VNM | AUTO SELIMI SH.P.K.

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

PËR PROJEKTIN
"Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, importimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve"

LOKACIONI

Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan | Zona Kadastrale Lipjan, parcelat 1402-2 dhe 1402-9 | Komuna e Lipjanit

APLIKUESI	HARTUESJA PËRGJEGJËSE
AUTO SELIMI SH.P.K. **Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan**	**Luljeta Kastrati** **Inxh. dipl. e Bujqësisë | Licencë për VNM nr. 20/19/24**

LIPJAN
Gusht 2026

TË DHËNAT E APLIKUESIT DHE HARTUESES PËRGJEGJËSE

AUTO SELIMI SH.P.K. – Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan | Faqe për nënshkrim

01 TË DHËNAT E APLIKUESIT

Emri i biznesit	AUTO SELIMI SH.P.K.
Emri tregtar	AUTO SELIMI
Numri Unik Identifikues	812145119
Forma juridike	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.)
Data e regjistrimit	27.03.2024
Adresa e regjistruar	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan
Veprimtaria kryesore	4520 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve
Veprimtaria sekondare	4532 – Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve
Përfaqësuesi / personi i autorizuar	Kushtrim Krasniqi – Drejtor Menaxhues
Telefoni dhe e-maili	048 316 466 | autoselimi@gmail.com

02 HARTUESJA PËRGJEGJËSE DHE RAPORTI

Hartuesja përgjegjëse	**Luljeta Kastrati**
Kualifikimi	Inxh. dipl. e Bujqësisë
Licenca për VNM	Nr. 20/19/24; e vlefshme 12.08.2024 – 11.08.2029
Statusi profesional	Person fizik i licencuar dhe hartuese përgjegjëse për Raportin e VNM-së
Raporti	**Raport i VNM-së për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, importimin dhe tregtimin e pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve – AUTO SELIMI SH.P.K.**

03 DEKLARATA DHE NËNSHKRIMET

Me nënshkrimin e kësaj faqeje, aplikuesi konfirmon saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit të dorëzuar për veprimtarinë e AUTO SELIMI SH.P.K. Hartuesja përgjegjëse konfirmon se Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur me kujdes profesional, në bazë të dokumentacionit teknik, administrativ, hapësinor dhe të dhënave institucionale në dispozicion, si dhe vlerësimit profesional të ndikimeve. Raporti trajton mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, importimin, magazinimin dhe tregtimin e pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera paraprakisht jashtë Kosovës, si dhe aktivitetet e servisimit të përshkruara në raport. Raporti nuk zëvendëson lejet, pëlqimet, licencat dhe projektet teknike që kërkohen nga autoritetet kompetente.

PËR APLIKUESIN	HARTUESJA E RAPORTIT
AUTO SELIMI SH.P.K.	**Luljeta Kastrati**
Përfaqësuesi: Kushtrim Krasniqi	Inxh. dipl. e Bujqësisë
Drejtor Menaxhues	Licenca për VNM nr. 20/19/24
Nënshkrimi: _____	Nënshkrimi: _____
Data: ____ / ____ / 2026	Data: ____ / ____ / 2026
Vula e kompanisë	Vula, sipas zbatueshmërisë

PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME 12

1.1. Të dhënat për aplikuesin 12

1.2. Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa 13

1.3. Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e Raportit të VNM-së 15

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR 17

2.1. Kategoria e projektit të propozuar 17

2.2. Përshkrim të punëve përgatitore për zbatimin e projektit 18

2.3. Përshkrimin e karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit 19

2.4. Përshkrimin detal të procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar 20

2.5. Paraqitjen e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme 21

2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik 22

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave 24

2.8. Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit 25

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme 26

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave 28

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin 28

2.12. Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese 29

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR 31

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti 31

3.2. Skicën dhe planimetrinë e vendndodhjes së projektit 32

3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi 36

3.4. Paraqitjen e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit 38

3.4.1. Pedologjia dhe përdorimi i tokës 38

3.4.2. Gjeomorfologjia dhe gjeologjia 39

3.4.3. Hidrogjeologjia 40

3.4.4. Sizmologjia 40

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë 41

3.6. Paraqitjen e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik 41

3.7. Prezantimi i karakteristikave natyrore....42
3.8. Rishikimi i karakteristikave themelore të peizazhit....43
3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike....43
3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar....43
3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese....44
3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme....46
3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj....49
4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR....51
4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor....51
4.1.1. Ajri....51
4.1.2. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore....52
4.1.3. Toka dhe nëntoka....52
4.1.4. Zhurma dhe vibrimet....52
4.1.5. Klima dhe ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike....52
4.1.6. Biodiversiteti dhe habitatet....53
4.1.7. Peizazhi dhe pamja vizuale....53
4.1.8. Popullsia, shëndeti dhe përdorimet e ndjeshme....53
4.1.9. Trashëgimia kulturore dhe natyrore....53
4.1.10. Infrastruktura, trafiku dhe shërbimet komunale....54
4.1.11. Mbeturinat dhe materialet e rrezikshme....54
4.1.12. Përmbledhja e gjendjes bazë dhe e boshllëqeve të të dhënave....54
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT....56
5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme....56
5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar....57
5.3. Vendndodhjes ose rrugës....58
5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut....58
5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit....59
5.5.1. Pranimi, regjistrimi dhe diagnostikimi i automjetit....60
5.5.2. Shërbimet mekanike, motorike dhe xhenerike....61
5.5.3. Shërbimet diagnostikuese dhe elektrike....61
5.5.4. Karroceria dhe llamarinisteria....61
5.5.5. Procesi i lyerjes dhe i tharjes....62

5.5.6. Shërbimet e gomisterisë 62
5.5.7. Pajisjet, materialet dhe infrastruktura përcjellëse 62
5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit 64
5.7. Planin e lokacionit 65
5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit 66
5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit 66
5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit 66
5.11. Vëllimi i prodhimit 67
5.12. Kontrolli i ndotjes 67
5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar 68
5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit 68
5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit 68
5.16. Trajnime 69
5.17. Monitorimi 69
5.18. Planet për situata emergjente 69
5.19. Demolimi dhe rehabilitimi 70
5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit 71
5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim 71
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS 73
6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë 73
6.2. Cilësinë e ajrit 74
6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi 75
6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike 75
6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit 75
6.6. Cilësia e ujit 76
6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore 76
6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave 76
6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza 76
6.10. Toka 77
6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj 77
6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës 77

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore 78
6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur....78
6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike....78
6.16. Popullsia lokale 79
6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi....79
6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve 79
6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut 79
6.20. Ndikimet socio-ekonomike 80
6.21. Ndikimi i projektit në strukturen e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesor të zonës 80
6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme te vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura....80
6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare....81
6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia....81
6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre....81
6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversiteti, florës dhe fauna, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre....82
6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve 82
6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara 82
6.29. Shfrytëzimi i tokës....82
6.30. Infrastruktura komunale 83
6.31. Trafiku....83
6.32. Furnizimi me ujë 83
6.33. Energjia 84
6.34. Ujërat e zeza....84
6.35. Gjenerimi i mbeturinave....84
6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit....85
6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga ...85
6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit 85
6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese....85
6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis,....86
6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit....86
6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit....86

6.43. Emetimet në ajër të gazrave serrë gjatë operimit 87

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike 87

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS 89

7.1. Masat e parashikuara me legjislacion 89

7.2. Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha 90

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit 91

7.4. Masa të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis 93

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS 95

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis 95

8.2. Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet 96

8.3. Parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis 97

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar 98

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera 99

8.6. Detyrimin për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera 99

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis, sipas rastit 100

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR 101

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit 101

9.2. Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor 103

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000 104

10. INFORMACIONE SHTESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT 106

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit specifik apo një lloji të caktuar projektesh përmbajnë të dhëna të tjera për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM-së, nëse kërkohen 106

11. BURIMET E TË DHËNAVE 110

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së 110

12. SHTOJCA 117

12.1. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT 117

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Shkurtesat e përdorura në raport....11
Tabela 2. Të dhënat identifikuese të aplikuesit....12
Tabela 3. Të dhënat kryesore identifikuese të projektit....14
Tabela 4. Të dhënat e hartueses përgjegjëse dhe fusha e përgjegjësisë....16
Tabela 5. Lidhja e projektit me kategoritë e Shtojcës 2 të Ligjit nr. 08/L-181....18
Tabela 6. Punët përgatitore, kushtet e zbatimit dhe dëshmia e kryerjes....19
Tabela 7. Karakteristikat kryesore të funksionimit të projektit....20
Tabela 8. Fazat e procesit nga hyrja e materialeve deri te produkti përfundimtar....21
Tabela 9. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme....22
Tabela 10. Rrymat e mbeturinave, karakteri dhe mënyra e vlerësimit të sasisë....23
Tabela 11. Burimet e emetimeve gjatë procesit teknologjik dhe kontrolli i tyre....24
Tabela 12. Rrugët e menaxhimit të rrymave të mbeturinave....25
Tabela 13. Programi i zbatimit, funksionimit dhe mbylljes....26
Tabela 14. Komponentët e infrastrukturës dhe kërkesat funksionale....27
Tabela 15. Lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme....29
Tabela 16. Të dhënat identifikuese të lokacionit....31
Tabela 17. Koordinatat e pikave kufitare sipas situacionit gjeodetik....33
Tabela 18. Sipërfaqet e planifikuara të zgjerimit....34
Tabela 19. Distancat orientuese ndaj receptorëve të paraqitur në hartë....37
Tabela 20. Furnizimi me ujë dhe të dhënat që kërkohen për ta plotësuar bilancin....41
Tabela 21. Treguesit klimatikë dhe rëndësia e tyre për lokacionin....42
Tabela 22. Treguesit demografikë të Komunës së Lipjanit....43
Tabela 23. Objektet dhe infrastruktura ekzistuese....44
Tabela 24. Përmbledhja e gjendjes bazë dhe e boshllëqeve të të dhënave....55
Tabela 25. Alternativat e shqyrtuara dhe realizueshmëria e tyre....57
Tabela 26. Krahasimi i alternativave sipas kritereve kryesore....58
Tabela 27. Vlerësimi krahasues i ndikimeve sipas alternativave....59
Tabela 28. Pajisjet kryesore të procesit teknologjik dhe aspekti mjedisor i tyre....62
Tabela 29. Organizimi funksional sipas situacionit dhe skicës së zgjerimit....65
Tabela 30. Treguesit e kapacitetit aktual të deklaruar....67
Tabela 31. Elementet themelore të Planit të Menaxhimit Mjedisor....71
Tabela 32. Kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve....73
Tabela 33. Pasqyra përmbledhëse e ndikimeve sipas komponentëve mjedisorë....74
Tabela 34. Matrica përmbledhëse e ndikimeve, e masave dhe e ndikimit të mbetur....87
Tabela 35. Masat e detyrueshme që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi....89
Tabela 36. Skenarët emergjentë, veprimi i menjëhershëm dhe veprimi pasues....91
Tabela 37. Zgjidhjet teknike të kërkuara dhe kriteret e pranimit....92
Tabela 38. Masat organizative, përgjegjësia, afati dhe dëshmia....94
Tabela 39. Objektivat e monitorimit, treguesit dhe pragjet për veprim....95
Tabela 40. Përmbajtja minimale e fushatës bazë të monitorimit....96
Tabela 41. Parametrat e monitorimit sipas komponentëve mjedisorë....97
Tabela 42. Pikat e monitorimit, mënyra dhe frekuenca minimale....98
Tabela 43. Raportet, përmbajtja minimale, afati dhe marrësi....99
Tabela 44. Rastet, informacioni, kanali dhe koha e informimit të publikut....100

Tabela 45. Rolet, detyrat dhe dëshmitë brenda Planit të Menaxhimit Mjedisor 101
Tabela 46. Kontrollet e detyrueshme sipas fazave dhe proceseve.....102
Tabela 47. Kalendari i zbatimit dhe kriteret e mbylljes së veprimeve 103
Tabela 48. Kontrolli i pajtueshmërisë me pëlqimin mjedisor 104
Tabela 49. Elementet e sistemit të menaxhimit mjedisor dhe zbatimi i propozuar.....105
Tabela 50. Karakteristikat e projektit dhe kufiri i vlerësimit 106
Tabela 51. Hapat e kontrollit të dërgesës dhe kriteret e refuzimit.....107
Tabela 52. Shërbimet dhe burimet: gjendja e dëshmuar dhe kontrolli shtesë i nevojshëm.....108
Tabela 53. Ndryshimet që kërkojnë rishqyrtim para zbatimit.....108
Tabela 54. Dokumentet e operatorit dhe institucionale.....110
Tabela 55. Burimet gjeohapësinore dhe terrenore.....111
Tabela 56. Burimet zyrtare statistikore dhe mjedisore.....112
Tabela 57. Regjistri i akteve juridike dhe statusi i tyre i verifikuar 113
Tabela 58. Të dhënat e prejardhura dhe metoda e nxjerrjes së tyre 115
Tabela 59. Të dhënat kryesore të projektit në formë të përmbledhur.....118
Tabela 60. Hapat kryesorë të veprimtarisë dhe kontrolli mjedisor.....120
Tabela 61. Ndikimet kryesore, rreziku pa masa dhe gjendja e synuar pas masave.....123
Tabela 62. Masat kryesore sipas fushave dhe dëshmia e zbatimit 124
Tabela 63. Elementet kryesore të monitorimit dhe veprimi në rast devijimi 124
Tabela 64. Regjistri i shtojcave dhe i dokumenteve përcjellëse.....126

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Organizimi aktual i kompleksit dhe zonat e planifikuara të zgjerimit 35
Figura 2. Zgjerimi i kompleksit dhe rruga.....36
Figura 3. Gjendja aktuale e hyrjes, e oborrit dhe e zonës operative me automjete e pjesë të ruajtura 38
Figura 4. Gjendja e sipërfaqeve operative dhe e zonave të magazinimit të pjesëve 45
Figura 5. Dëshmi dokumentare e shërbimit për mbeturinat komunale 46
Figura 6. Skicë konceptuale e organizimit funksional të lokacionit sipas zonave të përdorimit.....47
Figura 7. Pajisje dhe hapësira pune të përdorura gjatë procesit teknologjik 64
Figura 8. Zona e punës, magazinimi i materialeve dhe organizimi i brendshëm 64
Figura 9. Gjendja ekzistuese e zonës operative dhe e magazinimit të pjesëve.....121
Figura 10. Organizimi funksional i propozuar i lokacionit sipas zonave të përdorimit 122

LISTA E HARTAVE

Harta 1. Pozita gjeografike dhe kadastrale e zonës së projektit në raport me Lipjanin, Banullën dhe rrjetin rrugor 15
Harta 2. Qasja rrugore dhe konteksti i përdorimeve fqinje në zonën e projektit.....27
Harta 3. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në zonën e projektit sipas Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021–2029.....30
Harta 4. Situacioni i terrenit me ortofoto, kufirin e projektit dhe objektet ekzistuese.....33
Harta 5. Distancat orientuese ndaj vendbanimeve dhe objekteve orientuese.....37
Harta 6. Pozita e projektit në hartën pedologjike të zonës 39
Harta 7. Pozita e projektit në hartën gjeologjike të zonës 40
Harta 8. Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në raport me zonën e projektit.....49
Harta 9. Situacioni i qasjes në rrjetin e kanalizimit dhe pozita e pusetave (propozim).....50
Harta 10. Pozita gjeografike e veprimtarisë në raport me vendbanimet dhe me rrjetin rrugor 119

SHKURTESAT DHE KONVENTAT E PARAQITJES SË TË DHËNAVE

Ky seksion përcakton shkurtesat dhe konventat numerike të përdorura në të gjithë raportin. Qëllimi është të eliminohet çdo mundësi e keqleximit të vlerave sasiore gjatë shqyrtimit administrativ, inspektimit ose krahasimit me dokumentet burimore.

Tabela 1. Shkurtesat e përdorura në raport

Shkurtesa	Kuptimi i plotë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
AKK / SIKTK	Agjencia Kadastrale e Kosovës / Sistemi i Informacionit Kadastral
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinave
UA	Udhëzim Administrativ
GZ	Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
ZK	Zona Kadastrale
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
VOC	Përbërje organike të avullueshme (volatile organic compounds)
TPH	Hidrokarbure totale të naftës (total petroleum hydrocarbons)
BTEX	Benzen, toluen, etilbenzen dhe ksilene
PM_{10} / $PM_{2,5}$	Grimca të pezulluara me diametër aerodinamik nën 10 / 2,5 µm
LAeq	Nivel ekuivalent i vazhdueshëm i zhurmës, i ponderuar A
PPE	Pajisje mbrojtëse personale
ELV	Automjete në fund të jetës (end-of-life vehicles)

Burimi: Terminologjia e përdorur në legjislacionin mjedisor të Republikës së Kosovës dhe në praktikën teknike të raporteve të VNM-së.

Vlerat numerike paraqiten sipas konventës shqipe: presja përdoret si shenjë dhjetore (për shembull 673,3 mm) dhe pika përdoret si ndarëse e mijësheve (për shembull 5.094 m²). Njësitë matëse shkruhen pas vlerës, të ndara me hapësirë. Vlerat e marra drejtpërdrejt nga dokumente burimore paraqiten pa ndryshim të madhësisë; vetëm formati i shkrimit është harmonizuar.

Sipërfaqja e përgjithshme e lokacionit shkruhet 5.094 m² (pesë mijë e nëntëdhjetë e katër metra katrorë), sipërfaqja e planifikuar e zgjerimit shkruhet 1.280 m² (një mijë e dyqind e tetëdhjetë metra katrorë), ndërsa popullsia e Komunës së Lipjanit shkruhet 55.044 banorë (pesëdhjetë e pesë mijë e dyzet e katër banorë).

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për veprimtarinë e kompanisë AUTO SELIMI SH.P.K. dhe për projektin me titull "Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, importimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve". Raporti hartohet në zbatim të Ligjit nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Gazeta Zyrtare nr. 2/2023, 06.01.2023) dhe strukturohet sipas Shtojcës I të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit.

Titujt dhe renditja e kapitujve 1–12, si dhe e nënkapitujve brenda tyre, janë bartur pa ndryshim nga Shtojca I e UA-së nr. 04/2025. Kjo zgjedhje metodologjike mundëson kontroll të drejtpërdrejtë të përputhshmërisë nga Komisioni i VNM-së dhe krahasim pikë për pikë me Listën e Kontrollit të Shtojcës II të së njëjtës UA. Aty ku natyra e projektit ka kërkuar ndarje më të hollësishme, janë shtuar vetëm nënnivele brenda pikës përkatëse, pa hequr, bashkuar ose rirenditur asnjë pikë të strukturës së detyrueshme.

Veprimtaria e vlerësuar është ekzistuese dhe zhvillohet në lokacionin në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan. Për këtë arsye, raporti dallon në mënyrë sistematike gjendjen faktike aktuale nga ndërhyrjet e propozuara, nga masat e detyrueshme dhe nga rezultatet e monitorimit që do të gjenerohen pas zbatimit. Ky dallim ruhet në secilin kapitull dhe përbën bazën e vlerësimit të ndikimit të mbetur.

1.1. Të dhënat për aplikuesin

Aplikuesi është AUTO SELIMI SH.P.K., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë me Numër Unik Identifikues 812145119. Subjekti është vazhdimësi e biznesit individual të themeluar më 24.08.2001, i cili më 27.03.2024 ka ndryshuar formën juridike në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ky element ka rëndësi për vlerësimin, sepse dëshmon se veprimtaria në lokacion ka histori më të gjatë se data e regjistrimit aktual dhe se gjendja bazë e mjedisit nuk mund të konsiderohet gjendje e paprekur.

Të dhënat identifikuese janë krahasuar ndërmjet certifikatës së regjistrimit, informatave të biznesit të lëshuara nga ARBK dhe dokumenteve të lokacionit. Nuk janë konstatuar mospërputhje në emrin e biznesit, numrin unik identifikues dhe adresën e regjistruar. Veprimtaria kryesore e regjistruar është kodi 4520, ndërsa veprimtaria sekondare është kodi 4532; të dyja janë në përputhje me aktivitetin që përshkruhet në Kapitullin 2.

Të dhënat e mëposhtme përcaktojnë subjektin përgjegjës për zbatimin e masave mjedisore, kufirin e përgjegjësisë juridike dhe kanalin zyrtar të komunikimit me autoritetin kompetent. Ato nuk zëvendësojnë certifikatat origjinale, të cilat dorëzohen si dokumente shoqëruese sipas Shtojcës III të UA-së nr. 04/2025 dhe nenit 13 të Ligjit nr. 08/L-181.

Tabela 2. Të dhënat identifikuese të aplikuesit

Elementi identifikues	Të dhëna	Burimi dhe statusi
Emri i biznesit	AUTO SELIMI SH.P.K.	Certifikata e regjistrimit, ARBK – e dokumentuar
Emri tregtar	AUTO SELIMI	Informatat e biznesit, ARBK – e dokumentuar
Numri Unik Identifikues	812145119	Informatat e biznesit, ARBK – e dokumentuar
Numri serik i certifikatës	10181415	Certifikata e regjistrimit – e dokumentuar

Elementi identifikues	Të dhëna	Burimi dhe statusi
Forma juridike	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.)	Certifikata e regjistrimit – e dokumentuar
Data e regjistrimit në formën aktuale	27.03.2024	Certifikata e regjistrimit – e dokumentuar
Themelimi fillestar i veprimtarisë	24.08.2001	Informatat e biznesit – e dokumentuar
Adresa e regjistruar dhe e ushtrimit të veprimtarisë	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan	Certifikata e regjistrimit dhe dokumentet e lokacionit – e dokumentuar
Veprimtaria kryesore	4520 – Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	Informatat e biznesit, ARBK – e dokumentuar
Veprimtaria sekondare	4532 – Tregtia me pakicë e pjesëve dhe aksesorëve të automjeteve	Informatat e biznesit, ARBK – e dokumentuar
Përfaqësuesi / personi i autorizuar	Kushtrim Krasniqi – Drejtor Menaxhues	Informatat e biznesit, ARBK – e dokumentuar
Telefoni	048 316 466	Deklarim i aplikuesit – e deklaruar
Posta elektronike	autoselimi@gmail.com	Deklarim i aplikuesit – e deklaruar
Numri i punëtorëve i deklaruar në ARBK	1	Informatat e biznesit – e dokumentuar; numri faktik konfirmohet nga aplikuesi

Burimi: Certifikata e regjistrimit dhe informatat e biznesit të lëshuara nga ARBK; të dhënat e kontaktit të deklaruara nga aplikuesi.

Numri i punëtorëve i regjistruar në ARBK është një (1). Ky numër përfaqëson gjendjen e regjistruar administrative dhe jo domosdoshmërisht numrin e personave që punojnë realisht në lokacion gjatë orarit të punës. Meqë numri i personave të ekspozuar përcakton kërkesat për pajisje mbrojtëse, trajnime, nyje sanitare dhe plan emergjent, numri faktik i punëtorëve duhet të deklarohet nga aplikuesi dhe të përditësohet në regjistrimin e biznesit; kjo çështje është regjistruar në listën e çështjeve të hapura.

1.2. Të dhënat kryesore për projektin, titulli i plotë, vendndodhja dhe adresa

Titulli i plotë i projektit është “Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, importimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve”. Ky titull përdoret në formë identike në kopertinë, në faqen e nënshkrimeve, në përmbajtje, në të gjithë kapitujt, në përmbledhjen joteknike dhe në shtojcat e raportit. Çdo shkurtim i titullit në dokumentet përcjellëse duhet të shoqërohet me titullin e plotë të paktën një herë, në mënyrë që identifikimi i projektit të mbetet i pandryshuar gjatë procedurës administrative.

Projekti përfshin dy veprimtari funksionalisht të lidhura. E para është mirëmbajtja, diagnostikimi dhe riparimi i automjeteve, duke përfshirë shërbimet mekanike, motorike, elektrike dhe elektronike, punët e karrocerisë e llamarinisterisë, përgatitjen dhe lyerjen në kabinë/furrë, si dhe gomisterinë. E dyta është importimi, pranimi, magazinimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura të automjeteve, ku përfshihen edhe segmente të mëdha strukturore – pjesa e përparme, pjesa e pasme dhe seksione të tjera të trupit – të prera paraprakisht jashtë Republikës së Kosovës dhe të destinuara për ripërdorim si pjesë.


Veprimtaria zhvillohet në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, në Zonën Kadastrale Lipjan, Komuna e Lipjanit, me qasje të drejtpërdrejtë nga rruga ekzistuese. Sipas situacionit të terrenit të rilevuar nga gjeodeti i licencuar Florent Retkoceri (licencë nr. 182) më 17.08.2026, sipërfaqja e matur e lokacionit të projektit është 5.094 m². Kufiri hapësinor i vlerësimit të këtij raporti është identik me kufirin e projektit të paraqitur në atë situacion dhe nuk shtrihet përtej tij.

Tabela 3. Të dhënat kryesore identifikuese të projektit

Elementi	Të dhëna	Statusi i të dhënës
Titulli i plotë i projektit	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, importimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve	I deklaruar nga aplikuesi
Lloji i projektit	Veprimtari ekzistuese shërbyese dhe tregtare, me zgjerim të planifikuar brenda kufirit ekzistues të lokacionit	Vlerësim mbi bazën e dokumentacionit
Komuna	Komuna e Lipjanit	E dokumentuar
Zona kadastrale	ZK Lipjan	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Parcelat sipas situacionit gjeodetik	1402-2 dhe 1402-9	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Adresa	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan	ARBK dhe dokumentet e lokacionit – e dokumentuar
Sipërfaqja e matur e lokacionit	5.094 m²	Situacion i rilevuar më 17.08.2026 – e dokumentuar
Sipërfaqja e planifikuar e zgjerimit	1.280 m² (autoservis 550 m² + garazh/depo 730 m²)	E deklaruar nga aplikuesi
Kapaciteti aktual i shërbimit	Rreth 30 automjete të riparuara në muaj	E deklaruar nga aplikuesi
Kapaciteti aktual i importit të pjesëve	Rreth 15 vetura/furgona të prera në seksione për pjesë në muaj	E deklaruar nga aplikuesi
Orari i punës	08:00–16:00, e hënë – e shtunë	E deklaruar nga aplikuesi
Statusi i lokacionit sipas planifikimit hapësinor	Zonë komerciale sipas Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021–2029	E dokumentuar në material hartografik komunal

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit, situacioni gjeodetik i datës 17.08.2026 dhe materiali hartografik komunal i dorëzuar për raportin.

Vlerat e kapacitetit të paraqitura më sipër janë vlera mesatare mujore të deklaruara nga aplikuesi dhe përdoren si bazë e vlerësimit në të gjithë raportin. Ato nuk janë rezultat i numërimit të pavarur dhe nuk përbëjnë kufi të autorizuar; kufiri i autorizuar i kapacitetit përcaktohet me vendimin e autoritetit kompetent. Verifikimi i tyre bëhet përmes evidencës së urdhër-punëve, dokumenteve doganore dhe regjistrit të inventarit, sipas programit të monitorimit të Kapitullit 8.



Harta 1. Pozita gjeografike dhe kadastrale e zonës së projektit në raport me Lipjanin, Banullën dhe rrjetin rrugor

Burimi: Material hartografik i korrigjuar dhe i harmonizuar me situacionin gjeodetik të datës 17.08.2026; kufiri i projektit dhe parcelat paraqiten sipas burimit primar gjeodetik.

Harta 1 është harmonizuar me situacionin gjeodetik të datës 17.08.2026 dhe paraqet parcelat P-71409044-01402-2 dhe P-71409044-01402-9. Për kufirin, gjeometrinë dhe sipërfaqen e projektit burimi primar mbetet situacioni i rilevuar nga gjeodeti i licencuar. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit me koordinata në sistemin KosovaRef mbeten dokumente shoqëruese të dosjes sipas Shtojcës III të UA-së nr. 04/2025; ato nuk zëvendësohen nga kjo hartë, por mospërputhja numerike e mëparshme e etiketave të parcelave është eliminuar.

1.3. Të dhëna për hartuesit që kanë marrë pjesë në hartimin e Raportit të VNM-së

Raporti është hartuar dhe konsoliduar nga Luljeta Kastrati, Inxh. dipl. e Bujqësisë, person fizik i licencuar nga Ministria për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Licenca mban numrin 20/19/24 dhe është e vlefshme nga 12.08.2024 – 11.08.2029. Kopja e licencës dhe dokumentet që dëshmojnë kualifikimin profesional bashkëngjiten në dosjen e aplikimit, sipas pikës (n) të Shtojcës III të UA-së nr. 04/2025.

Hartuesja përgjegjëse mban përgjegjësinë profesionale për metodologjinë e vlerësimit, identifikimin e ndikimeve, përcaktimin e masave, programin e monitorimit, planin e menaxhimit mjedisor dhe konsolidimin përfundimtar të dokumentit. Procedurat dhe kriteret për licencimin e personave fizikë dhe juridikë për hartimin e raportit të VNM-së rregullohen me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) nr. 03/2025, të publikuar më 26.11.2025 në zbatim të nenit 12 paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-181.

Aplikuesi është përgjegjës për saktësinë dhe plotësinë e të dhënave teknike, pronësore, operative dhe administrative që i janë vënë në dispozicion hartueses. Çdo ndryshim i procesit teknologjik, i kapacitetit, i

kufirit të lokacionit ose i dokumentacionit pas datës së këtij raporti duhet t'i komunikohet me shkrim hartueses dhe autoritetit kompetent para zbatimit, sepse mund të ndryshojë përfundimet e vlerësimit dhe kushtet e pëlqimit mjedisor.

Tabela 4. Të dhënat e hartueses përgjegjëse dhe fusha e përgjegjësisë

Elementi	Të dhëna	Fusha e mbuluar në raport
Hartuesja përgjegjëse	Luljeta Kastrati	Konsolidimi i të gjithë raportit dhe nënshkrimi
Kualifikimi profesional	Inxh. dipl. e Bujqësisë	Vlerësimi i tokës, biodiversitetit dhe përdorimit të sipërfaqeve
Licenca për VNM	Nr. 20/19/24	Baza ligjore e hartimit sipas nenit 12 të Ligjit nr. 08/L-181
Vlefshmëria e licencës	12.08.2024 – 11.08.2029	Mbulon periudhën e hartimit dhe të dorëzimit
Statusi profesional	Person fizik i licencuar nga MMPHI	Përgjegjësi profesionale për metodologjinë dhe përfundimet
Kontributi i aplikuesit	Të dhëna teknike, operative dhe dokumentacion	Kapitujt 1, 2, 5 dhe 10 – të dhënat e deklaruara
Kontributi i gjeodetit të licencuar	Florent Retkoceri, licencë nr. 182, rilevim i datës 17.08.2026	Kufiri i projektit, koordinatat dhe sipërfaqja – Kapitulli 3

Burimi: Licenca për VNM e lëshuar nga MMPHI, situacioni i terrenit i datës 17.08.2026 dhe dokumentacioni i hartimit.

Në hartimin e raportit nuk ka marrë pjesë asnjë anëtar i Komisionit të VNM-së, në përputhje me nenin 5 paragrafi 4 të Ligjit nr. 08/L-181, dhe nuk është identifikuar konflikt interesi ndërmjet hartueses dhe aplikuesit. Kur autoriteti kompetent kërkon matje instrumentale ose analiza laboratorike, ato kryhen nga laboratorë ose persona kompetentë të akreditуar për parametrin përkatës dhe raportet e tyre i bashkëngjiten raportit pa ndryshim.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

Ky kapitull përshkruan projektin sipas pikave 2.1–2.12 të Shtojcës I të UA-së nr. 04/2025. Projekti i propozuar lidhet me veprimtarinë ekzistuese të servisit të automjeteve dhe të tregtimit të pjesëve të përdorura, si dhe me zgjerimin e planifikuar të objekteve brenda kufirit ekzistues të lokacionit. Përshkrimi mbulon njëkohësisht atë që kryhet sot dhe atë që propozohet të ndryshojë, duke i dalluar qartë të dyja.

Kufiri teknologjik i projektit është përcaktues për të gjithë raportin. Prerja fillestare e automjeteve në seksione të mëdha kryhet jashtë Republikës së Kosovës; në lokacionin e Lipjanit kryhen pranimi, kontrolli, karantina kur konstatohet rrjedhje ose status i paqartë, magazinimi, nxjerrja dhe tregtimi i pjesëve, si dhe punët e servisit mekanik, të karrocerisë, të lyerjes dhe të gomisterisë. Trajtimi i automjeteve në fund të jetës si rrymë mbeturinash nuk është pjesë e këtij projekti dhe nuk vlerësohet këtu.

Për çdo element të përshkruar tregohet burimi dhe statusi i të dhënës. Sasitë që nuk janë dokumentuar me faturë, inventar ose matje paraqiten si vlera të deklaruara nga aplikuesi dhe hyjnë në programin e evidencës të Kapitullit 8, ku përcaktohet mënyra e regjistrimit dhe e verifikimit të tyre.

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Projekti nuk bën pjesë në asnjë kategori të Shtojcës 1 të Ligjit nr. 08/L-181, e cila mbulon projektet që i nënshtrohen detyrimisht procedurës së VNM-së. Në lokacion nuk kryhet shkrirje metalesh, nuk ka fonderi, nuk ka trajtim sipërfaqësor elektrolitik apo kimik me vëllim vaske mbi 10 m³, nuk ka djegie industriale, nuk ka trajtim termik dhe nuk ka deponim përfundimtar të mbeturinave. Prandaj klasifikimi i projektit duhet kërkuar në Shtojcën 2 të po atij ligji, e cila përcakton projektet që ekzaminohen rast pas rasti.

Karakteristikat e veprimtarisë lidhen me tri kategori të Shtojcës 2. Pika 4.5 – impiant për trajtim sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike – bëhet relevante për shkak të punëve të karrocerisë, bluarjes, stukimit dhe lyerjes së sipërfaqeve metalike e plastike të automjeteve. Pika 10.2 – projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjeve të automjeteve – lidhet me karakterin tregtar-shërbyes të kompleksit dhe me sipërfaqet e mëdha të manipulimit e të radhitjes së automjeteve. Pika 12.11 – çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të Shtojcës 1 ose 2 që mund të ketë ndikime të theksuara jo të favorshme – lidhet drejtpërdrejt me zgjerimin e planifikuar prej 1.280 m².

Pika 12.5 e Shtojcës 2 – depo për ruajtjen e mbeturinave të hekurit dhe të metaleve të tjera, duke përfshirë skeletet metalike të makinave të dala jashtë përdorimit – nuk zbatohet për gjendjen e përshkruar në këtë raport, sepse pjesët e importuara janë të destinuara për ripërdorim dhe trajtohen si mallra. Kjo pikë do të bëhej e zbatueshme menjëherë nëse lokacioni do të përdorej për grumbullimin e skeleteve metalike të automjeteve jashtë përdorimit ose të mbetjeve metalike si rrymë mbeturinash. Për këtë arsye, kontrolli i kufirit produkt–mbeturinë në pranim nuk është masë administrative dytësore, por kusht që përcakton vetë kategorinë ligjore të projektit.

Tabela 5. Lidhja e projektit me kategoritë e Shtojcës 2 të Ligjit nr. 08/L-181

Pika e Shtojcës 2	Përmbajtja e kategorisë	Lidhja me projektin	Vlerësimi
4.5	Impiant për trajtim sipërfaqësor të metaleve dhe materialeve plastike (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën 1)	Karroceria, bluarja, stukimi dhe lyerja në kabinë/furrë të sipërfaqeve metalike e plastike	E zbatueshme; burim kryesor i emetimeve të VOC-ve dhe i pluhurit
10.2	Projekte të zhvillimit urban, duke përfshirë ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkingjeve të automjeteve	Kompleks tregtar-shërbyes me sipërfaqe të gjera manipulimi, radhitjeje dhe parkimi	E zbatueshme për nga natyra e përdorimit të sipërfaqes
12.11	Çdo ndryshim ose zgjerim i projekteve të Shtojcës 1 ose 2 me ndikime të mundshme jo të favorshme	Zgjerimi i autoservisit me 550 m² dhe garazhi/depoja me 730 m²	E zbatueshme për komponentin e zgjerimit
12.5	Depo për ruajtjen e mbeturinave të hekurit dhe të metaleve, përfshirë skeletet metalike të makinave jashtë përdorimit	Nuk zbatohet për pjesët e destinuara për ripërdorim; do të zbatohej nëse lokacioni përdoret për grumbullim mbetjesh metalike	Jo e zbatueshme në kushtet e këtij raporti; kusht kufizues i detyrueshëm
Shtojca 1	Projektet që i nënshtrohen detyrimisht VNM-së	Pa shkrirje, pa fonderi, pa trajtim elektrolitik mbi 10 m³, pa djegie industriale	Nuk zbatohet

Burimi: Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 1 dhe Shtojca 2 (Gazeta Zyrtare nr. 2/2023).

Klasifikimi i paraqitur më sipër është vlerësim profesional i hartueses dhe nuk e paragjykon vendimin e Komisionit të VNM-së. Sipas nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-181, projektet e Shtojcës 2 ekzaminohen rast pas rasti sipas kritereve të Shtojcës 3 të po atij ligji, dhe vendimi përfundimtar mbi nevojën dhe shtrirjen e procedurës i takon autoritetit kompetent.

KUFIRI TEKNOLOGJIK I PROJEKTIT

Pjesët e importuara pranohen si produkte të përdorura vetëm kur janë të identifikueshme, të kulluara nga lëngjet, pa rrjedhje, teknikisht të përshtatshme dhe realisht të destinuara për ripërdorim. Kur një ngarkesë përmban pjesë të papërdorshme, materiale të përziera pa destinim të qartë ose materiale të destinuara vetëm për rikuperim apo asgjësim, ajo klasifikohet si dërgesë mbeturinash dhe i nënshtrohet Udhëzimit Administrativ MMPHI nr. 02/2024 për lejen e importit, eksportit dhe kalimit tranzit të mbeturinave. Prerja e automjeteve të plota në Kosovë, importi i automjeteve për trajtim dhe grumbullimi i skeleteve metalike nuk mbulohen nga ky vlerësim.

2.2. Përshkrim të punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Meqë veprimtaria është ekzistuese, punët përgatitore nuk kanë karakter të hapjes së një kantieri të ri, por të riorganizimit funksional të lokacionit dhe të përgatitjes së dy ndërhyrjeve ndërtimore të planifikuara. Faza përgatitore fillon me verifikimin e kufirit kadastral sipas situacionit gjeodetik, vazhdon me hartimin e projektit zbatues për zgjerimin e autoservisit me 550 m² dhe për garazhin/depon me 730 m², dhe përfundon me kontrollin statik, urbanistik, kundër zjarrit dhe mjedisor të zgjidhjeve të propozuara.

Para fillimit të punimeve caktohen fizikisht zona e punës, hyrja e kontrolluar, vendet e përkohshme për materialet dhe për mbeturinat e ndërtimit, si dhe korridori i lëvizjes së sigurt brenda parcelës. Sipas skicës së aplikuesit, rruga e brendshme e qarkullimit do të kalojë nën pjesën e zgjeruar të objektit të autoservisit dhe do të vazhdojë drejt garazhit/depos. Projekti zbatues duhet të vërtetojë lartësinë e lirë të kalimit, ngarkesat

strukturore, rrezet e kthesave për automjetet e transportit, fushëpamjen, ndriçimin, ventilimin dhe qasjen e mjeteve të shërbimeve emergjente, pa e bllokuar hyrjen nga rruga publike.

Gjatë punimeve zbatohen masat e zakonshme të kontrollit të pluhurit, të zhurmës dhe të mbeturinave: lagia e kontrolluar ose pastrimi me vakum i sipërfaqeve, kufizimi i punëve të zhurmshme brenda orarit 08:00–16:00, mbulimi i materialeve të imëta, ndarja e mbeturinave të ndërtimit sipas llojit, mbrojtja e pusetave ekzistuese dhe gatishmëria për derdhje aksidentale. Materialet dhe pajisjet nuk vendosen jashtë parcelave 1402-2 dhe 1402-9, ndërsa ujërat me llum, vaj ose bojë nuk shkarkohen në tokë, në kanalizim ose në rrjedhat ujore.

Tabela 6. Punët përgatitore, kushtet e zbatimit dhe dëshmia e kryerjes

Puna përgatitore	Përmbajtja teknike	Kushti mjedisor	Dëshmia
Verifikimi i kufirit	Shënimi në terren i kufirit të projektit sipas situacionit gjeodetik të datës 17.08.2026	Asnjë aktivitet, magazinim ose parkim operativ jashtë kufirit	Procesverbal i shënimit dhe fotografi me datë
Projektimi i zgjerimeve	Projekt zbatues për 550 m² autoservis dhe 730 m² garazh/depo	Dysheme e papërshkueshme, ventilim, mbrojtje nga zjarri dhe drenazhim i kontrolluar	Projekti i aprovuar dhe lejet përkatëse
Organizimi i zonave	Ndarja e pranimit, karantinës, servisit, magazinës dhe mbeturinave	Korridor i lirë qarkullimi dhe emergjence sipas projektit të aprovuar	Planimetria e zbatimit dhe shenjat në dysheme
Përgatitja e sipërfaqeve	Riparimi i çarjeve, shtrimi ose veshja e zonave me rrezik	Rezistencë ndaj hidrokarbureve dhe mundësi pastrimi	Fletët teknike të materialeve dhe procesverbali i pranimit
Pajisjet e mbrojtjes	Kompletet për derdhje, aparatet kundër zjarrit, sinjalizimi	Vendosje e qasshme dhe e pabllokuar nga stoku	Lista e pajisjeve dhe afatet e kontrollit
Menaxhimi i mbeturinave të punimeve	Ndarja e mbetjeve të ndërtimit sipas llojit	Ndalim i përzierjes me mbeturinat e servisit dhe komunale	Fletëpërcjellëset dhe dëshmitë e dorëzimit

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi.

Punët përgatitore nuk kërkojnë gërmime të thella, largim të shtresës vegjetative në sipërfaqe të gjera, hapje rrugësh të reja jashtë parcelës apo ndërhyrje në rrjedhat ujore. Për këtë arsye ndikimet e fazës përgatitore vlerësohen si të përkohshme, lokale dhe të kthyeshme, me kusht që masat e mësipërme të zbatohen dhe të dokumentohen.

2.3. Përshkrimin e karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi organizohet në linja të ndara por të ndërlidhura, të cilat ndajnë të njëjtin kufi lokacioni, të njëjtën hyrje dhe të njëjtët receptorë mjedisorë. Linjat kryesore janë: pranimi dhe diagnostikimi i automjeteve; mirëmbajtja mekanike, motorike dhe elektrike; karroceria dhe llamarinisteria me saldim e bluarje; përgatitja, lyerja dhe tharja në kabinë/furrë; gomisteria; pranimi, karantina dhe magazinimi i pjesëve të përdorura; dhe garazhi/depoja për pajisje pune e pjesë rezervë.

Kapaciteti aktual i deklaruar është rreth 30 automjete të riparuara në muaj dhe rreth 15 vetura ose furgona të prera në seksione për pjesë të importuara në muaj, me orar 08:00–16:00, e hënë – e shtunë. Në repartin e autoservisit përdoren tetë (8) ura ngritëse, kompresori i ajrit, pajisjet diagnostikuese, pajisjet e saldimit, pajisjet e gomisterisë dhe kabina/furra e lyerjes. Këto pajisje përdoren vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit, me mirëmbajtje të dokumentuar dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë në punë.

Zonimi i brendshëm është element funksional me efekt të drejtpërdrejtë mjedisor. Ndarja fizike e klientëve, e automjeteve në punë, e stokut tregtar dhe e mbeturinave pengon përzierjen e materialeve me status të ndryshëm

juridik, zvogëlon rrezikun e kontaminimit të pjesëve të pastra dhe mundëson gjurmimin e çdo dërgese. Procesi i lyerjes kërkon ventilim të dedikuar, filtra funksionalë, kontroll të pluhurit nga bluarja, enë të mbyllura për bojërat dhe tretësit, si dhe ruajtje sipas fletëve të të dhënave të sigurisë.

Tabela 7. Karakteristikat kryesore të funksionimit të projektit

Karakteristika	Vlera ose përshkrimi	Statusi i të dhënës
Statusi i veprimtarisë	Ekzistuese, me zgjerim të planifikuar brenda kufirit	E dokumentuar me regjistrim dhe fotografi terreni
Orari i punës	08:00–16:00, e hënë – e shtunë	E deklaruar nga aplikuesi
Automjete të mirëmbajtura/riparuara	Rreth 30 në muaj	E deklaruar; verifikohet me urdhër-punët
Njësi të importuara për pjesë	Rreth 15 vetura/furgona të prera në seksione në muaj	E deklaruar; verifikohet me dokumentet doganore
Ura ngritëse	8 copë	E deklaruar nga aplikuesi
Kabina/furra e lyerjes	Një njësi për lyerje dhe tharje të automjeteve	E deklaruar; kapaciteti dhe filtrat verifikohen me dokumentacionin e pajisjes
Sipërfaqja e lokacionit	5.094 m²	E matur nga gjeodeti i licencuar
Zgjerimi i planifikuar	1.280 m² gjithsej	E deklaruar; dimensionet verifikohen në projektin zbatues
Prerja e automjeteve	Kryhet jashtë Republikës së Kosovës	E deklaruar; kufi teknologjik i detyrueshëm
Produktet dalëse	Pjesë të përdorura të tregtuara dhe shërbimi i riparimit	Vlerësim mbi bazën e përshkrimit të procesit

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit dhe situacioni gjeodetik i datës 17.08.2026.

Vlerat vjetore prej rreth 360 automjeteve dhe rreth 180 njësive të importuara janë ekstrapolime aritmetike dymbëdhjetëmujore të mesatares mujore të deklaruar. Ato nuk përfaqësojnë evidencë vjetore të verifikuar dhe nuk marrin parasysh ndërprerjet sezonale, refuzimet e ngarkesave ose luhatjet e kërkesës. Evidenca reale vjetore duhet të paraqesë numrin faktik dhe ndryshimet kundrejt mesatares.

2.4. Përshkrimin detal të procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar

Projekti nuk përbën linjë klasike prodhimi. Produkti përfundimtar është, nga njëra anë, pjesa e përdorur e kontrolluar dhe e dorëzuar te klienti, dhe nga ana tjetër shërbimi i riparimit i kryer mbi automjetin e klientit. Rrjedhimisht, “lëndët hyrëse” janë pjesët dhe segmentet strukturore të importuara, automjetet e klientëve dhe materialet ndihmëse të servisimit e të lyerjes, ndërsa dalja përfshin produktin e tregtuar, automjetin e riparuar dhe rrymat e mbeturinave.

Rrjedha operative fillon me përzgjedhjen dhe dokumentimin e dërgesës në vendin e origjinës dhe përfundon me dorëzimin te klienti ose me dorëzimin e mbeturinave te operatori i autorizuar. Pika kritike e gjithë procesit është hapi i tretë – vendimi produkt–mbeturinë – sepse ai përcakton njëkohësisht statusin juridik të materialit, mënyrën e ruajtjes, kërkesat e dokumentimit dhe rrugën e daljes nga lokacioni.

Tabela e mëposhtme paraqet fazat e procesit sipas radhës kohore, aktivitetet përbërëse dhe kontrollin mjedisor që i takon secilës fazë. Ajo lexohet së bashku me skemën e procesit teknologjik të paraqitur në Kapitullin 5 dhe me kriteret e pranimit të Kapitullit 9; të tri paraqitjet përdorin të njëjtën renditje fazash dhe të njëjtën terminologji.

Tabela 8. Fazat e procesit nga hyrja e materialeve deri te produkti përfundimtar

Nr.	Faza	Përmbajtja e fazës	Kontrolli mjedisor kryesor
1	Përzgjedhja në vendin e origjinës	Përzgjidhen vetëm pjesë dhe segmente strukturore me potencial real ripërdorimi; kryhet identifikimi, pastrimi dhe kullimi paraprak i lëngjeve	Ndalim i ngarkimit të pjesëve me rrjedhje aktive; dokumentim fotografik i gjendjes
2	Paketimi dhe transporti	Pjesët stabilizohen sipas peshës dhe dimensioneve; motorët, ndërruesit dhe komponentët e ngjashëm vendosen mbi paleta ose mbajtëse	Mbajtje sekondare kundër rrjedhjeve gjatë transportit
3	Importi dhe pranimi	Çdo ngarkesë shoqërohet me faturë, listë pjesësh dhe dokumentacion doganor; në hyrje kontrollohen dokumentet, gjendja fizike dhe mungesa e rrjedhjeve	Shkarkimi lejohet vetëm në platformë të papërshkueshme; ngarkesa jokonforme refuzohet
4	Karantina dhe klasifikimi	Pjesët me status të paqartë izolohen në zonë të shënuar; pas kontrollit klasifikohen si produkt, pjesë për riparim ose mbeturinë	Mbulim, mbajtje sekondare dhe vendim i dokumentuar produkt–mbeturinë
5	Magazinimi dhe inventarizimi	Pjesët shënohen me kod, model dhe gjendje; elementet e rënda ruhen mbi bazamente të qëndrueshme, komponentët e ndjeshëm nën mbulim	Pa kontakt me tokën dhe pa ekspozim ndaj reshjeve
6	Karroceria dhe llamarinisteria	Çmontimi i pjesës së dëmtuar, drejtimi ose prerja e kontrolluar, saldimi, bluarja dhe përgatitja e sipërfaqes	Aspirim lokal i pluhurit dhe tymit; ndarje e shkëndijave nga materialet e ndezshme
7	Lyerja dhe tharja	Përgatitja e bojës sipas fletës së sigurisë, aplikimi dhe tharja në kabinë/furrë	Ventilim dhe filtra funksionalë; enë të mbyllura; evidencë e ndërrimit të filtrave
8	Kontrolli, montimi dhe dorëzimi	Montimi, kontrolli funksional e vizual, testimi i kufizuar dhe dorëzimi te klienti	Kufizim i ndezjeve provuese; pastrim me metoda të thata
9	Menaxhimi i rrymave dalëse	Pjesët e refuzuara dhe mbeturinat e servisimit ndahen sipas llojit dhe ruhen përkohësisht në mënyrë të sigurt	Etiketim, evidencë sasiore dhe dorëzim vetëm te operatorë të licencuar

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit për rrjedhën operative dhe kërkesat e legjislacionit për menaxhimin e mbeturinave.

Nga tabela dallohen tre pika ku ndikimi mjedisor mund të kalojë nga i kontrollueshëm në të rëndësishëm: pranimi i një ngarkese me rrjedhje aktive, ruajtja e pjesëve me lëngje të mbetura në sipërfaqe të papërshtatshme dhe mungesa e ndarjes ndërmjet stokut tregtar dhe mbeturinave. Masat e Kapitullit 7 janë ndërtuar pikërisht rreth këtyre tri pikave.

2.5. Paraqitjen e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Burimet e nevojshme për funksionimin e projektit ndahen në katër grupe: hapësira dhe infrastruktura ekzistuese; energjia dhe uji; materialet hyrëse tregtare, pra pjesët e importuara; dhe materialet ndihmëse të servisimit, karrocerisë e lyerjes. Asnjë prej tyre nuk përfshin shfrytëzim të drejtpërdrejtë të burimeve natyrore mineral, pyjore ose ujore në sasi industriale.

Dokumentacioni i dorëzuar për hartimin e raportit nuk përmban bilance vjetore të konsumit të energjisë, të ujit dhe të materialeve. Prandaj sasitë nuk paraqiten si vlera të matura, por si njësi evidence me bazë të përcaktuar përllogaritjeje. Aplikuesi është i detyruar t’i finalizojë ato mbi bazën e faturave, të kapacitetit të magazinimit dhe të numrit mesatar të shërbimeve, sipas programit të evidencës të Kapitullit 8.

Ndër materialet ndihmëse, vëmendje e veçantë i kushtohet grupit të bojërave, stukove, primerëve, llaqeve dhe tretësve, sepse ky grup përcakton emetimet e përbërjeve organike të avullueshme, rrezikun nga zjarri dhe një pjesë të konsiderueshme të mbeturinave të rrezikshme. Për secilin produkt të këtij grupi duhet të ruhet fleta e të dhënave të sigurisë dhe të regjistrohet sasia e konsumuar për periudhë.

Tabela 9. Lloji dhe sasia e burimeve të nevojshme

Burimi	Përdorimi	Njësia e evidencës	Baza e përcaktimit të sasisë
Sipërfaqja e lokacionit	Punishte, magazinim, qarkullim dhe manipulim	m²	5.094 m² sipas situacionit gjeodetik të datës 17.08.2026
Sipërfaqet e zgjerimit	Autoservis dhe garazh/depo	m²	550 m² + 730 m² = 1.280 m² sipas deklarimit; verifikohen në projektin zbatues
Pjesë të përdorura dhe segmente strukturore	Mall tregtar dhe montim në servis	copë, kg ose ton për ngarkesë	Lista e çdo dërgese dhe inventari periodik
Energji elektrike	Ndriçim, vegla, kompresor, kabinë lyerjeje dhe diagnostikë	kWh/muaj	Leximi i matësit dhe faturat e furnizuesit
Ujë	Nevoja sanitare dhe pastrim i kontrolluar	m³/muaj	Leximi i matësit; pa proces me konsum të vazhdueshëm
Vajra, lubrifikantë dhe lëngje teknike	Mirëmbajtje dhe riparim	litra/muaj	Urdhër-punët dhe faturat e blerjes
Bojëra, stuko, primerë, llak dhe tretës	Karroceria dhe lyerja	kg ose litra/muaj	Faturat, inventari dhe konsumi i regjistruar për urdhër-pune
Filtra kabine, materiale maskuese dhe letra zmerile	Kontrolli i mjegullës së bojës dhe përgatitja e sipërfaqes	copë ose kg/muaj	Evidenca e ndërrimeve dhe e mirëmbajtjes
Materiale absorbuese dhe pastruese	Parandalim dhe pastrim i derdhjeve	kg/muaj	Konsumi real dhe evidenca e magazinës
Gazet teknike dhe materialet e saldimit	Bashkimi dhe riparimi i pjesëve metalike	copë ose kg/muaj	Faturat dhe evidenca e magazinës
Fuqi punëtore	Operim dhe administrim	numër punëtorësh	1 punëtor i deklaruar në ARBK; numri faktik konfirmohet nga aplikuesi

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit, situacioni gjeodetik dhe faturat e shërbimeve të paraqitura në dosjen e raportit.

Asnjë nga sasitë e mësipërme nuk është paraqitur si vlerë e matur, sepse dokumentet burimore nuk përmbajnë seri konsumi. Kolona e fundit përcakton se ku dhe si sigurohet secila vlerë, në mënyrë që evidenca e parë mujore të mund të krahasohet me kapacitetin e deklaruar dhe të shërbejë si bazë për vlerësimin e ndryshimit të kapacitetit.

2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik

Mbeturinat gjenerohen kryesisht nga mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, nga punët e karrocerisë dhe lyerjes, nga ambalazhet e materialeve dhe nga refuzimi i pjesëve që pas kontrollit rezultojnë të papërdorshme. Sasitë varen drejtpërdrejt nga numri i shërbimeve dhe i dërgesave; për këtë arsye ato maten në pikën e gjenerimit dhe raportohen në evidencën mujore e vjetore të operatorit.

Kodet e paraqitura më poshtë janë kode orientuese sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave dhe duhet të konfirmohen sipas përbërjes reale të secilës rrymë. Klasifikimi përfundimtar i një rryme, veçanërisht për antifrizin dhe për mbetjet e bojërave, varet nga përmbajtja e substancave të rrezikshme e deklaruar në fletën e

të dhënave të sigurisë së produktit të përdorur. Kodi i gabuar nuk është çështje formale: ai përcakton kërkesat e paketimit, të etiketimit, të magazinimit dhe operatorin që lejohet ta pranojë rrymën.

Emetimet në ajër lidhen me trafikun dhe ndezjet provuese, por edhe me pluhurin nga bluarja, tymin e saldimit dhe përbërjet organike të avullueshme nga përgatitja e sipërfaqes dhe lyerja. Kabina e lyerjes duhet të funksionojë me ventilim dhe filtra sipas projektit dhe udhëzimeve të prodhuesit; ndërrimi i filtrave, konsumi i materialeve dhe çdo ankesë për erë regjistrohen. Ujërat ose materialet me vaj, bojë e tretës nuk shkarkohen në tokë, në kanalizim ose në rrjedhat ujore.

Tabela 10. Rrymat e mbeturinave, karakteri dhe mënyra e vlerësimit të sasisë

Kodi orientues	Lloji i mbeturinës	Karakteri	Mënyra e vlerësimit të sasisë
13 02 05*	Vajra minerale jo të klorinuara të motorit, transmisionit dhe lubrifikimit	E rrezikshme	Matje në litra dhe evidencë për çdo ndërrim
16 01 07*	Filtra vaji	E rrezikshme	Numërim dhe peshim para dorëzimit
16 01 13*	Lëngje frenash	E rrezikshme	Matje në litra
16 01 14* / 16 01 15	Lëngje antifrizi me ose pa substanca të rrezikshme	Sipas përbërjes	Matje në litra dhe verifikim i fletës së sigurisë
16 06 01*	Bateri plumbi	E rrezikshme	Numërim dhe peshim
16 01 03	Goma jashtë përdorimit	Jo e rrezikshme	Numërim dhe peshim
16 01 17 / 16 01 18	Metale hekuri dhe metale johekurore	Jo e rrezikshme	Peshim para dorëzimit
16 01 19 / 16 01 20	Plastikë dhe qelq	Jo e rrezikshme	Peshim dhe evidencë sipas llojit
08 01 11* / 08 01 12	Mbetje bojrash dhe llaqesh me ose pa tretës e substanca të rrezikshme	Sipas përbërjes	Peshim dhe verifikim me fletën e të dhënave të sigurisë
08 01 17*	Mbetje nga heqja e bojërave dhe llaqeve që përmbajnë substanca të rrezikshme	E rrezikshme	Peshim në enën e dedikuar
15 01 10*	Ambalazhe që përmbajnë mbetje ose janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme	E rrezikshme	Numërim ose peshim për çdo enë
15 02 02*	Absorbues, filtra kabine, lecka dhe veshje mbrojtëse të kontaminuara	E rrezikshme	Peshim në enën e dedikuar
15 01 01 / 15 01 02	Ambalazh letre, kartoni dhe plastike	Jo e rrezikshme	Peshim ose vlerësim sipas vëllimit
12 01 01 / 12 01 02	Ashkla dhe grimca metalike nga bluarja dhe përpunimi mekanik	Jo e rrezikshme nëse nuk janë të vajosura	Peshim; nëse janë të vajosura, kalojnë në kod të rrezikshëm
20 03 01	Mbeturina komunale të përziera nga administrata dhe nyjat sanitare	Jo e rrezikshme	Vëllimi i kontejnerit dhe numri i zbrazjeve

Burimi: Udhëzimi Administrativ nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave; përbërja reale e secilës rrymë konfirmohet me fletët e të dhënave të sigurisë.

Rrymat me yll (*) janë mbeturina të rrezikshme dhe kërkojnë enë kompatibile, të mbyllura dhe të etiketuara, ruajtje nën mbulim me mbajtje sekondare, ndarje nga rrymat e tjera dhe dorëzim vetëm te operatorë të autorizuar, sipas Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme. Shërbimi komunal i mbeturinave nuk mbulon asnjë prej tyre.

Tabela 11. Burimet e emetimeve gjatë procesit teknologjik dhe kontrolli i tyre

Burimi i emetimit	Faza e procesit	Emetimi kryesor	Kontrolli i parashikuar
Lëvizja dhe ndezja e automjeteve	Pranim, provë, dorëzim	Gazra shkarkimi, PM, NO_2, CO	Kufizim i ndezjeve në boshe; shpejtësi e ulët; orientim i portave larg receptorëve
Bluarja dhe përgatitja e sipërfaqes	Karroceri	Pluhur i imët dhe grimca	Aspirim lokal, pastrim me vakum, ndarje e zonës
Saldimi	Karroceri	Tym saldimi dhe grimca metalike	Aspirim lokal dhe ekranim i shkëndijave
Aplikimi i bojës dhe tretësve	Lyerje	VOC dhe mjegull boje	Kabinë me ventilim dhe filtra; enë të mbyllura; evidencë e konsumit
Tharja në furrë	Lyerje	VOC të mbetura dhe nxehtësi	Parametra sipas prodhuesit; filtra funksionalë
Kompresori dhe veglat	Servis mekanik	Zhurmë dhe vibrime të shkurtra	Elemente antivibruese, mirëmbajtje, punë brenda objektit
Sipërfaqet e pambuluara	Manipulim dhe magazinim	Pluhur nga rrëshqitja e mjeteve	Shtrim ose lagie e kontrolluar; kufizim shpejtësie
Enët me lëngje teknike	Magazinim	Avullime të kufizuara dhe erë	Enë të mbyllura, të etiketuara, nën mbulim

Burimi: Vlerësim profesional mbi bazën e procesit të deklaruar dhe të pajisjeve të identifikuara në lokacion.

Asnjë prej emetimeve të mësipërme nuk është matur në kufirin e lokacionit ose te receptori më i afërt. Për këtë arsye raporti nuk pretendon përputhshmëri numerike me vlerat kufitare; ai identifikon burimin, rrugën e përhapjes dhe kontrollin, dhe e lidh secilin burim me një pikë monitorimi të Kapitullit 8.

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Në lokacion nuk planifikohet dhe nuk lejohet asnjë operacion trajtimi industrial, rikuperimi termik ose asgjësimi përfundimtar i mbeturinave. Menaxhimi bazohet tërësisht në ndarjen në burim, ruajtjen e përkohshme të sigurt dhe dorëzimin te operatorë të licencuar. Ky kufizim është përcaktues për kategorinë e projektit dhe duhet të ruhet gjatë gjithë kohës së funksionimit.

Vajrat dhe lëngjet teknike mblidhen në enë të mbyllura, të etiketuara dhe të vendosura mbi mbajtje sekondare me vëllim të mjaftueshëm. Filtrat kullohen në sistem të mbyllur para magazinimit, absorbuesit dhe leckat e kontaminuara ruhen në kontejnerë të veçantë nën mbulim, ndërsa bateritë vendosen vertikalisht mbi sipërfaqe rezistente ndaj acidit dhe të mbrojtur nga reshjet. Metalet, plastika, qelqi, gomat dhe ambalazhet ndahen për riciklim ose trajtim përmes operatorëve të autorizuar.

Hierarkia e menaxhimit zbatohet në renditjen: parandalim i gjenerimit; përgatitje për ripërdorim, që në këtë veprimtari është opsioni kryesor dhe përfaqësohet nga vetë tregtimi i pjesëve të përdorshme; riciklim; rikuperim tjetër; dhe, si mundësi e fundit, asgjësim nga operatori i licencuar. Për çdo dorëzim mbahet dëshmi me llojin, kodin, sasinë, datën, pranuesin dhe numrin e licencës së tij.

Tabela 12. Rrugët e menaxhimit të rrymave të mbeturinave

Rryma	Ruajtja e përkohshme në lokacion	Rruga e mëtejshme	Dëshmia që mbahet
Vajra të përdorura dhe lëngje teknike	Enë të mbyllura, të etiketuara, mbi mbajtje sekondare, nën mbulim	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme	Fletëpërcjellësja, licenca e operatorit, sasia në litra
Filtra vaji dhe filtra kabine	Kullim i plotë në sistem të mbyllur; enë e dedikuar	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme	Numri/pesha dhe dokumenti i dorëzimit
Bateri plumbi	Pozitë vertikale, sipërfaqe rezistente ndaj acidit, nën mbulim	Operator i licencuar ose skemë e kthimit te furnizuesi	Numri, pesha dhe dokumenti i dorëzimit
Mbetje bojrash, llaqesh dhe ambalazhe të kontaminuara	Enë të mbyllura dhe të etiketuara, larg burimeve të ndezjes	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme	Pesha, kodi dhe fleta e të dhënave të sigurisë
Absorbues dhe lecka të kontaminuara	Kontejner i veçantë me kapak, nën mbulim	Operator i licencuar për mbeturina të rrezikshme	Pesha dhe dokumenti i dorëzimit
Goma jashtë përdorimit	Radhitje e qëndrueshme, e ndarë nga stoku tregtar	Operator i autorizuar për rikuperim	Numri/pesha dhe dokumenti i dorëzimit
Metale hekuri dhe johekurore	Kontejner ose zonë e shënuar, e ndarë nga stoku	Riciklues i autorizuar	Pesha dhe dokumenti i dorëzimit
Plastikë, qelq dhe ambalazh letre	Kontejnerë të ndarë sipas llojit	Riciklues i autorizuar	Pesha ose vëllimi dhe dokumenti i dorëzimit
Mbeturina komunale	Kontejner komunal	KRM “Pastrimi” Sh.A.	Fatura dhe evidenca e zbrazjeve

Burimi: Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, i ndryshuar dhe plotësuar; UA (QRK) nr. 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme; praktikat e zbatueshme të servisimit të automjeteve.

Kontrata ekzistuese për mbeturinat komunale me KRM “Pastrimi” Sh.A. mbulon vetëm rrymën komunale të paraqitur në rreshtin e fundit. Për çdo rrymë tjetër, para dorëzimit të parë, aplikuesi duhet të verifikojë licencën e operatorit dhe të sigurojë kontratë ose marrëveshje për rrymën përkatëse. Këto dokumente mungojnë në dosjen aktuale dhe, për këtë arsye, trajtohen si kusht me afat të menjëhershëm; pa to nuk lejohet dorëzimi i mbeturinave jashtë lokacionit.

2.8. Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Programi ndahet në katër faza: riorganizimi dhe përgatitja e lokacionit; ndërtimi i dy zgjerimeve të planifikuara; funksionimi i rregullt; dhe mbyllja me rehabilitim. Meqë veprimtaria është ekzistuese, faza e parë dhe e treta ndodhin paralelisht dhe nuk kërkojnë ndërprerje të plotë të aktivitetit, me kusht që siguria dhe qarkullimi të mbeten të garantuara.

Afatet e paraqitura më poshtë janë orientuese dhe fillojnë të rrjedhin pas sigurimit të pëlqimit mjedisor dhe të lejeve përkatëse. Ato nuk përbëjnë angazhim kontraktual dhe nuk zëvendësojnë afatet që mund të vendosen me kushtet e vendimit të autoritetit kompetent. Kohëzgjatja e funksionimit nuk është e paracaktuar dhe rrjedh përderisa lejet dhe kushtet mjedisore mbeten të vlefshme.

Faza e mbylljes trajtohet me të njëjtin nivel detajimi si fazat e tjera, sepse pikërisht atëherë materializohet rreziku i grumbullimit të mbeturinave të pa dorëzuara dhe i ndotjes historike të pazbuluar. Mbyllja fillon me

njoftimin e autoritetit, vazhdon me largimin e inventarit dhe të lëngjeve, dhe përfundon me kontrollin e tokës në zonat me rrezik dhe me rehabilitimin sipas gjetjeve.

Tabela 13. Programi i zbatimit, funksionimit dhe mbylljes

Faza	Aktivitetet kryesore	Afati orientues	Rezultati i kërkuar
Faza 1 – Riorganizimi	Shënimi i zonave funksionale, lirimi i korridoreve, ndarja e mbeturinave, vendosja e kompleteve për derdhje dhe e pajisjeve kundër zjarrit	0–3 muaj pas pëlqimit	Lokacion i organizuar dhe i dokumentuar me fotografi e lista kontrolli
Faza 2 – Ndërtimi i zgjerimeve	Zgjerimi i autoservisit me 550 m² dhe ndërtimi i garazhit/depos me 730 m² sipas projektit zbatues	6–12 muaj, sipas lejeve	Objekte të përfunduara dhe të pranuara teknikisht
Faza 3 – Funksionimi	Pranim, kontroll, magazinim, tregtim dhe servisim; monitorim dhe raportim	Pa afat të paracaktuar, gjatë vlefshmërisë së lejeve	Veprimtari e rregullt me evidencë mjedisore të plotë
Mirëmbajtja	Kontroll periodik i pajisjeve, dyshemeve, drenazhimit, enëve dhe pajisjeve kundër zjarrit	Gjatë gjithë funksionimit	Parandalim i rrjedhjeve, i aksidenteve dhe i degradimit të sipërfaqeve
Faza 4 – Mbyllja dhe rehabilitimi	Njoftim i autoritetit, largim i inventarit dhe i mbeturinave, pastrim i sipërfaqeve, kontroll i tokës në zonat me rrezik	3–6 muaj pas ndërprerjes	Lokacion i pastruar, pa rrezik të mbetur dhe me dokumentacion të plotë të dorëzimit

Burimi: Deklarimet e aplikuesit për dinamikën e planifikuar dhe kërkesat e procedurës së pëlqimit mjedisor.


Sipas nenit 21 të Ligjit nr. 08/L-181, vlefshmëria e pëlqimit mjedisor ndërpritet nëse brenda dy (2) vjetësh nga data e pranimit të vendimit aplikuesi nuk siguron lejen për ndërtim ose aprovimin për realizimin e projektit dhe nëse lokacioni nuk është përgatitur e as nuk është nisur ndonjë aktivitet operativ. Ky afat duhet të merret parasysh në planifikimin e Fazës 2, sepse vonesa në sigurimin e lejeve ndërtimore mund të kërkojë aplikim të ri për pëlqim mjedisor.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Lokacioni lidhet drejtpërdrejt me rrugën Bajram Gashi, e cila siguron qasjen për automjetet e klientëve dhe për mjetet e furnizimit. Organizimi i hyrjes dhe i daljes duhet të mundësojë manovrim të sigurt brenda parcelës, pa bllokim të rrugës publike dhe pa pritje të mjeteve të rënda në karrexhatë. Nuk kërkohet hapja e rrugëve të reja jashtë kufirit të lokacionit.

Infrastruktura funksionale e projektit përfshin punishten me dysheme rezistente, zonën e magazinimit, hapësirën e ngarkim-shkarkimit, rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, objektet sanitare, sistemin e drenazhimit të ujërave atmosferike dhe zonën e ruajtjes së përkohshme të mbeturinave. Furnizimi me energji elektrike nga rrjeti publik dëshmohet me faturën e furnizuesit KESCO në emër të biznesit, ndërsa shërbimi për mbeturinat komunale dëshmohet me faturën e KRM “Pastrimi” Sh.A.

Menaxhimi i ujërave atmosferike mbetet komponent prioritar i mbrojtjes së tokës dhe ujërave. Raporti përcakton ndarjen konceptuale të ujërave të pastra nga rrjedhjet e zonave me rrezik dhe kalimin e këtyre të fundit në grumbullim, sedimentim, separator hidrokarburesh dhe pusetë kontrolli; skema teknike orientuese është bashkëngjitur në fund të raportit. Dosja nuk përmban ende projekt zbatues hidroteknik, dimensionim të separatorit apo pikë të miratuar shkarkimi; këto mbeten kërkesa të projektit zbatues dhe të pranimit teknik.



Harta 2. Qasja rrugore dhe konteksti i përdorimeve fqinje në zonën e projektit

Burimi: Ortofoto dhe material hartografik i rrjetit rrugor i përgatitur për projektin; kufiri i projektit sipas situacionit gjeodetik.

Tabela 14. Komponentët e infrastrukturës dhe kërkesat funksionale

Komponenti	Gjendja aktuale	Kërkesa funksionale dhe mjedisore
Qasja dhe manipulimi	Hyrje ekzistuese nga rruga Bajram Gashi / R-120	Hyrje e kontrolluar, hapësirë manovrimi brenda parcelës, zonë e ndarë ngarkim-shkarkimi
Punishtja	Objekt pune ekzistues me ura ngritëse dhe pajisje servisi	Dysheme e qëndrueshme dhe e papërshkueshme, pa çarje, me ventilim dhe ndriçim të mjaftueshëm
Kabina/furra e lyerjes	Njësi ekzistuese për lyerje dhe tharje	Ventilim dhe filtrim sipas prodhuesit; evidencë e ndërrimit të filtrave; ndalim i burimeve të ndezjes
Magazinimi i pjesëve	Ruajtje e kombinuar, pjesërisht në hapësirë të jashtme	Rafte dhe bazamente të dimensionuara sipas peshës, mbulim dhe ndarje sipas llojit
Energjia elektrike	Furnizim nga rrjeti publik, faturë KESCO në emër të biznesit	Instalime të mbrojtura, kontroll periodik, evidencë mujore e kWh
Furnizimi me ujë	Ujë sanitar nga kompania rajonale e ujësjellësit	Matës funksional dhe evidencë mujore e m³; dëshmi e kyçjes
Ujërat e zeza sanitare	Shkarkim në kanalizimin e vendbanimit – i deklaruar; dëshmia e kyçjes për t'u bashkëngjitur	Vetëm ujëra sanitare; ndalim i lëngjeve teknike. Në mungesë të lidhjes funksionale zbatohet vetëm zgjidhje alternative e mbyllur dhe e papërshkueshme sipas projektit teknik
Ujërat atmosferike	Rrjedhje sipërfaqësore dhe pusetat ekzistuese; skema konceptuale e ndarjes dhe e kontrollit është paraqitur në raport	Projekt zbatues hidroteknik: ndarje e ujërave të pastra nga zonat me rrezik, sedimentim, separator hidrokarburesh, pusetë kontrolli dhe pikë daljeje e miratuar
Siguria nga zjarri	Pajisje ekzistuese kundër zjarrit	Aparate të kontrolluara, dalje të lira, sinjalizim, ndarje e materialeve të ndezshme

Komponenti	Gjendja aktuale	Kërkesa funksionale dhe mjedisore
Zona e mbeturinave	Ruajtje e përkohshme në lokacion	Hapësirë e mbuluar, e shënuar dhe me mbajtje sekondare për rrymat e rrezikshme

Burimi: Vrojtimi i dokumentacionit fotografik, faturat e shërbimeve dhe deklarimet e aplikuesit.

Kolona e tretë përcakton nivelin minimal të pranueshëm për secilin komponent. Aty ku gjendja aktuale nuk e arrin këtë nivel – sidomos te drenazhimi, mbulimi i magazinimit të jashtëm dhe zona e mbeturinave të rrezikshme – kërkesa kalon si masë e detyrueshme në Kapitullin 7 dhe si tregues i pranimit në Kapitullin 9.

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Projekti nuk kërkon ndërtimin e kampeve të punëtorëve, të rezidencave, të guroreve, të rrugëve të reja apo të objekteve të përkohshme jashtë kufirit të lokacionit. Punimet e planifikuara zhvillohen brenda parcelave 1402-2 dhe 1402-9 dhe kryhen nga kontraktorë që lëvizin ditore; nuk parashihet akomodim i personelit në lokacion.

Aktivitetet ndihmëse kufizohen në transportin ndërkombëtar dhe vendor të dërgesave, shërbimet doganore, mirëmbajtjen e pajisjeve nga servise të specializuara, kontrollin periodik të pajisjeve kundër zjarrit dhe angazhimin e operatorëve të licencuar për rrymat e mbeturinave. Këto aktivitete nuk zhvillohen në lokacion në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk shtojnë burime të reja emetimi brenda parcelës.

Nëse në një fazë të ardhshme do të kërkohej ndonjë aktivitet ndihmës me karakter të përhershëm – për shembull, një depo e jashtme e autorizuar, një zonë e re parkimi jashtë parcelës ose një impiant i vogël i trajtimit të ujërave – ai do të përbënte ndryshim të projektit dhe do t'i nënshtrohej vlerësimit paraprak dhe njoftimit të autoritetit kompetent para zbatimit, sipas procedurës së menaxhimit të ndryshimit të përcaktuar në Kapitullin 9.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Para operimit të plotë sipas kushteve të vlerësuara në këtë raport, aplikuesi duhet të sigurojë dhe të mirëmbajë dokumentacionin që zbatohet sipas natyrës reale të aktivitetit dhe sipas vendimit të autoriteteve kompetente. Lista e mëposhtme nuk zëvendëson kërkesat e autoritetit, por i grupon ato sipas institucionit dhe qëllimit, në mënyrë që dosja e aplikimit të mund të kontrollohet pikë për pikë.

Sipas nenit 7 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit nr. 08/L-181, pëlqimi mjedisor i paraprin lejes së ndërtimit ose çdo leje tjetër, dhe aplikuesi nuk mund të fillojë ekzekutimin e projektit përderisa nuk pajiset me pëlqim mjedisor. Kjo radhë ka rëndësi praktike për Fazën 2 të programit të zbatimit: projektimi mund të vazhdojë, por punimet ndërtimore nuk mund të fillojnë para vendimit të Ministrisë dhe para lejes së ndërtimit.

Një grup i veçantë dokumentesh lidhet me statusin e dërgesave. Për çdo ngarkesë të pjesëve të përdorura ruhen fatura, lista e pjesëve, dëshmia e origjinës dhe dokumentacioni doganor. Leja për import mbeturinash sipas UA-së MMPHI nr. 02/2024 kërkohet vetëm nëse dërgesa klasifikohet si mbeturinë; ajo nuk aplikohet automatikisht për pjesët e destinuara për ripërdorim, por bëhet e detyrueshme sapo kriteret e ripërdorimit nuk plotësohen.

Tabela 15. Lejet, licencat dhe dokumentet e nevojshme

Dokumenti ose kërkesa	Institucioni ose pala	Qëllimi	Statusi
Certifikata e regjistrimit dhe informatat e biznesit	ARBK	Përputhja e veprimtarisë së regjistruar me aktivitetin real	E dorëzuar; përditësohet sipas ndryshimeve
Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe kopja e planit me koordinata në sistemin KosovaRef	AKK / Zyra Kadastrale Komunale	Vërtetimi i pronësisë dhe harmonizimi i identifikuesve kadastralë	Për t'u plotësuar
Plani i rilevimit të terrenit dhe licenca e gjeodetit	Gjeodet i licencuar	Kufiri, koordinatat dhe sipërfaqja e projektit	I dorëzuar (rilevim i datës 17.08.2026)
Vendimi i përzgjedhjes dhe pëlqimi mjedisor	MMPHI	Zbatimi i procedurës së VNM-së sipas Ligjit nr. 08/L-181	Në procedurë
Leja mjedisore, nëse kërkohet për kategorinë e aktivitetit	MMPHI ose autoriteti kompetent	Kushtet e operimit dhe të monitorimit sipas UA (MMPHI) nr. 04/2022	Për t'u përcaktuar
Pëlqimi i Komunës ose njoftim-informimi sipas planit zhvillimor, hartave zonale dhe kushteve ndërtimore	Komuna e Lipjanit	Pajtueshmëria hapësinore dhe ndërtimore e lokacionit	Për t'u plotësuar
Leja e ndërtimit dhe e përdorimit për zgjerimet e planifikuara	Komuna e Lipjanit	Legalizimi i 1.280 m² sipërfaqe të re	Për t'u siguruar para punimeve
Pëlqimi dhe masat e mbrojtjes nga zjarri	Autoriteti kompetent	Zbatimi i Ligjit nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri	Për t'u plotësuar
Dokumentet doganore dhe tregtare për çdo ngarkesë	Dogana e Kosovës	Dëshmimi i origjinës dhe i statusit të pjesëve të përdorura	Mbahen për çdo dërgesë
Leja për import mbeturinash	MMPHI	Zbatohet vetëm kur dërgesa klasifikohet si mbeturinë, sipas UA MMPHI nr. 02/2024	Nuk aplikohet për pjesët e ripërdorshme
Kontratat dhe dëshmitë e dorëzimit të mbeturinave	Operatorë të licencuar	Menaxhim i ligjshëm i vajrave, filtrave, baterive, gomave dhe rrymave të tjera	Për t'u plotësuar
Dëshmia e kyçjes në ujësjellës dhe kanalizim	KRU dhe Komuna	Konfirmimi i furnizimit dhe i shkarkimit sanitar	Për t'u plotësuar
Licenca e hartuesit të raportit të VNM-së	MMPHI	Zbatimi i nenit 12 të Ligjit nr. 08/L-181 dhe i UA (MMPHI) nr. 03/2025	E dorëzuar (nr. 20/19/24)

Burimi: Ligji nr. 08/L-181, neni 9 dhe neni 13; Shtojca III e UA-së (MMPHI) nr. 04/2025; legjislacioni sektorial në fuqi.


Statusi "për t'u plotësuar" tregon dokumente që nuk gjendeshin në dosjen e vënë në dispozicion për hartimin e raportit. Të gjitha janë bartur në listën e çështjeve të hapura me përgjegjësin dhe kapitullin ku integrohen, sepse mungesa e tyre mund të pengojë pranimin e aplikimit ose të kushtëzojë vendimin e Ministrisë.

2.12. Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti nuk varet teknologjikisht nga asnjë impiant tjetër dhe nuk furnizon me lëndë të parë asnjë proces industrial. Ndërlidhjet e tij janë funksionale dhe infrastrukturore: rrjeti ekzistues rrugor, furnizimi me energji elektrike dhe me ujë, rrjeti i kanalizimit të vendbanimit, shërbimet doganore, transportuesit ndërkombëtarë e vendorë, tregu i pjesëve të automjeteve dhe operatorët e licencuar për menaxhimin e mbeturinave.

Sipas Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021–2029, zona ku ndodhet lokacioni është e përcaktuar si zonë komerciale. Kjo do të thotë se në afërsi bashkëjetojnë dhe do të vazhdojnë të bashkëjetojnë veprimtari të ngjashme tregtare e shërbyese, të cilat përdorin të njëjtin korridor rrugor dhe të njëjtat shërbime komunale. Rrjedhimisht, ndikimet e projektit nuk vlerësohen të izoluara, por së bashku me kontributin e veprimtarive fqinje – kjo trajtohet në pikën 6.39 për ndikimet kumulative.

Nuk është identifikuar asnjë projekt i planifikuar në afërsi që të ndryshojë ndjeshëm gjendjen bazë të përshkruar në Kapitullin 4. Nëse gjatë procedurës administrative Komuna ose Ministria identifikon një projekt të tillë – për shembull, një zgjerim i infrastrukturës rrugore ose një veprimtari e re me emetime – vlerësimi kumulativ duhet të plotësohet para vendimit, sepse receptorët janë të njëjtë.



Harta 3. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në zonën e projektit sipas Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021–2029

Burimi: Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2021–2029, fragment i dorëzuar për raportin; pajtueshmëria përfundimtare vërtetohet me konfirmim zyrtar urbanistik.

Harta zonale përdoret këtu si tregues i kontekstit planifikues dhe jo si dokument që vërteton pajtueshmërinë e parcelave konkrete. Konfirmimi zyrtar i pajtueshmërisë zonale dhe i kushteve ndërtimore për parcelat 1402-2 dhe 1402-9 lëshohet nga Komuna e Lipjanit dhe është pjesë e dokumentacionit shoqërues të kërkuar nga Shtojca III e UA-së nr. 04/2025.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

Ky kapitull përshkruan lokacionin dhe receptorët mjedisorë sipas pikave 3.1–3.13 të Shtojcës I të UA-së nr. 04/2025. Vlerësimi mbështetet në situacionin gjeodetik të datës 17.08.2026, në hartat tematike të dorëzuara, në fotografitë e terrenit, në dokumentet e operatorit dhe në burimet zyrtare komunale e statistikore.

Hierarkia e burimeve është e përcaktuar dhe zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme. Situacioni i rilevuar nga gjeodeti i licencuar ka përparësi absolute për kufirin e projektit, për koordinatat dhe për sipërfaqen. Hartat tematike rajonale përdoren për kontekst gjeologjik, pedologjik, hidrologjik dhe zonal, por nuk përdoren për të nxjerrë vlera që kërkojnë matje lokale. Fotografitë e terrenit dëshmojnë gjendjen faktike të sipërfaqes dhe të magazinimit.

Aty ku nuk ekzistojnë matje laboratorike, studime gjeoteknike ose matje hidrologjike të parcelës, kjo është shënuar shprehimisht dhe nuk është zëvendësuar me supozime. Të dhënat rajonale ose komunale nuk interpretohen si matje të parcelës; ato shërbejnë vetëm për të përcaktuar kontekstin dhe për të orientuar programin e monitorimit.

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Në nivel makrolokacioni, projekti ndodhet në Komunën e Lipjanit, në pjesën qendrore të Republikës së Kosovës, në fushëgropën e Kosovës. Lipjani lidhet me Prishtinën dhe me Ferizajn përmes korridorit kryesor rrugor të vendit dhe ka strukturë të përzier urbane, periurbane dhe rurale. Në nivel mikrolokacioni, veprimtaria zhvillohet në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, në skajin lindor/periurban të qytetit të Lipjanit, në një korridor me përdorim mbizotërues komercial dhe shërbyes.

Lokacioni ka qasje të drejtpërdrejtë nga rruga Bajram Gashi, e cila lidhet me rrugën rajonale R-120. Ky pozicionim ka dy pasoja mjedisore të drejtpërdrejta: nga njëra anë, projekti nuk kërkon hapjen e rrugëve të reja dhe nuk shkakton fragmentim të ri të tokës; nga ana tjetër, hyrja dhe dalja e mjeteve ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe në rrjedhën e trafikut të korridorit ekzistues.

Rëndësia e karakteristikave të lokacionit për vlerësimin përcaktohet nga rrugët e mundshme të ndikimit. Ajri dhe zhurma përhapen drejt objekteve të afërta të përdorura; rrjedhjet e lëngjeve lëvizin drejt tokës, pusetave dhe rrjedhës ujore në lindje–juglindje; trafiku ndikon në rrugën Bajram Gashi. Prandaj masat e projektuara në kapitujt vijues janë dimensionuar për receptorin më të afërt dhe më të ndjeshëm, jo për distancën mesatare deri te qendrat e vendbanimeve.

Tabela 16. Të dhënat identifikuese të lokacionit

Elementi	Të dhëna	Burimi dhe statusi
Emri i lokacionit	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan	ARBK dhe dokumentet e lokacionit – e dokumentuar
Komuna	Lipjan	E dokumentuar
Zona kadastrale	ZK Lipjan	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Parcelat sipas situacionit gjeodetik	1402-2 dhe 1402-9	Rilevim i licencuar i datës 17.08.2026 – e dokumentuar
Identifikuesit e plotë në shtresat GIS të dorëzuara	P-71409044-01403-2 dhe P-71409044-01403-9	Hartat tematike – mospërputhje e regjistruar si çështje e hapur
Sipërfaqja e matur e projektit	5.094 m²	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Shkalla e situacionit	1:750	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Numri i pikave kufitare	10 pika me koordinata të listuara	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar

Elementi	Të dhëna	Burimi dhe statusi
Lënda / numri i projektit gjeodezik	S/2026	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Gjeodeti i licencuar	Florent Retkoceri, licencë nr. 182	Situacioni gjeodetik – e dokumentuar
Qasja	Qasje e drejtpërdrejtë nga rruga Bajram Gashi, e lidhur me R-120	Ortofoto dhe vrojtim – e dokumentuar
Përdorimi zonal	Zonë komerciale sipas Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit 2021–2029	Material hartografik komunal – kërkon konfirmim zyrtar


Burimi: Situacioni i terrenit i datës 17.08.2026, hartat tematike të dorëzuara dhe dokumentet e biznesit.

3.2. Skicën dhe planimetrinë e vendndodhjes së projektit

Situacioni gjeodetik me ortofoto është burimi kryesor për kufirin hapësinor të projektit. Ai paraqet zonën kadastrale, njësitë kadastrale, sipërfaqen e përbashkët prej 5.094 m², objektet ekzistuese, dhjetë pikat kufitare me koordinata, shkallën 1:750, legjendën, datën e rilevimit dhe të dhënat identifikuese të gjeodetit të licencuar.

Dokumenti burimor duhet lexuar në shkallën e tij origjinale. Meqë raporti është në format A4, paraqitja grafike e situacionit është e zvogëluar dhe nuk lejon nxjerrjen e dimensioneve me matje mbi faqe. Për këtë arsye koordinatat e pikave kufitare janë riparaqitur në tabelë të veçantë, në mënyrë që të mbeten të lexueshme gjatë printimit, kontrollit administrativ dhe verifikimit të pavarur.

Kufiri i projektit, i paraqitur me vijë të kuqe, dallohet nga kufiri kadastral i paraqitur me vijë të gjelbër. Ky dallim është thelbësor për vlerësimin: kufiri i projektit përcakton zonën ku zbatohen masat, ku kryhet monitorimi dhe ku ndalohet çdo magazinim jashtë. Çdo projekt ndërtimor ose planimetri zbatuese duhet të përdorë matjet origjinale të gjeodetit dhe jo dimensione të nxjerra nga figurat e këtij raporti.



Harta 4. Situacioni i terrenit me ortofoto, kufirin e projektit dhe objektet ekzistuese

Burimi: Situacioni i terrenit, ZK Lipjan, njësitë kadastrale 1402-2 dhe 1402-9, lënda S/2026, shkalla 1:750; rilevuar nga Florent Retkoceri, licencë nr. 182, më 17.08.2026.

Tabela 17. Koordinatat e pikave kufitare sipas situacionit gjeodetik

Nr. i pikës	Y	X	Përshkrimi
1	7511123.515	4708857.486	Pikë kufitare e parcelës
2	7511136.485	4708861.227	Pikë kufitare e parcelës
3	7511154.504	4708821.517	Pikë kufitare e parcelës
4	7511180.582	4708761.146	Pikë kufitare e parcelës
5	7511204.051	4708710.005	Pikë kufitare e parcelës
6	7511194.001	4708706.356	Pikë kufitare e parcelës
7	7511188.691	4708702.718	Pikë kufitare e parcelës
8	7511175.350	4708693.580	Pikë kufitare e parcelës
9	7511147.420	4708759.990	Pikë kufitare e parcelës
10	7511110.240	4708853.660	Pikë kufitare e parcelës

Burimi: Lista e koordinatave të pikave të matura, e paraqitur në situacionin e terrenit të datës 17.08.2026. Sistemi referues i koordinatave nuk është deklaruar në dokumentin burimor; ai përcaktohet në kopjen e planit me koordinata në sistemin KosovaRef, të lëshuar nga institucioni kadastral kompetent.

Vlerat e koordinatave janë bartur pa ndryshim nga dokumenti burimor. Shtojca III e UA-së nr. 04/2025 dhe neni 13 i Ligjit nr. 08/L-181 kërkojnë shprehimisht kopjen e planit me koordinata në sistemin KosovaRef; prandaj deklarimi i sistemit referues në dokumentin kadastral është kusht formal i dosjes dhe është regjistruar si çështje e hapur.

Sipas deklarimit plotësues të aplikuesit, brenda kufirit ekzistues planifikohen dy zgjerime: zgjerimi i objektit të autoservisit me 550 m² dhe ndërtimi i garazhit/depos me 730 m². Sipërfaqja e re e planifikuar është 1.280 m² gjithsej dhe përfshihet brenda kufirit të projektit prej 5.094 m².

Tabela 18. Sipërfaqet e planifikuara të zgjerimit

Komponenti	Sipërfaqja e planifikuar	Pozita sipas skicës	Statusi i të dhënës
Zgjerimi i objektit të autoservisit	550 m²	Zona e kufizuar me vijë të verdhë	E deklaruar nga aplikuesi; verifikohet në projektin zbatues
Garazhi dhe depoja	730 m²	Zona e kufizuar me vijë të kaltër	E deklaruar nga aplikuesi; verifikohet në projektin zbatues
Gjithsej sipërfaqe e re e planifikuar	1.280 m²	Brenda kufirit të projektit	Shumë aritmetike; brenda sipërfaqes prej 5.094 m²
Pjesa e mbetur e lokacionit	3.814 m²	Qarkullim, radhitje, manipulim dhe zona funksionale	Vlerë e prejardhur: 5.094 m² − 1.280 m²

Burimi: Deklarimi plotësues i aplikuesit dhe situacioni gjeodetik i datës 17.08.2026.

Vlera prej 3.814 m² është e prejardhur me zbritje nga sipërfaqja e matur dhe përfaqëson hapësirën që mbetet për qarkullim, radhitje, manipulim dhe zona funksionale të hapura pas realizimit të zgjerimeve. Ajo nuk përfaqëson matje të pavarur dhe do të saktësohet me planimetrinë e aprovuar; megjithatë, ajo tregon se zgjerimet zënë rreth një të katërtën e sipërfaqes së lokacionit, gjë që kufizon në mënyrë të ndjeshme hapësirën e disponueshme për magazinim të jashtëm.




Figura 1. Organizimi aktual i kompleksit dhe zonat e planifikuara të zgjerimit

Burimi: Skica e ofruar nga aplikuesi, e interpretuar së bashku me situacionin gjeodetik; gjurma dhe dimensionet përfundimtare përcaktohen në projektin zbatues të aprovuar.

Skica paraqet objektin ekzistues me etazhitet P+3, zonën e verdhë të zgjerimit të autoservisit, zonën e kaltër të garazhit/depos me objektin P+0 dhe drejtimin e qarkullimit të brendshëm të shënuar me shigjetë të gjelbër. Rruga e brendshme kalon nën pjesën e zgjeruar të objektit dhe lidh zonën e autoservisit me garazhin e depon e planifikuar.

Në pjesën jugore të figurës dallohet qartë radhitja e dendur e automjeteve dhe e pjesëve përgjatë kufirit lindor të parcelës. Kjo pamje ka rëndësi për tri kapituj të mëvonshëm: përcakton ngarkesën vizuale të vlerësuar në pikën 6.18, sipërfaqen e ekspozuar ndaj reshjeve të trajtuar në pikën 6.7 dhe nevojën për kufizim të stokut të përcaktuar në masat e Kapitullit 7.




Figura 2. Zgjerimi i kompleksit dhe rruga


3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi

Lokacioni ndodhet në një korridor me përdorim të përzier, ku ndërthuren objekte biznesi, ndërtesa banimi dhe parcela të hapura. Harta e distancave e dorëzuar paraqet distancat vijëdrejta nga zona e projektit deri te disa pika orientuese: një pikë e vendbanimit në Lipjan, një xhami, një pikë e vendbanimit Banullë dhe një kishë.

Këto distanca përshkruajnë raportin me qendrat e vendbanimeve dhe me objektet orientuese, por ato nuk përcaktojnë receptorin kritik. Fotografitë e terrenit dhe ortofotoja tregojnë se në afërsi të drejtpërdrejtë të zonës operative ndodhen objekte të shfrytëzuara, përfshirë një ndërtesë shumëkatëshe menjëherë pranë kufirit. Për

vlerësimin e zhurmës, të pluhurit, të erës dhe të trafikut, receptor kritik konsiderohet objekti i përdorur më i afërt dhe jo qendra e vendbanimit.

Distanca e saktë horizontale nga kufiri i projektit deri te fasada e objektit të banuar ose të përdorur më të afërt nuk figuron në asnjë dokument të dorëzuar. Kjo vlerë kërkohet për dimensionimin e masave akustike dhe për zgjedhjen e pikës së matjes te receptori; ajo mund të nxirret me matje GIS mbi ortofoton e gjeoreferencuar ose me matje gjeodetike të dedikuar dhe është regjistruar si çështje e hapur.



Harta 5. Distancat orientuese ndaj vendbanimeve dhe objekteve orientuese

Burimi: Harta e distancave e dorëzuar nga aplikuesi; distancat janë vijëdrejta dhe hartografike, jo matje gjeodetike të kontrolluara.

Tabela 19. Distancat orientuese ndaj receptorëve të paraqitur në hartë

Receptori	Distanca e paraqitur	Drejtimi	Rëndësia për vlerësimin
Pikë e vendbanimit në Lipjan	rreth 470 m	Perëndim – veriperëndim	Referencë për ekspozimin e zonës së banuar kompakte
Xhami	rreth 963 m	Jugperëndim	Objekt orientues; statusi si aset i mbrojtur nuk është vërtetuar
Pikë e vendbanimit Banullë	rreth 1.147 m	Lindje – juglindje	Referencë për drejtimin e erës dominante juglindore
Kishë	rreth 1.369 m	Veriperëndim	Objekt orientues; statusi si aset i mbrojtur nuk është vërtetuar
Objekte biznesi dhe banimi në afërsi të drejtpërdrejtë	Ngjitur ose në afërsi të drejtpërdrejtë	Verilindje dhe veriperëndim	Receptor kritik për zhurmën, pluhurin, erën dhe trafikun; distanca e saktë kërkon matje

Burimi: Harta e distancave e dorëzuar nga aplikuesi dhe vrojtimi i ortofotos e i fotografive të terrenit.

Krahasimi i rreshtit të fundit me katër rreshtat e parë tregon pse distancat hartografike nuk mjaftojnë. Ndërsa qendrat e vendbanimeve ndodhen në qindra metra, objektet e përdorura fqinje janë praktikisht ngjitur me zonën operative. Prandaj vlerësimi i ekspozimit njerëzor në Kapitullin 6 bazohet te ky receptor i afërt, ndërsa distancat e mësipërme shërbejnë vetëm për kontekst hapësinor.



Figura 3. Gjendja aktuale e hyrjes, e oborrit dhe e zonës operative me automjete e pjesë të ruajtura

Burimi: Fotografi të terrenit të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026; data, pozicioni dhe drejtimi i fotografimit duhet të plotësohen në shtojcë.

Fotografitë dëshmojnë tri karakteristika me rëndësi për vlerësimin: sipërfaqja operative është kryesisht e shtruar por me pjesë të hapura; automjetet dhe pjesët ruhen në hapësirë të jashtme dhe në kontakt të drejtpërdrejtë me reshjet; dhe objektet e afërta ndodhen brenda fushëpamjes së zonës së magazinimit. Këto tri gjetje përsëriten në gjendjen bazë të Kapitullit 4 dhe janë bazë për masat e Kapitullit 7.

3.4. Paraqitjen e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Karakteristikat e terrenit përcaktojnë ndjeshmërinë e mjedisit pritës ndaj rrjedhjeve të lëngjeve dhe kushtëzojnë zgjidhjet teknike të sipërfaqeve dhe të drenazhimit. Për këtë arsye ato trajtohen këtu jo si përshkrim gjeografik i përgjithshëm, por si element që lidhet me rrugën e mundshme të ndotjes nga sipërfaqja drejt nëntokës.

Burimet e disponueshme janë harta tematike në shkallë rajonale. Ato lejojnë përshkrim cilësor të njësive pedologjike e gjeologjike, por nuk lejojnë përcaktimin e trashësisë së shtresave, të përshkueshmërisë, të nivelit të ujit nëntokësor ose të parametrave gjeoteknikë. Ky kufizim deklarohet në secilën nënpikë dhe lidhet me kërkesat për studime specifike aty ku ato bëhen të detyrueshme.

Në dosjen e dorëzuar nuk ka shpime, piezometra, prova përshkueshmërie, mostra toke ose studim gjeoteknik për parcelën. Prandaj vlerësimet e mëposhtme janë vlerësime kujdesi: aty ku mungon matja, mjedisi pritës trajtohet si potencialisht i ndjeshëm dhe masat dimensionohen për skenarin më të pafavorshëm të arsyeshëm.


3.4.1. Pedologjia dhe përdorimi i tokës

Harta pedologjike e dorëzuar e vendos parcelën në zonën e ulët fushore të Lipjanit, në kontakt me njësi pedologjike të hartëzuara në nivel rajonal. Harta është e përshtatshme për përshkrim të përgjithshëm të tipit të tokës, por jo për përcaktimin e trashësisë së horizonteve, të përshkueshmërisë ose të shkallës së ndotjes brenda parcelës.

Përdorimi aktual i sipërfaqes brenda kufirit të projektit është komercial dhe shërbyes. Sipërfaqja operative është pjesërisht e shtruar me elemente betoni dhe pjesërisht e hapur, me skaje me tokë të pambuluar. Brenda kufirit

nuk zhvillohet veprimtari bujqësore aktive dhe nuk ka kultura të mbjella; toka bujqësore shfaqet në parcela përreth, jashtë kufirit të projektit.

Pasoja praktike e kësaj gjendjeje është se pjesët e pashtruara përbëjnë rrugë të drejtpërdrejtë infiltrimi për çdo pikim ose derdhje. Prandaj kërkesa për sipërfaqe të papërshkueshme nuk zbatohet për tërë lokacionin, por përqendrohet te zonat me rrezik: pranimi, servisi, karantina, magazinimi i lëngjeve dhe zona e mbeturinave të rrezikshme.



Harta 6. Pozita e projektit në hartën pedologjike të zonës


Burimi: Hartë tematike pedologjike e dorëzuar për projektin; emërtimi përfundimtar i njësisë verifikohet me metadatat e shtresës burimore.

3.4.2. Gjeomorfologjia dhe gjeologjia

Terreni është kryesisht i rrafshët deri lehtësisht i pjerrët dhe i takon fushëgropës së Kosovës. Nuk janë vërejtur prerje të reja të terrenit, gurore, shpate të larta ose fenomene të dukshme rrëshqitjeje brenda parcelës. Kjo morfologji e thjeshtë kufizon rrezikun e erozionit dhe të paqëndrueshmërisë, por njëkohësisht ngadalëson rrjedhjen sipërfaqësore dhe rrit kohën e kontaktit të ujërave atmosferike me sipërfaqet operative.

Sipas hartës gjeologjike tematike të dorëzuar, zona e projektit bie në njësinë e paraqitur si proluvium, pra depozitime relativisht të reja të materialit të transportuar nga shpatet dhe nga rrjedhjet episodike. Depozitimet proluviale karakterizohen zakonisht nga heterogjenitet i lartë granulometrik dhe nga përshkueshmëri e ndryshueshme.

Kjo veçori ka rëndësi të drejtpërdrejtë mjedisore: në një mjedis të pakonsoliduar dhe heterogjen, një derdhje e paizoluar mund të migrojë më shpejt në thellësi sesa në një substrat argjilor kompakt. Prandaj vlerësimi i rrezikut për tokën dhe ujërat nëntokësore në Kapitullin 6 trajtohet me parimin e kujdesit, edhe pse mungojnë të dhënat e drejtpërdrejta të përshkueshmërisë.



Harta 7. Pozita e projektit në hartën gjeologjike të zonës

Burimi: Hartë tematike gjeologjike e dorëzuar për projektin; shkalla rajonale nuk lejon projektim gjeoteknik.

3.4.3. Hidrogjeologjia

Në materialet e dorëzuara nuk ka shpime, piezometra, nivele të matura të ujit nëntokësor, prova përshkueshmërie ose analiza të cilësisë së ujërave nëntokësore për parcelën. Rrjedhimisht, as thellësia e nivelit ujëmbajtës, as drejtimi i rrjedhjes nëntokësore nuk mund të përcaktohen në këtë raport.

Duke qenë se terreni është fushor dhe i ndërtuar nga depozitime të reja të pakonsoliduara, prania dhe lëvizja e ujërave nëntokësore duhet të konsiderohen si receptor potencialisht i ndjeshëm ndaj rrjedhjeve të vajrave dhe të lëngjeve teknike. Ky konstatim është vlerësim profesional kujdesi dhe jo rezultat i një matjeje hidrogjeologjike të parcelës.

Pasoja për projektin është e qartë: mbrojtja e ujërave nëntokësore realizohet me kontroll në burim – sipërfaqe të papërshkueshme, mbajtje sekondare, enë të mbyllura dhe reagim i shpejtë ndaj derdhjeve – dhe jo me mbështetje te aftësia vetëpastruese e mjedisit. Nëse autoriteti kërkon monitorim të ujërave nëntokësore, ndërtimi i të paktën një piezometri kontrolli do të ishte parakusht teknik.

3.4.4. Sizmologjia

Dokumentacioni i projektit nuk përmban mikrozonim sizmik, studim gjeoteknik të lokacionit ose raport të kategorisë së terrenit. Prandaj ky raport nuk cakton parametra sizmikë projektues dhe nuk vlerëson përshtatshmërinë strukturore të objekteve ekzistuese.

Për objektet ekzistuese dhe për të dy zgjerimet e planifikuara zbatohen kërkesat e projektimit dhe të sigurisë strukturore që rrjedhin nga legjislacioni i ndërtimit në fuqi. Rreziku sizmik duhet të trajtohet në dokumentacionin ndërtimor dhe gjeoteknik, veçanërisht për garazhin/depon e planifikuar dhe për raftet e larta të magazinimit të pjesëve të rënda.

Nga këndvështrimi mjedisor, rreziku sizmik lidhet me tri pasoja dytësore: rrëzimin e rafteve dhe të pjesëve të rënda, dëmtimin e enëve me lëngje teknike dhe ndërprerjen e furnizimit me energji. Për këtë arsye, ankorimi i rafteve, kufizimi i lartësisë së stokut dhe mbajtja sekondare e enëve janë masa që shërbejnë njëkohësisht për sigurinë në punë dhe për parandalimin e ndotjes në rast tërmeti.

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Uji për nevoja sanitare merret nga sistemi publik i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit që mbulon Komunën e Lipjanit. Sipas deklarimit të aplikuesit, uji përdoret për nyjat sanitare dhe për pastrim të kufizuar; në lokacion nuk zhvillohet asnjë proces industrial me konsum të vazhdueshëm uji dhe uji nuk përdoret si lëndë e parë teknologjike.

Për vlerësimin mjedisor kanë rëndësi katër të dhëna që aktualisht mungojnë: numri i konsumatorit dhe dëshmia e kyçjes, prania dhe leximi i matësit, konsumi mesatar mujor në m³ dhe distanca e lokacionit nga çdo zonë e mbrojtjes sanitare të burimeve ujore. Pa këto të dhëna nuk mund të përcaktohet as ngarkesa e projektit mbi rrjetin, as sasia e ujërave të zeza sanitare që gjenerohen.

Në lokacion nuk është deklaruar shpim, pus individual ose burim tjetër i pavarur furnizimi. Nëse në të ardhmen do të shfrytëzohej ujë nëntokësor për ndonjë qëllim – përfshirë larjen e pjesëve – kjo do të përbënte ndryshim të projektit, do të kërkonte leje ujore sipas Ligjit nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës dhe do të ndryshonte tërësisht bilancin e ujërave të ndotura të vlerësuar në Kapitullin 6.

Tabela 20. Furnizimi me ujë dhe të dhënat që kërkohen për ta plotësuar bilancin

Elementi	Gjendja e deklaruar	Të dhëna që kërkohen
Burimi i furnizimit	Sistemi publik i KRU-së për Komunën e Lipjanit	Kontrata ose numri i konsumatorit dhe dëshmia e kyçjes
Përdorimi	Nevoja sanitare dhe pastrim i kufizuar	Ndarja e konsumit sanitar nga ai i pastrimit, kur është e mundur
Matja e konsumit	Nuk është paraqitur lexim i matësit	Leximi mujor në m³ për të paktën 12 muaj
Larja e pjesëve	Nuk deklarohet si proces i rregullt	Deklarim i shprehur; nëse kryhet, kërkohet mbledhje dhe trajtim i veçantë i ujërave
Burime të pavarura uji	Nuk janë deklaruar shpime ose puse	Konfirmim me shkrim; çdo shfrytëzim i ri kërkon leje ujore
Zonat e mbrojtjes sanitare	Nuk janë identifikuar në materialet e dorëzuara	Verifikim me autoritetin e ujërave për praninë e zonave mbrojtëse në afërsi

Burimi: Deklarimet e aplikuesit; kërkesat e pikës 1.4 të nenit 7 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Sipas deklarimit të aplikuesit, ujërat fekale nga nyjat sanitare shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të vendbanimit; dëshmia e kyçjes duhet të jetë pjesë e dosjes përfundimtare. Ky shkarkim nuk duhet të përzihet në asnjë rrethanë me vajra, karburante, antifriz, lëngje frenash, ujëra nga larja e pjesëve ose materiale absorbuese të kontaminuara; kufijtë dhe kushtet e shkarkimit në rrjetin publik të kanalizimit rregullohen me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) nr. 02/2022.

3.6. Paraqitjen e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Komuna e Lipjanit ka klimë kontinentale të Kosovës qendrore, me dimra të ftohtë dhe vera të ngrohta e relativisht të thata. Treguesit e mëposhtëm janë vlera mesatare komunale ose rajonale të raportuara në dokumentet zyrtare dhe përdoren si kontekst afatgjatë; ato nuk janë seri matjesh brenda parcelës dhe nuk mund të përdoren për modelim ose dimensionim teknik pa seritë origjinale të stacionit meteorologjik.

Për këtë projekt, treguesit klimatikë nuk kanë vlerë përshkruese, por operative. Reshjet përcaktojnë vëllimin e ujërave atmosferike që kontaktojnë sipërfaqet operative dhe stokun e ruajtur jashtë; lagështia ndikon në korrozion dhe në kushtet e magazinimit; drejtimi dhe shpejtësia e erës përcaktojnë drejtimin e mundshëm të përhapjes së pluhurit, të erës dhe të mjegullës së bojës; temperaturat e larta rrisin avullimin e tretësve dhe rrezikun nga zjarri.

Tabela 21. Treguesit klimatikë dhe rëndësia e tyre për lokacionin

Treguesi	Vlera e raportuar	Rëndësia për projektin
Temperatura mesatare vjetore	10,0 – 10,5 °C	Ndikon në avullimin e tretësve, në kushtet e punës dhe në ruajtjen e materialeve
Reshjet mesatare vjetore	rreth 673,3 mm	Përcakton vëllimin e ujërave atmosferike që kontaktojnë sipërfaqet dhe stokun e jashtëm
Lagështia relative mesatare	rreth 74,7 %	Ndikon në korrozionin e pjesëve metalike dhe në kushtet e magazinimit
Shkëlqimi diellor mesatar vjetor	rreth 2.018 orë	Ekspozim sezonal i sipërfaqeve dhe i enëve; rrit avullimin dhe rrezikun nga zjarri
Era me shpejtësinë mesatare më të lartë	juglindje, rreth 4,0 m/s	Përcakton drejtimin kryesor të mundshëm të përhapjes së pluhurit dhe të erës

Burimi: Dokumentet dhe materialet zyrtare komunale për Komunën e Lipjanit; Vjetari Hidrometeorologjik i Kosovës si referencë kombëtare.

Drejtimi juglindor i erës dominante ka pasojë praktike për pozicionimin e monitorimit: receptorët në drejtimin veriperëndimor nga lokacioni janë ata që me shumë gjasë do të ndikohen nga pluhuri dhe nga erërat e procesit. Kjo merret parasysh në përcaktimin e pikave të matjes të Kapitullit 8.

> Vlerat e paraqitura janë përdorur si kontekst afatgjatë komunal dhe jo si matje mikroklimatike në parcelë. Për modelim të shpërndarjes së ndotësve, për dimensionim të drenazhimit ose për llogaritje të ngarkesës së reshjeve kërkohen seria e stacionit meteorologjik përkatës, periudha e mesatarizimit, plotësia e serisë dhe burimi zyrtar i çdo parametri. Këto të dhëna nuk gjenden në dosjen aktuale.

3.7. Prezantimi i karakteristikave natyrore

Zona e projektit është e urbanizuar dhe periurbane, e transformuar nga rruga, objektet komerciale, oborret e shtruara dhe magazinimi i automjeteve. Brenda kufirit operativ nuk janë identifikuar habitate natyrore të paprekura, sipërfaqe pyjore, ligatina, grykëderdhje ose bashkësi të veçanta bimore. Mbulesa e gjelbër mbetet kryesisht në skajet e parcelës dhe në parcelat e pazhvilluara përreth.

Vlerat natyrore më të njohura në territorin e Komunës së Lipjanit – Ligatina e Hencit–Radevës, kompleksi i Blinajës dhe Shpella e Gadimes – nuk paraqiten brenda zonës së projektit në asnjë nga hartat e dorëzuara dhe nuk ndodhen në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit. Prandaj nuk identifikohet ndikim i drejtpërdrejtë fizik mbi zona të mbrojtura natyrore.

Në lokacion nuk është kryer inventar sezonal i florës dhe i faunës. Për këtë arsye, mungesa e vrojtimit të specieve të rralla nuk barazohet me vërtetim shkencor të mungesës së tyre. Libri i Kuq i Florës Vaskulare dhe Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës përdoren si burime kontrolli për statusin e ruajtjes së llojeve që mund të jenë potencialisht të pranishme në habitate të ngjashme periurbane, por asnjë lloj nuk deklarohet i pranishëm në lokacion vetëm sepse figuron në këto burime.

3.8. Rishikimi i karakteristikave themelore të peizazhit

Peizazhi lokal është mozaik periurban: rrugë rajonale dhe lokale, objekte shërbyese e tregtare, ndërtesa banimi shumëkatëshe, parcela të hapura dhe sipërfaqe bujqësore ose të pazhvilluara në skaj. Nuk ka forma reliefi dominuese, pika panoramike të mbrojtura ose korridore vizuale me vlerë të veçantë të njohur.

Brenda kufirit të projektit, pamja dominohet nga oborri i shtruar, nga automjetet e radhitura dhe nga pjesët e ekspozuara. Dukshmëria nga rruga Bajram Gashi është e lartë, sepse kufiri perëndimor i parcelës është praktikisht i hapur ndaj korridorit rrugor. Rrjedhimisht, gjendja vizuale e oborrit nuk është çështje estetike e brendshme, por pjesë e drejtpërdrejtë e peizazhit të korridorit.

Ndjeshmëria e peizazhit vlerësohet e ulët deri e mesme: zona tashmë ka karakter të përzier tregtar dhe nuk ka cilësi peizazhore të mbrojtura. Megjithatë, dendësia dhe lartësia e stokut përcaktojnë nëse kompleksi lexohet si veprimtari e organizuar shërbimi apo si zonë grumbullimi. Ky dallim është vlerësuar në pikën 6.18 dhe trajtohet me masat e renditjes, të kufizimit të lartësisë dhe të ekranimit të përcaktuara në Kapitullin 7.

3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Brenda kufirit të projektit nuk është identifikuar asnjë objekt i mbrojtur i trashëgimisë kulturore ose historike, asnjë strukturë me vlerë arkitekturore të njohur dhe asnjë element arkeologjik i regjistruar. Sipërfaqja është e transformuar nga veprimtaria ekzistuese dhe nuk përmban ndërtime historike.

Harta e distancave paraqet një xhami në rreth 963 m dhe një kishë në rreth 1.369 m si objekte orientuese. Statusi i tyre juridik si asete nën mbrojtje nuk është vërtetuar nga dokumentacioni i dorëzuar; ato janë përdorur në raport vetëm si pika orientimi hapësinor dhe si receptorë socialë të mundshëm, jo si asete të mbrojtura.

Kontrolli përfundimtar i statusit të mbrojtjes duhet të bëhet në Listën e Trashëgimisë Kulturore nën mbrojtje dhe, kur kërkohet nga procedura, me konfirmim nga institucioni kompetent për trashëgiminë kulturore. Meqë distancat janë të konsiderueshme dhe projekti nuk përfshin gërmime të thella apo ndërhyrje jashtë parcelës, rreziku për trashëgiminë vlerësohet i papërfillshëm; megjithatë, në rast të zbulimit të rastësishëm të gjetjeve arkeologjike gjatë punimeve, punimet duhet të ndërpriten dhe institucioni kompetent të njoftohet menjëherë.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Sipas Profilit të Komunës së Lipjanit të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës në korrik 2026, i bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024, komuna ka 55.044 banorë. Krahasuar me vitin 2011, kur numri i banorëve ishte 57.605, popullsia ka shënuar rënie prej rreth 4,4 %.

Ndryshimi më i rëndësishëm për këtë vlerësim nuk është rënia e përgjithshme, por rishpërndarja hapësinore. Pjesa urbane e popullsisë është rritur nga 11,9 % në 23,8 %, ndërsa dendësia urbane është rritur nga 1.524 në 2.905 banorë/km². Njëkohësisht, numri i njësive të banimit është rritur nga 13.647 në 19.434. Kjo do të thotë se zona periurbane ku ndodhet lokacioni ka gjasa të vazhdojë të dendësohet me banim dhe me veprimtari shërbyese.

Tabela 22. Treguesit demografikë të Komunës së Lipjanit

Treguesi demografik	2011	2024	Ndryshimi
Popullsia e komunës	57.605	55.044	−2.561 banorë (−4,4 %)
Pjesëmarrja urbane	11,9 %	23,8 %	+11,9 pikë përqindjeje
Pjesëmarrja rurale	88,1 %	76,2 %	−11,9 pikë përqindjeje
Dendësia urbane	1.524 banorë/km²	2.905 banorë/km²	+90,6 %

Treguesi demografik	2011	2024	Ndryshimi
Dendësia rurale	152 banorë/km²	126 banorë/km²	−17,1 %
Njësi banimi	13.647	19.434	+5.787 njësi (+42,4 %)

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Profili i Komunës së Lipjanit, korrik 2026, i bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024.

Kolona e ndryshimit është llogaritur nga vlerat e publikuara dhe paraqitet si vlerë e prejardhur. Përfundimi operativ për projektin është se numri i receptorëve njerëzorë në afërsi ka gjasa të rritet gjatë jetëgjatësisë së veprimtarisë; prandaj masat për zhurmën, pluhurin dhe trafikun nuk duhet të dimensionohen për gjendjen aktuale, por të lejojnë shtrëngim pa ndërhyrje të mëdha.

Profili komunal nuk jep numrin e banorëve brenda një rrezeje të caktuar rreth parcelës dhe një numër i tillë nuk është llogaritur në këtë raport, sepse do të kërkonte të dhëna të gjeoreferencuara të banimit që nuk janë të disponueshme. Receptorët relevantë përcaktohen cilësisht: punëtorët, klientët, kalimtarët, përdoruesit e objekteve fqinje dhe banorët përgjatë korridorit rrugor.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Brenda kufirit të projektit ndodhen objekti kryesor i punës dhe administrimit me etazhitet P+3, objekti P+0 në zonën jugore, sipërfaqet e shtruara për manipulim dhe radhitje, si dhe zonat e hapura të magazinimit. Këto elemente paraqiten në situacionin gjeodetik dhe dëshmohen nga fotografitë e terrenit.

Jashtë kufirit, në afërsi të drejtpërdrejtë, ndodhen objekte biznesi dhe ndërtesa të shfrytëzuara, ndërsa më tej shtrihen parcela të hapura dhe sipërfaqe bujqësore ose të pazhvilluara. Ky kombinim përcakton karakterin e përzier të korridorit dhe shpjegon pse receptorët njerëzorë ndodhen praktikisht në kufi të zonës operative.

Infrastruktura ekzistuese e shërbimeve dëshmohet me dokumente: furnizimi me energji elektrike me faturën e KESCO-s në emër të biznesit dhe shërbimi për mbeturinat komunale me faturën nr. 6856823 të datës 30.06.2026 të KRM “Pastrimi” Sh.A., me identifikuesin e konsumatorit 129776 dhe me kontejner prej 1,1 m³ me dy zbrazje. Furnizimi me ujë dhe kyçja në kanalizim janë deklaruar por nuk janë dëshmuar me dokument.

Tabela 23. Objektet dhe infrastruktura ekzistuese

Elementi	Gjendja e dokumentuar	Burimi i dëshmisë
Objektet në parcelë	Objekt pune dhe administrimi P+3; objekt P+0; sipërfaqe të shtruara dhe zona të hapura për radhitje e manipulim	Situacioni gjeodetik dhe fotografitë e terrenit
Rruga e qasjes	Qasje direkte nga rruga Bajram Gashi, e lidhur me R-120; nuk kërkohet rrugë e re	Ortofoto dhe harta e qasjes
Energjia elektrike	Furnizim nga rrjeti publik; llogari aktive në emër të biznesit	Faturë KESCO për AUTO SELIMI SH.P.K., viti 2026
Ujësjellësi	Furnizim publik për nevoja sanitare	Deklarim i aplikuesit; dëshmia e kyçjes mungon
Kanalizimi	Ujërat fekale shkarkohen në kanalizimin e vendbanimit	Deklarim i aplikuesit; dëshmia e kyçjes mungon
Mbeturinat komunale	Kontejner 1,1 m³ me dy zbrazje sipas faturës	KRM “Pastrimi” Sh.A., faturë nr. 6856823, 30.06.2026, ID 129776
Objektet përreth	Biznese, ndërtesa të shfrytëzuara, parcela të hapura dhe sipërfaqe bujqësore në skaj	Ortofoto dhe fotografitë e terrenit


Burimi: Situacioni gjeodetik, fotografitë e terrenit dhe faturat e shërbimeve të paraqitura në dosjen e raportit.



Figura 4. Gjendja e sipërfaqeve operative dhe e zonave të magazinimit të pjesëve

Burimi: Fotografi të terrenit të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026.

Fotografitë tregojnë se magazinimi i pjesëve zhvillohet kryesisht në hapësirë të jashtme dhe se një pjesë e komponentëve vendoset drejtpërdrejt mbi sipërfaqe të pambuluar. Kjo gjendje është regjistruar si element i gjendjes bazë dhe përcakton dy masa prioritare të Kapitullit 7: mbulimin e komponentëve me lëngje të mbetura dhe ndalimin e kontaktit të drejtpërdrejtë të pjesëve me tokën.



Kompania Rajonale
Regional Company
Regionalna Produzece
"PASTRIMI" SH.A.

Rr. Bill Clinton p.n. PRISHTINË
Tel: 038 603 153 ; 038 603 004; 045 206 908
email: sherbimimeklient@hotmail.com
Nr. Unik 811276957
Nr. TVSH: 330038861

ID:129776 / ID e vjeter:1914
AUTO SELIMI SH.P.K
Bajram Gashi
Lipjan
Bajram Gashi NR.112
NRB:
NRF: 812145119
NRTVSH:
Pronari:

Nr.i Faturës / Invoice No / Br. racuna: 6856823
Muaji / Month / Mesec: Qershor, 2026
Datë / Date / Datum: 30/06/2026

Përshkrimi / Description / Opis	Sasia / Qty / Kol.	Çmimi / Price / Cena	Çmimi pa TVSH / Price without VAT / Cena bez PDV	TVSH / VAT / PDV	Shuma me TVSH / Total with VAT / Total sa PDV
PNR.: 155/25, KM, TAX.:35.40 Në bazë të kontratës, ju faturojmë për shërbimin e kryer me kontejner 1/1 m³ Gjithsej zbrazje:	2.00	10.82	20.04	1.60	21.64

Për pagesë - For payment - Za naplatu: 21.64
Borgji paraprak - Previous due - Prethodni dug: 141.24
Gjithsej borgji - Total Due - Ukupan dug: 162.88

Afati i pagesës-Due date-Rok za pomirenje racuna

Xhirollogaria: NLB 1700200100051292, TEB 2020000050871240, BpB 1300271200114096, BKT 1903550381031161, BE 1401000000896071, RBKO 1501130000355964, PCB 1189002637000108

Kjo faturë është e shtypur nga sistemi i kompjuterizuar për faturim dhe si e tillë nuk ka nevojë për vulë apo nënshkrim.
This invoice is printed by a computerised billing system and therefore does not require a stamp or signature.
Ovaj racun je stampan sa kompjuterizovanog sistema za fakturisanje stoga nije potreban potpis ili pecat.

Faturat mund t'i gjeni dhe t'i paguani edhe në platformën e-Kosova duke shtypur numrin tuaj ID: 129776, ose me numër tuaj të biznesit.

10

Figura 5. Dëshmi dokumentare e shërbimit për mbeturinat komunale

Burimi: KRM "Pastrimi" Sh.A., faturë nr. 6856823, datë 30.06.2026, ID e konsumatorit 129776.

Fatura dëshmon vetëm shërbimin për mbeturinat komunale të përziera. Ajo nuk mbulon vajrat mbeturinë, filtrat, bateritë, antifrizin, lëngjet e frenave, absorbuesit e kontaminuar, gomat ose mbetjet metalike, të cilat kërkojnë operatorë të licencuar të veçantë për secilën rrymë.

3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Nga hartat e dorëzuara dhe nga dokumentet komunale nuk rezulton që parcelat të ndodhen brenda një zone të mbrojtur natyrore, brenda një zone të veçantë të mbrojtur, brenda një vendi arkeologjik të konfirmuar, brenda një zone të përcaktuar për kërkime shkencore ose brenda një zone me qëllime të veçanta. Harta zonale e paraqet zonën si komerciale.

Ky përfundim është rezultat i një kontrolli dokumentar në shkallë plani dhe ka vlerën e një kontrolli paraprak. Ai nuk zëvendëson konfirmimin zyrtar nga regjistrat kompetentë – regjistri i zonave të mbrojtura të natyrës dhe lista e trashëgimisë kulturore – nëse ky konfirmim kërkohet gjatë procedurës administrative nga Komisioni i VNM-së.

Në zonën e projektit dhe në afërsinë e drejtpërdrejtë të saj nuk janë identifikuar as objekte të infrastrukturës sociale me ndjeshmëri të lartë – shkolla, çerdhe, objekte të kujdesit shëndetësor ose institucione për të moshuar.

Nëse gjatë konsultimit publik identifikohet një objekt i tillë brenda zonës së ndikimit të zhurmës ose të pluhurit, vlerësimi i ndjeshmërisë së receptorit duhet të rishikohet dhe masat të shtrëngohen përpara vendimit.





Figura 6. Skicë konceptuale e organizimit funksional të lokacionit sipas zonave të përdorimit

Burimi: Skicë konceptuale e përgatitur për organizimin funksional të lokacionit. Sipërfaqet e zonave janë të përafërta dhe orientuese; kufiri dhe sipërfaqja detyruese janë ato të situacionit gjeodetik të datës 17.08.2026 dhe të projektit zbatues të aprovuar.

Skica konceptuale përcakton dhjetë zona funksionale: parkimi i mjeteve dhe pritja, magazina e pjesëve të përdorura, zona e mirëmbajtjes dhe riparimit, magazina e depozitimit dhe sortimit, zyra administrative, administrata dhe pritja e klientëve, tualeti dhe dhoma e ndërrimit, separatori i vajit dhe ujërave, gropa septike si zgjidhje alternative kur nuk ka lidhje me kanalizim, si dhe vendparkimi i mbeturinave dhe depozitimi i përkohshëm.

Kjo skicë përdoret në raport si mjet organizimi funksional dhe jo si planimetri detyruese. Dy elemente të saj kërkojnë sqarim të shprehur për të shmangur keqkuptimin: shuma e sipërfaqeve të zonave funksionale të paraqitura në skicë është më e vogël se sipërfaqja e përgjithshme e lokacionit, sepse skica nuk përfshin sipërfaqet e qarkullimit dhe hapësirat e lira; dhe gropa septike paraqitet vetëm si alternativë për rastin kur mungon lidhja me kanalizimin, ndërsa gjendja e deklaruar për këtë lokacion është shkarkimi sanitar në rrjetin e kanalizimit të vendbanimit.



Skemë teknike1. Skemë konceptuale e gropës septike të mbyllur dhe të papërshkueshme për menaxhimin alternativ të ujërave sanitare

Skema e mësipërme paraqet një gropë septike të mbyllur dhe të papërshkueshme, e cila konsiderohet vetëm si **zgjidhje alternative për menaxhimin e ujërave sanitare kur lidhja funksionale me rrjetin publik të kanalizimit nuk është e mundur ose ndërpritet**. Në kushtet e deklaruara të projektit, ujërat sanitare parashihen të shkarkohen në rrjetin e kanalizimit të vendbanimit dhe nuk përzihen me ujërat e procesit, vajrat, karburantet, antifrizin, lëngjet teknike apo ujërat nga larja e pjesëve dhe pajisjeve. Në rast të aplikimit të zgjidhjes alternative, gropa septike duhet të jetë hermetike, e papërshkueshme dhe pa shkarkim në tokë ose në


drenazhimin atmosferik; zbrazja kryhet periodikisht nga operator i autorizuar dhe dokumentohet. Skema është konceptuale dhe nuk zëvendëson projektin teknik të sistemit sanitar ose kushtet e autoritetit kompetent.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të saj

Brenda kufirit të projektit nuk është paraqitur lumë, përrua, burim, pus publik ose trup tjetër ujor sipërfaqësor. Harta tematike e rrjedhave ujore paraqet një rrjedhë ujore në lindje deri juglindje të zonës së projektit, si pjesë e rrjetit më të gjerë hidrografik të zonës Lipjan–Banullë–Gllogoc.

Distanca e saktë horizontale nga kufiri i projektit deri te bregu i kësaj rrjedhe nuk është e matur në asnjë dokument të dorëzuar. Kjo vlerë ka rëndësi të drejtpërdrejtë për vlerësimin e rrezikut, sepse përcakton kohën e disponueshme për ndërhyrje në rast derdhjeje dhe nevojën eventuale për pikë monitorimi sipër dhe poshtë pikës së ndikimit. Ajo është regjistruar si çështje e hapur me metodë të përcaktuar zgjidhjeje – matje GIS mbi ortofoton e gjeoreferencuar ose matje gjeodetike.

Lidhja kryesore hidrologjike e lokacionit me mjedisin përreth nuk janë trupat ujorë, por ujërat atmosferike nga sipërfaqet e shtruara dhe nga zonat e jashtme të magazinimit. Dokumentacioni nuk përmban plan të drenazhimit, ndarje të ujërave të pastra nga ato potencialisht të ndotura, separator vajrash, pikë të përcaktuar shkarkimi ose analiza të ujit. Kjo mangësi është boshllëku më i rëndësishëm i të dhënave në gjithë dosjen dhe përcakton prioritetin e parë të masave teknike.



Harta 8. Rrjeti i ujërave sipërfaqësore në raport me zonën e projektit

Burimi: Hartë tematike e rrjedhave ujore e dorëzuar nga aplikuesi; harta nuk përmban matje të cilësisë, të prurjes ose të distancës së kontrolluar.



Harta 9. Situacioni i qasjes në rrjetin e kanalizimit dhe pozita e pusetave (propozim)

Burimi: Material hartografik i përgatitur për projektin mbi ortofoto; skema e paraqitur ka karakter propozimi dhe kërkon konfirmim nga operatori i shërbimit dhe nga Komuna.

Harta e qasjes në kanalizim paraqet trasenë e propozuar dhe pozitat e pusetave. Ajo është material propozues dhe nuk zëvendëson dëshminë e kyçjes. Në të njëjtën hartë parcelat janë etiketuar me identifikuesit P-71409044-01403-2 dhe P-71409044-01403-9, gjë që përsërit mospërputhjen e identifikuesve kadastralë të regjistruar në pikën 3.1 dhe përforcon nevojën për harmonizim me certifikatën e pronës.

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

Ky kapitull paraqet gjendjen bazë të faktorëve mjedisorë para zbatimit të plotë të masave të propozuara dhe para çdo rritjeje të autorizuar të kapacitetit. Meqë veprimtaria është ekzistuese, gjendja bazë nuk është gjendje e paprekur natyrore, por gjendja e një lokacioni komercial në funksion, i lidhur me infrastrukturën publike dhe i rrethuar nga receptorë njerëzorë.

Neni 8 i UA-së nr. 04/2025 kërkon që raporti për gjendjen aktuale të përmbajë edhe përshkrimin e ndryshimeve të mundshme në gjendjen e mjedisit nëse projekti nuk zbatohet. Ky element trajtohet në fund të kapitullit, ndërsa analiza e plotë e alternativës pa veprim zhvillohet në pikën 5.21.

Metodologjia e përdorur kombinon vrojtimin e dokumentuar fotografik, hartat tematike, dokumentet e shërbimeve komunale dhe burimet zyrtare statistikore e mjedisore. Nuk janë dorëzuar matje të akredituara për ajrin, zhurmën, tokën, ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore; prandaj asnjë përfundim i këtij kapitulli nuk paraqitet si përputhshmëri numerike me vlerat kufitare.

4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Gjendja bazë përshkruhet faktor pas faktori, sipas të njëjtës renditje që përdoret në Kapitullin 6 për vlerësimin e ndikimeve. Kjo mundëson krahasim të drejtpërdrejtë ndërmjet gjendjes para dhe presionit të shtuar nga projekti. Për secilin faktor tregohet çfarë është dokumentuar, çfarë mungon dhe si ndikon mungesa në sigurinë e vlerësimit.

Ky raport i gjendjes bazë ka gjithashtu funksion referencial: ai përcakton pikën nga e cila matet çdo ndryshim i ardhshëm. Prandaj fushata e parë e matjeve, e përcaktuar në pikën 8.2, duhet të realizohet sa më shpejt dhe në kushte përfaqësuese të operimit normal, para se ndërhyrjet në drenazhim, në dysheme dhe në organizim të ndryshojnë gjendjen faktike.

Aty ku mungon një rezultat laboratorik, mungesa nuk interpretohet as si mungesë ndikimi, as si prani e ndotjes. Ajo trajtohet si pasiguri e identifikuar, e cila justifikon kontroll më të rreptë në burim, dokumentim fotografik dhe përfshirje të parametrit përkatës në programin e monitorimit.

4.1.1. Ajri

Lokacioni ndodhet pranë një rruge me trafik dhe brenda një zone komerciale. Burimet ekzistuese të presionit mbi ajrin janë trafiku rrugor në rrugën Bajram Gashi dhe R-120, ndezja dhe lëvizja e automjeteve brenda lokacionit, pluhuri nga sipërfaqet e pambuluara, punët e bluarjes dhe të saldimit, si dhe emetimet e kufizuara të përbërjeve organike të avullueshme nga përgatitja e sipërfaqes dhe lyerja.

Në terren nuk është dokumentuar oxhak industrial, kaldajë me kapacitet të konsiderueshëm ose proces djegieje i vazhdueshëm i lidhur me projektin. Burimi më i rëndësishëm i palëvizshëm është kabina/furra e lyerjes, e cila trajtohet si burim i palëvizshëm i shkarkimeve në ajër dhe i nënshtrohet rregullave të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr. 07/2021, sipas zbatueshmërisë dhe kushteve të autoritetit.

Nuk ekziston asnjë seri matjesh për PM_{10}, $PM_{2,5}$, NO_2, CO, benzen, VOC ose depozitim pluhuri në kufirin e parcelës apo te receptori më i afërt. Raporti vjetor kombëtar për cilësinë e ajrit nuk përmban stacion matës të dedikuar për Lipjanin; prandaj të dhënat kombëtare shërbejnë vetëm si kontekst dhe nuk përdoren si vlera të lokacionit.

4.1.2. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore

Brenda parcelës nuk është evidentuar trup ujor sipërfaqësor. Një rrjedhë ujore paraqitet në afërsi lindore–juglindore sipas hartës tematike; gjendja kimike dhe ekologjike e saj nuk është matur për këtë raport dhe distanca deri te ajo nuk është e kontrolluar.

Për ujërat nëntokësore nuk ekzistojnë të dhëna as për nivelin, as për drejtimin e rrjedhjes, as për cilësinë. Ujërat fekale dërgohen në kanalizimin e vendbanimit sipas deklarimit të aplikuesit; nuk është dokumentuar asnjë shkarkim i autorizuar i ujërave teknologjike dhe nuk është deklaruar proces që i gjeneron ato.

Elementi më i rëndësishëm i gjendjes bazë për këtë faktor është faktik dhe i dokumentuar me fotografi: automjetet dhe pjesët ruhen në hapësirë të jashtme dhe kontakti i tyre me reshjet është i vazhdueshëm. Në mungesë të një skeme drenazhimi dhe të një separatori, ujërat atmosferike që kalojnë mbi këto sipërfaqe përbëjnë rrugën reale dhe aktuale të mundshme të ndotjes drejt tokës dhe rrjedhës së afërt.

4.1.3. Toka dhe nëntoka

Sipërfaqja e oborrit është kryesisht e shtruar me elemente betoni, por përmban edhe pjesë të hapura dhe skaje me tokë të pambuluar. Në fotografitë e disponueshme nuk dallohet një ndotje e verifikueshme vizualisht në shkallë të gjerë; megjithatë, prania e automjeteve të çmontuara pjesërisht, e motorëve dhe e komponentëve mekanikë krijon nevojë të arsyeshme për kontroll të historikut të rrjedhjeve.

Nuk janë dorëzuar mostra të tokës për hidrokarbure totale, BTEX, metale të rënda ose parametra të tjerë. Prandaj gjendja bazë e tokës mbetet e pakonfirmuar analitikisht dhe nuk mund të krahasohet me vlerat kufitare të legjislacionit.

Pasoja praktike e kësaj mungese është juridike po aq sa teknike: pa mostrim bazë nuk mund të ndahet ndotja historike, e cila i përket periudhës para vlerësimit, nga çdo ndotje e mëvonshme e lidhur me operimin e autorizuar. Për këtë arsye, mostrimi i tokës në pikat me rrezik përpara zbatimit të ndërhyrjeve është në interes të drejtpërdrejtë të vetë operatorit.

4.1.4. Zhurma dhe vibrimet

Klima akustike aktuale përcaktohet nga trafiku në rrugën Bajram Gashi, nga lëvizja dhe manovrimi i automjeteve brenda lokacionit, nga veprimtaritë komerciale përreth dhe nga puna mekanike në zonë. Receptorët kryesorë janë objektet e afërta të përdorura dhe përdoruesit e rrugës.

Nuk ekzistojnë matje të nivelit të zhurmës për periudhën e ditës dhe të natës, nuk ka hartë izofonike dhe nuk ka inventar të burimeve me fuqi akustike të deklaruar. Prandaj nuk mund të vlerësohet përputhshmëria me vlerat kufitare të përcaktuara sipas Ligjit nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma dhe akteve përkatëse.

Vibrime të vazhdueshme industriale nuk janë dokumentuar dhe nuk priten, sepse në lokacion nuk ka makineri të rëndë me punë të vazhdueshme. Vibrimet e identifikueshme janë të shkurtra dhe lokale dhe lidhen me veglat pneumatike, me kompresorin dhe me manipulimin e pjesëve të rënda.

4.1.5. Klima dhe ekspozimi ndaj rreziqeve klimatike

Gjendja klimatike karakterizohet nga ndryshime të theksuara sezonale, nga reshje vjetore rreth 673,3 mm dhe nga verë e ngrohtë me insolacion të lartë. Sipërfaqet e jashtme dhe stoku i ruajtur në to janë të ekspozuara plotësisht ndaj reshjeve, ngricës, nxehtësisë dhe rrezatimit diellor.

Terreni fushor dhe prania e rrjetit të rrjedhave në afërsi kërkojnë që në gjendjen bazë të dokumentohet sjellja e ujërave gjatë reshjeve intensive: ku grumbullohet uji, ku rrjedh dhe ku del nga parcela. Ky dokumentim nuk ekziston dhe nuk është dorëzuar as studim i rrezikut nga vërshimet për parcelën.

Ekspozimi klimatik i lokacionit vlerësohet i moderuar, por jo i papërfillshëm. Ngjarjet me intensitet të lartë – shi i rrëmbyeshëm, valë të nxehti ose erëra të forta – janë ngjarjet që shndërrojnë një rrezik latent, si një enë e paizoluar ose një pjesë me lëng të mbetur, në incident real me shtrirje jashtë kufirit.

4.1.6. Biodiversiteti dhe habitatet

Zona operative është e transformuar dhe ka vlerë të ulët si habitat natyror brenda parcelës. Nuk janë evidentuar habitate kritike, specie të mbrojtura ose korridore ekologjike të konfirmuara brenda kufirit të projektit.

Sipërfaqet e gjelbra në skaje dhe parcelat e hapura përreth mund të shërbejnë si strehë e përkohshme ose vend ushqimi për specie të zakonshme urbane dhe periurbane. Libri i Kuq i Florës Vaskulare dhe Libri i Kuq i Faunës përdoren si burime kontrolli për statusin e ruajtjes, por asnjë lloj nuk deklarohet i pranishëm në lokacion mbi bazën e tyre.

Pa vrojtim biologjik sezonal nuk konfirmohet as prania, as mungesa e llojeve të mbrojtura. Ky kufizim ndikon në sigurinë e vlerësimit vetëm në rastin kur do të hiqej vegjetacioni periferik ose do të ndërhyhej në parcelat e hapura fqinje; për punimet brenda gjurmës së aprovuar, ndikimi i drejtpërdrejtë mbetet i papërfillshëm.

4.1.7. Peizazhi dhe pamja vizuale

Gjendja vizuale aktuale dominohet nga numri i madh i automjeteve, i kabinave dhe i pjesëve të vendosura në oborr dhe përgjatë korridoreve të brendshme. Tabela e biznesit dhe objektet janë të dukshme nga rruga, ndërsa kufiri perëndimor i parcelës është praktikisht i hapur ndaj korridorit rrugor.

Organizimi aktual është funksional për veprimtarinë tregtare, sepse mundëson qasje të shpejtë te stoku. Megjithatë, ruajtja e hapur dhe dendësia e materialeve e bëjnë zonën vizualisht të ngarkuar në krahasim me parcelat e hapura në lindje dhe në jug.

Në gjendjen bazë nuk ekziston as ekranim vizual i vazhdueshëm, as brez gjelbërimi përgjatë kufirit të dukshëm, as kufizim i deklaruar i lartësisë së stokut. Këto tri mungesa përcaktojnë përmbajtjen e masave vizuale të Kapitullit 7 dhe treguesit e pranimit të Kapitullit 9.

4.1.8. Popullsia, shëndeti dhe përdorimet e ndjeshme

Komuna e Lipjanit ka 55.044 banorë sipas Regjistrimit 2024, me përqendrim urban në rritje. Lokacioni ndodhet në zonë periurbane me objekte të shfrytëzuara në afërsi të drejtpërdrejtë; prandaj ekspozimi potencial i njerëzve duhet vlerësuar mbi receptorin më të afërt dhe jo mbi distancën deri te qendra e vendbanimit.

Në dosje nuk ka të dhëna shëndetësore lokale, ankesa të regjistruara nga fqinjët, matje të zhurmës ose të erës te receptori, e as numërim të banorëve brenda një rrezeje të caktuar. Mungesa e ankesave të dokumentuara nuk interpretohet si dëshmi e mungesës së shqetësimit, sepse nuk ekziston as regjistër ku ankesat të mund të ishin evidentuar.

Elementi i vetëm i dokumentuar për këtë faktor është prania fizike e objekteve të përdorura ngjitur me zonën operative, e dëshmuar nga fotografitë dhe ortofotoja. Ky element mjafton për ta klasifikuar ndjeshmërinë e receptorit njerëzor si të mesme deri të lartë për zhurmën, pluhurin dhe erërat gjatë orarit të punës.

4.1.9. Trashëgimia kulturore dhe natyrore

Brenda kufirit të projektit nuk është dokumentuar asnjë aset i mbrojtur i trashëgimisë kulturore ose natyrore. Xhamia dhe kisha e paraqitura në hartën e distancave janë objekte orientuese në distanca prej rreth 963 m dhe rreth 1.369 m; statusi i tyre juridik si asete nën mbrojtje nuk është vërtetuar nga dokumentacioni i dorëzuar.

Zonat natyrore të mbrojtura të njohura të Komunës së Lipjanit nuk paraqiten në afërsi të drejtpërdrejtë të projektit dhe nuk ndodhen brenda zonës së ndikimit të vlerësuar për zhurmën, pluhurin ose ujërat atmosferike.

Rrjedhimisht, gjendja bazë për këtë faktor është e qëndrueshme dhe nuk përmban element që kufizon zhvillimin e veprimtarisë. E vetmja kërkesë që mbetet aktive është detyrimi i njoftimit të menjëhershëm të institucionit kompetent në rast të zbulimit të rastësishëm të gjetjeve arkeologjike gjatë punimeve të zgjerimit.

4.1.10. Infrastruktura, trafiku dhe shërbimet komunale

Gjendja aktuale e infrastrukturës është funksionale: qasje rrugore ekzistuese, furnizim me energji nga rrjeti publik i dëshmuar me faturë, furnizim sanitar me ujë nga kompania rajonale, shkarkim i ujërave fekale në kanalizimin e vendbanimit dhe shërbim i mbeturinave komunale nga KRM "Pastrimi" Sh.A. i dëshmuar me faturë.

Nuk janë dorëzuar numërime të trafikut në hyrje, vlerësim i kapacitetit të kyçjes në rrugë, plan i parkimit ose analizë e sigurisë së manovrimit. Meqë hyrja shërben njëkohësisht klientët, mjetet e furnizimit dhe kamionët e dërgesave, mungesa e këtyre të dhënave përbën boshllëk të ndjeshëm për vlerësimin e sigurisë dhe të pengesave në rrugën publike.

Për dy shërbime – ujësjellësin dhe kanalizimin – nuk ekziston dëshmi dokumentare e kyçjes. Kjo do të thotë se dy nga rrugët kryesore të daljes së substancave nga lokacioni (uji sanitar dhe rrjeti i kanalizimit) nuk janë të verifikueshme në gjendjen aktuale dhe duhet të dokumentohen para se të pranohen si kushte të vlerësimit.

4.1.11. Mbeturinat dhe materialet e rrezikshme

Shërbimi i mbeturinave komunale mbulohet nga KRM "Pastrimi" Sh.A.; fatura e qershorit 2026 dëshmon kontejner prej 1,1 m³ dhe dy zbrazje. Kjo dëshmi është e vlefshme por e kufizuar: ajo mbulon vetëm rrymën komunale të përzier.

Në materialet e dorëzuara nuk ka kontrata dhe fletëpërcjellëse me operatorë të licencuar për vajrat mbeturinë, filtrat e vajit, bateritë, antifrizin, lëngjet e frenave, absorbuesit e kontaminuar, mbetjet e bojërave, gomat ose pjesët metalike. Gjithashtu nuk ekziston regjistër sasior i gjenerimit, dëshmi fotografike e një depoje të mbuluar për mbeturinat e rrezikshme, as dëshmi e mbajtjes sekondare.

Në gjendjen aktuale nuk është e mundur të dallohet në mënyrë dokumentare inventari i pjesëve të përdorshme nga materialet që kanë status mbeturine. Ky është boshllëku i dytë më i rëndësishëm i dosjes pas drenazhimit, sepse prek njëkohësisht klasifikimin ligjor të veprimtarisë, gjurmueshmërinë e rrymave dhe kategorinë e projektit sipas Shtojcës 2 të Ligjit nr. 08/L-181.

4.1.12. Përmbledhja e gjendjes bazë dhe e boshllëqeve të të dhënave

Tabela e mëposhtme përmbledh për secilin faktor atë që është dokumentuar dhe atë që mungon, si dhe përcakton veprimin që e mbyll boshllëkun. Ajo lexohet si urë ndërmjet këtij kapitulli dhe programit të monitorimit të Kapitullit 8: çdo boshllëk i identifikuar këtu ka një pikë korresponduese matjeje ose evidence atje.

Renditja e prioriteteve rrjedh nga kombinimi i dy kritereve: gjasa që mungesa e të dhënës të fshehë një ndikim real dhe kostoja e ulët e mbylljes së boshllëkut. Sipas këtij kriteri, prioritetet e para janë drenazhimi, dokumentimi i rrymave të mbeturinave, matja bazë e zhurmës te receptori më i afërt dhe mostrimi i tokës në pikat me rrezik.

Tabela 24. Përmbledhja e gjendjes bazë dhe e boshllëqeve të të dhënave

Faktori	Gjendja bazë e dokumentuar	Boshllëku kryesor	Veprimi që e mbyll boshllëkun
Ajri	Zonë pranë trafikut; burim i palëvizshëm vetëm kabina e lyerjes	Pa matje PM, NO_2, CO dhe VOC	Vlerësim i burimeve dhe matje sipas kushtit ose ankesës
Ujërat	Kanalizim sanitar i deklaruar; rrjedhë ujore në afërsi lindore–juglindore	Pa distancë të matur, pa analiza, pa plan drenazhimi	Matje GIS e distancës, projekt drenazhimi dhe mostrim sipas rrezikut
Toka	Oborr kryesisht i shtruar me pjesë të hapura	Pa mostra dhe pa verifikim të ndotjes historike	Mostrim bazë në pikat me rrezik para ndërhyrjeve
Zhurma	Trafik dhe punë mekanike e komerciale	Pa matje ditë/natë te receptori më i afërt	Matje bazë nga person kompetent me pajisje të kalibruar
Biodiversiteti	Parcelë e transformuar me gjelbërim periferik	Pa vrojtim sezonal	Vrojtim vetëm nëse preket vegjetacioni ose zgjerohet gjurma
Popullsia dhe shëndeti	55.044 banorë në komunë; receptorë të afërt të dokumentuar	Pa distancë të matur te receptori dhe pa regjistër ankesash	Matje e distancës dhe hapje e regjistrit të ankesave
Peizazhi	Ruajtje e dukshme e automjeteve dhe pjesëve nga rruga	Pa kufizim të deklaruar të lartësisë dhe pa ekranim	Plan i renditjes, kufi lartësie dhe ekranim ku është i mundur
Mbeturinat	Shërbim komunal i dëshmuar me faturë	Pa dokumente për rrymat e rrezikshme dhe të riciklueshme	Kontrata me operatorë të licencuar dhe hapje e regjistrit sasior
Infrastruktura dhe trafiku	Rrugë, energji, ujë, kanalizim dhe pastrim funksionalë	Pa dëshmi kyçjeje për ujë e kanalizim dhe pa numërim trafiku	Sigurim i dëshmive dhe numërim shtatëditor i hyrje-daljeve
Klima dhe rreziqet klimatike	Kontekst klimatik komunal i njohur	Pa dokumentim të sjelljes së ujërave gjatë reshjeve intensive	Vrojtim dhe fotografim i drenazhimit pas reshjeve të mëdha

Burimi: Sinteza e vrojtimit të dokumentacionit, e hartave tematike, e faturave të shërbimeve dhe e burimeve zyrtare statistikore e mjedisore.

Katër rreshtat e parë të tabelës përcaktojnë përmbajtjen minimale të fushatës bazë të matjeve. Nëse autoriteti kompetent nuk vendos ndryshe, kjo fushatë duhet të kryhet para ose menjëherë në fillim të operimit të autorizuar, në kushte përfaqësuese të aktivitetit normal dhe me dokumentim të plotë të pikave, të metodës dhe të kushteve meteorologjike. Nëse projekti nuk zbatohet dhe veprimtaria vazhdon në formën aktuale, gjendja e mjedisit nuk mbetet e pandryshuar. Pa ndërhyrje, sipërfaqet e pashtruara vazhdojnë të degradohen, kontakti i reshjeve me pjesët e ruajtura jashtë mbetet i pakontrolluar, rrymat e mbeturinave mbeten pa gjurmueshmëri dokumentare dhe ngarkesa vizuale rritet me akumulimin e stokut. Kjo do të thotë se alternativa e mosveprimit nuk është alternativë neutrale, por trajektore me përkeqësim të ngadaltë dhe kumulativ; ajo analizohet plotësisht në pikën 5.21.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT 4

Gjendja bazë përshkruan një lokacion komercial ekzistues, të lidhur me infrastrukturën publike dhe të rrethuar nga receptorë njerëzorë e përdorime të përziera. Pikat më pak të dokumentuara janë cilësia e tokës dhe e ujërave, zhurma te receptori më i afërt, drenazhimi i ujërave atmosferike dhe dokumentimi i rrymave jo-komunale të mbeturinave. Këto katër boshllëqe përcaktojnë prioritetet e kapitujve pasues për ndikimet, masat dhe monitorimin dhe nuk zhvillohen më tej në këtë kapitull.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

Ky kapitull vlerëson alternativat e realizueshme për një veprimtari ekzistuese. AUTO SELIMI SH.P.K. tashmë operon në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, në Zonën Kadastrale Lipjan, në parcelat 1402-2 dhe 1402-9 sipas situacionit gjeodetik, me sipërfaqe të matur 5.094 m². Prandaj alternativa bazë nuk është ndërtimi i një veprimtarie të re, por vazhdimi, riorganizimi dhe përmirësimi mjedisor i aktivitetit ekzistues.

Alternativat vlerësohen sipas kritereve të nenit 9 të UA-së nr. 04/2025: hartimi i projektit, teknologjia, lokacioni, madhësia dhe qëllimi. Për secilën alternativë merren parasysh realizueshmëria teknike, aftësia për të parandaluar ndotjen, respektimi i kufirit kadastral, mbrojtja e receptorëve të afërt, kostoja e ndryshimit dhe vazhdimësia e veprimtarisë ekonomike.

Vlerësimi bëhet krahasues dhe jo absolut. Asnjë alternativë nuk paraqitet si e pranueshme në vetvete; çdo alternativë vlerësohet së bashku me kushtet nën të cilat mund të pranohet dhe me treguesit që lejojnë verifikimin e zbatimit të atyre kushteve.

Veprimtaria funksionon nga ora 08:00–16:00, e hënë – e shtunë. Sipas të dhënave të operatorit, mesatarisht riparohen 30 automjete brenda muajit dhe importohen mesatarisht 15 vetura ose furgona të prera në seksione për pjesë. Këto vlera përfaqësojnë kapacitetin aktual të deklaruar dhe nuk përmbajnë rritje të propozuar të kapacitetit.

ALTERNATIVA E REKOMANDUAR

Vazhdimi i veprimtarisë ekzistuese në lokacionin aktual, i shoqëruar me riorganizim funksional, magazinim të kontrolluar, ndarje të qartë të pjesëve-produkt nga mbeturinat, mbrojtje të tokës dhe të ujërave, kontroll të zhurmës dhe të trafikut, dokumentim të plotë të rrymave të mbeturinave dhe monitorim të verifikueshëm. Përzgjedhja përfundimtare mbetet e kushtëzuar nga pëlqimi mjedisor, nga pajtueshmëria urbanistike dhe nga plotësimi i të dhënave të identifikuara si boshllëqe në Kapitullin 4.

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Janë shqyrtuar katër alternativa që mund të zbatohen teknikisht ose administrativisht, si dhe alternativa pa veprim që trajtohet veçmas në pikën 5.21. Alternativat krahasohen kundrejt gjendjes aktuale të përshkruar në Kapitullin 4, kundrejt ndjeshmërisë së receptorëve të afërt dhe kundrejt aftësisë reale për të kontrolluar rreziqet mjedisore të identifikuara.

Kriteri përcaktues nuk është kostoja më e ulët, por raporti ndërmjet zvogëlimit të rrezikut dhe burimeve të nevojshme. Një alternativë konsiderohet e realizueshme vetëm nëse mund të zbatohet brenda kufirit të dokumentuar të lokacionit, brenda kornizës ligjore në fuqi dhe pa krijuar ndikime të reja të papranueshme mbi receptorët ekzistues.

Tabela e mëposhtme përshkruan përmbajtjen dhe realizueshmërinë e secilës alternativë. Ajo lexohet së bashku me tabelën krahasuese të pikës 5.2, e cila i vlerëson të njëjtat alternativa sipas gjashtë kritereve të veçanta.

Tabela 25. Alternativat e shqyrtuara dhe realizueshmëria e tyre

Kodi	Alternativa	Përshkrimi dhe realizueshmëria
A	Vazhdimi në lokacionin ekzistues me përmirësime	Veprimtaria vazhdon brenda parcelave ekzistuese. Zbatohen zonimi i brendshëm, sipërfaqet e papërshkueshme në zonat me rrezik, mbulimi i pjesëve të ndjeshme, kontrolli i ujërave atmosferike, ruajtja e veçantë e mbeturinave, disiplina e trafikut dhe evidenca mjedisore. Kërkon investim të moderuar dhe nuk ndërpret veprimtarinë. Kjo është alternativa e rekomanduar.
B	Vazhdimi pa ndryshime – gjendja e tanishme	Aktiviteti vazhdon me organizimin aktual dhe vetëm me praktikat ekzistuese. Është teknikisht i mundshëm në afat të shkurtër, por nuk adreson asnjë prej katër boshllëqeve kryesore të Kapitullit 4 dhe e lë operatorin të ekspozuar ndaj mospërputhjes.
C	Riorganizim i thellë në lokacionin aktual	Pjesa më e madhe e magazinimit kalon në hapësira të mbuluara; ndërtohen platforma të reja, instalohet separator vajrash dhe krijohet qark i kontrolluar i ujërave atmosferike. Ka performancën më të mirë mjedisore brenda lokacionit, por kërkon investim të lartë dhe verifikim urbanistik e ndërtimor.
D	Zhvendosja në një zonë tjetër komerciale ose industriale	Veprimtaria transferohet në një lokacion me distancë më të madhe nga receptorët e ndjeshëm dhe me infrastrukturë të përshtatshme. Kërkon tokë ose objekt të ri, leje të reja, transport të inventarit dhe rehabilitim të lokacionit aktual.

Burimi: Vlerësim profesional mbi bazën e gjendjes së dokumentuar dhe të kërkesave ligjore për veprimtarinë.

Alternativa B paraqitet për transparencë metodologjike dhe si pikë referimi për krahasim; ajo nuk rekomandohet. Alternativat C dhe D mbeten rezerva teknike dhe strategjike që aktivizohen nëse masat e Alternativës A nuk arrijnë performancën e kërkuar ose nuk miratohen nga autoritetet kompetente.

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar

Alternativa A është përzgjedhur për katër arsye kryesore. Së pari, veprimtaria është ekzistuese dhe lokacioni disponon qasje të drejtpërdrejtë rrugore, furnizim me energji, ujë sanitar, kanalizim fekal dhe shërbim komunal të mbeturinave; asnjë prej këtyre elementeve nuk ka nevojë të krijohet nga fillimi. Së dyti, sipërfaqja prej 5.094 m² mundëson ndarjen funksionale të zonave pa kërkuar zhvendosje. Së treti, Harta Zonale e Komunës së Lipjanit e paraqet zonën si komerciale. Së katërti, procesi nuk përfshin shkrirje, djegie, copëtim industrial ose deponim përfundimtar.

Përzgjedhja nuk bazohet në koston më të ulët, por në kushtin që masat teknike dhe organizative të zvogëlojnë në mënyrë të verifikueshme rrezikun e rrjedhjeve, përzierjen e mallrave me mbeturinat, kontaktin e pjesëve me reshjet, zhurmën, ngarkesën vizuale dhe konfliktin me objektet e afërta. Nëse këto kushte nuk mund të realizohen ose nuk aprovohen nga autoritetet, Alternativa C ose D duhet të rishqyrtohet para se veprimtaria të vazhdojë në kapacitetin e deklaruar.

Krahasimi merr parasysh lokacionin, procesin teknologjik, qarkullimin e brendshëm, materialet, mbeturinat, rrezikun nga zjarri, koston e ndryshimit dhe ndërprerjen e aktivitetit. Vlerësimi është cilësor dhe krahasues; ai nuk përdor pikëzim numerik, sepse të dhënat bazë të nevojshme për një peshim sasior – matjet e zhurmës, të tokës dhe të ujërave – nuk ekzistojnë ende.

Tabela 26. Krahasimi i alternativave sipas kritereve kryesore

Kriteri	A – vazhdim me përmirësime	B – pa ndryshime	C – riorganizim i thellë	D – zhvendosje
Vazhdimësia e veprimtarisë	Shumë e favorshme	Shumë e favorshme	Mesatare gjatë punimeve	E pafavorshme gjatë transferimit
Kontrolli i ndotjes	I mirë, nëse zbatohen masat	I pamjaftueshëm	Shumë i mirë	I mirë deri shumë i mirë, varësisht nga lokacioni i ri
Mbrojtja e receptorëve të afërt	E mirë me masa akustike dhe vizuale	E dobët; ekspozimi mbetet i pandryshuar	Shumë e mirë	Shumë e mirë nëse distanca rritet
Kostoja kapitale	E moderuar	E ulët	E lartë	Shumë e lartë
Rreziku administrativ	I moderuar	I lartë për mospërputhje	I moderuar deri i lartë	I lartë për leje dhe pronë të re
Përdorimi i infrastrukturës ekzistuese	Po	Po	Po, me ndërhyrje	Jo ose vetëm pjesërisht
Përshtatshmëria e përgjithshme	E rekomanduar me kushte	Nuk rekomandohet	Rezervë teknike	Rezervë strategjike

Burimi: Vlerësim profesional krahasues i hartueses mbi bazën e gjendjes së dokumentuar.

Nga tabela dallohet se Alternativa B është e vetmja që nuk përmirëson asnjë kriter mjedisor dhe njëkohësisht mbart rrezikun më të lartë administrativ. Alternativa C është superiore për nga performanca mjedisore, por avantazhi i saj kundrejt A-së realizohet vetëm pasi të përfundojnë punimet, ndërsa gjatë punimeve krijon ndikime shtesë të përkohshme.

5.3. Vendndodhjes ose rrugës

Alternativa e zgjedhur ruan lokacionin ekzistues dhe hyrjen nga rruga Bajram Gashi e lidhur me R-120. Qasja ekzistuese shmang hapjen e një rruge të re, humbjen e tokës jashtë parcelës dhe ndërhyrjet shtesë në terren; ky është një avantazh mjedisor i drejtpërdrejtë dhe i pakundërshtueshëm i Alternativës A ndaj Alternativës D.

Brenda parcelës duhet të krijohet një regjim i kontrolluar hyrje–dalje me qarkullim të përcaktuar, me hapësirë pritjeje që nuk bllokon rrugën publike, me zonë të veçantë shkarkimi për mjetet e rënda dhe me korridor të lirë për shërbimet emergjente. Gjerësia dhe gjeometria e këtij korridori përcaktohen në projektin zbatues të aprovuar, duke marrë parasysh gabaritin e mjeteve më të mëdha që hyjnë realisht në lokacion.

Zhvendosja do të ishte e arsyeshme në tri rrethana konkrete: nëse matjet e zhurmës te receptori më i afërt tregojnë tejkalim të vazhdueshëm që nuk mund të korrigjohet me masa në burim; nëse kushtet urbanistike nuk lejojnë përmirësimet e nevojshme, veçanërisht mbulimin e magazinimit; ose nëse kapaciteti i ardhshëm tejkalon hapësirën e disponueshme pas realizimit të zgjerimeve. Lokacioni alternativ do të duhej të ishte zonë komerciale ose industriale me qasje për mjete të rënda, dysheme të papërshkueshme, kanalizim funksional dhe mundësi për kontroll të ujërave atmosferike.

5.4. Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Alternativa B mbart rrezikun më të lartë relativ, sepse ruajtja e jashtme e pakontrolluar dhe mungesa e të dhënave bazë vazhdojnë pa korrigjim. Në këtë skenar, çdo incident do të ndodhte pa gjendje bazë referuese, pa pikë monitorimi dhe pa dëshmi që e ndan përgjegjësinë historike nga ajo aktuale.

Alternativa A ul rrezikun për tokën dhe ujërat përmes ndarjes së zonave, kontrollit të rrjedhjeve dhe menaxhimit të dokumentuar të mbeturinave; ul rrezikun për njerëzit përmes kufizimit të punëve të zhurmshme brenda orarit, rregullimit të trafikut të brendshëm dhe mbajtjes së korridoreve të sigurta. Alternativa C ofron kontroll edhe më të madh, sidomos për ujërat atmosferike, por krijon ndikime të përkohshme nga punimet. Alternativa D e zhvendos presionin nga lokacioni aktual, por gjeneron ndikime nga ndërtimi, nga transferimi i inventarit dhe nga transporti më i gjatë.

Për shëndetin e njeriut, dallimi kryesor ndërmjet alternativave qëndron te ekspozimi profesional dhe te ekspozimi i fqinjëve. Ekspozimi profesional ndaj tretësve, pluhurit të bluarjes, tymit të saldimit dhe pjesëve të rënda është pothuajse i njëjtë në të gjitha alternativat dhe kontrollohet me pajisje mbrojtëse, ventilim dhe trajnim. Ekspozimi i fqinjëve ndaj zhurmës, erës dhe pluhurit ndryshon ndjeshëm ndërmjet alternativave dhe është kriteri që i jep përparësi mbylljes së proceseve brenda objektit.

Tabela 27. Vlerësimi krahasues i ndikimeve sipas alternativave

Faktori	A	B	C	D
Toka dhe ujërat	Rrezik i ulët deri i mesëm pas masave	Rrezik i mesëm deri i lartë	Rrezik i ulët	Varet nga lokacioni i ri
Ajri dhe pluhuri	I ulët deri i mesëm	I mesëm	I ulët pas përfundimit të punimeve	Varet nga trafiku dhe distanca
Zhurma	E kontrollueshme me orar dhe mbyllje procesesh	Mund të mbetet shqetësuese	E kontrollueshme	Mund të ulet me distancë
Shëndeti dhe siguria në punë	Përmirësim i qartë	Boshllëqe të vazhdueshme	Përmirësim shumë i madh	Varet nga projekti i ri
Peizazhi	Përmirësim me renditje dhe ekranim	Ngarkesë vizuale e pandryshuar	Përmirësim i madh	Eliminohet lokalisht
Ndikimet e përkohshme nga punimet	Të kufizuara	Nuk ka	Të konsiderueshme	Të konsiderueshme në dy lokacione

Burimi: Vlerësim profesional krahasues mbi bazën e gjendjes bazë të Kapitullit 4.

Rreshti i fundit shpjegon pse Alternativa A mbetet e preferuar edhe pse C ka performancë më të mirë përfundimtare: në një lokacion me receptorë ngjitur, ndikimet e përkohshme nga punimet e gjera nuk janë të papërfillshme dhe duhet të peshohen ndaj përfitimit të mëvonshëm. Zgjidhja e propozuar është zbatimi me faza, ku elementet me kosto të ulët dhe efekt të lartë realizohen së pari.


5.5. Proceset, teknologjia e prodhimit

Projekti nuk përbën linjë prodhuese klasike. Produkti është pjesa e përdorur e kontrolluar dhe e dorëzuar te klienti, si dhe shërbimi i riparimit i kryer mbi automjetin e klientit. Prandaj “teknologjia e prodhimit” këtu nënkupton teknologjinë e servisimit, të kontrollit të cilësisë së pjesëve dhe të menaxhimit të rrjedhës së materialeve.

Alternativa teknologjike e rekomanduar mbështetet në pesë elemente: inventarizim me kod unik për çdo pjesë; kontroll hyrës i dokumenteve dhe i gjendjes fizike; zonë karantine për pjesët me status të paqartë; rafte ose mbajtëse të dimensionuara sipas peshës; dhe tava e mbajtje sekondare për të gjithë komponentët që përmbajnë ose mund të përmbajnë lëngje. Këto pesë elemente zëvendësojnë nevojën për teknologji të rëndë trajtimi.

Alternativa më e avancuar teknologjike, e shqyrtuar në kuadër të Alternativës C, parashikon magazinim të mbyllur për motorët, transmisionet dhe komponentët elektrikë; platformë të mbuluar për ngarkim-shkarkim;

separator vajrash për ujërat nga sipërfaqet me rrezik; dhe sistem digjital që lidh dokumentacionin e importit me statusin e secilës pjesë. Për këtë lokacion nuk rekomandohet prerja industriale e automjeteve, copëtimi, djegia ose trajtimi termik në asnjë alternativë.



Skema 1. Skema e procesit teknologjik të autoservisit, nga pranimi i automjetit deri te dorëzimi

Burimi: Skemë e përgatitur për raportin mbi bazën e procesit të deklaruar nga aplikuesi.

Skema paraqet dymbëdhjetë hapa kryesorë të procesit, shërbimet përbërëse, hyrjet, daljet, mbetjet kryesore dhe elementet e infrastrukturës mjedisore. Ajo duhet lexuar së bashku me tabelën e fazave të pikës 2.4: skema jep pamjen operative të servisimit, ndërsa tabela jep rrjedhën e materialeve nga origjina deri te dorëzimi ose deri te operatori i mbeturinave.

Jo çdo automjet i nënshtrohet të gjitha fazave. Procesi përshtatet sipas defektit, llojit të shërbimit dhe gjendjes teknike të automjetit; për shembull, një ndërrim vaji nuk kalon në karroceri e lyerje, ndërsa një riparim strukturor pas aksidenti i kalon pothuajse të gjitha fazat. Kjo ndryshueshmëri merret parasysh në vlerësimin e emetimeve, të cilat nuk janë të njëtrajtshme në kohë.

5.5.1. Pranimi, regjistrimi dhe diagnostikimi i automjetit

Procesi fillon me pranimin e automjetit në ambientet e autoservisit. Gjatë pranimit kryhen identifikimi i automjetit, evidentimi i gjendjes së jashtme dhe i dëmtimeve ekzistuese, përcaktimi i kërkesës së klientit, kontrolli vizual fillestar dhe caktimi i zonës përkatëse të punës. Çdo automjet me rrjedhje të dukshme të vajit, karburantit ose lëngjeve të tjera kontrollohet para fillimit të punimeve dhe, kur rrjedhja vazhdon, vendoset mbi tavë mbajtëse për të mbrojtur dyshemenë e objektit.

Diagnostikimi kryhet me pajisje të dedikuara dhe mund të përfshijë kontrollin elektronik të automjetit, diagnostikimin e sistemit të motorit, të frenimit, të drejtimit, të transmisionit, të ndriçimit, të ndezjes, të

injektimit, të sistemit ABS, të sistemit AIRBAG dhe të sistemeve kundër vjedhjes. Mbi bazën e rezultateve përcaktohen lloji dhe shtrirja e punimeve, si dhe pjesët që do të zëvendësohen.

Nga këndvështrimi mjedisor, kjo fazë ka dy funksione. E para është parandaluese: identifikimi i hershëm i rrjedhjeve pengon ndotjen e dyshemesë dhe të sipërfaqeve. E dyta është dokumentuese: urdhri i punës i hapur në këtë fazë bëhet regjistri ku evidentohen sasitë e lëngjeve të zëvendësuara dhe pjesët e hequra, të cilat më pas bëhen rryma mbeturinash me kod përkatës.

5.5.2. Shërbimet mekanike, motorike dhe xhenerike

Punët mekanike dhe xhenerike kryhen kryesisht në hapësirat e pajisura me ura ngritëse. Ato përfshijnë diagnostikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemit të drejtimit dhe të përforcuesve të tij; të sistemit hidraulik dhe pneumatik të frenimit dhe të frenit të dorës; të friksionit mekanik dhe hidraulik; të kutive manuale dhe automatike të ndërrimit të shpejtësive dhe të mekanizmave të komandimit; të transmisioneve kardanike dhe kryesore; të diferencialeve, gjysmëboshteve dhe akseve; si dhe të varëseve, elementeve të pezullimit, rrotave, balancimit dhe gjeometrisë së rrotave.

Shërbimet motorike përfshijnë servisin periodik të motorit, ndërrimin e vajit dhe të filtrave, kontrollin dhe riparimin e komponentëve të brendshëm, mirëmbajtjen e sistemeve të ftohjes, të shkarkimit, të thithjes dhe të rikthimit të gazrave të shkarkimit, kontrollin e rrjedhjeve dhe zëvendësimin e komponentëve të dëmtuar.

Gjatë këtyre aktiviteteve gjenerohen vajra të përdorura, filtra vaji, filtra ajri dhe karburanti, lëngje ftohëse, lëngje frenash, pjesë metalike të zëvendësuara dhe materiale absorbuese të kontaminuara. Vajrat e përdorura mblidhen menjëherë në enë të përshtatshme, të mbyllura dhe të vendosura mbi mbajtje sekondare; ndalohet çdo derdhje e tyre në tokë, në kanalizim, në ujëra sipërfaqësore ose në sistemin sanitar.

5.5.3. Shërbimet diagnostikuese dhe elektrike

Në këtë segment kryhen diagnostikimi i problemeve elektronike, i sistemit të ndriçimit, të ndezjes, të furnizimit me energji, të injektimit, të sistemeve AIRBAG dhe ABS dhe i sistemeve kundër vjedhjes, si dhe kontrolli e riparimi i instalimeve elektrike dhe kontrolli i baterive e i komponentëve elektrikë.

Rryma kryesore e mbeturinave nga ky segment janë bateritë e plumbit, të cilat klasifikohen si mbeturina të rrezikshme. Ato grumbullohen në hapësirë të veçantë, të identifikuar, të mbrojtur nga reshjet dhe mbi sipërfaqe rezistente ndaj acidit, në pozitë vertikale dhe pa u përzier me rrymat e tjera.

Rreziku specifik i këtij segmenti është dëmtimi mekanik i baterisë dhe derdhja e elektrolitit. Për këtë arsye, zona e baterive pajiset me mbajtje sekondare rezistente ndaj acidit dhe me material neutralizues të përshtatshëm, ndërsa personeli trajnohet posaçërisht për trajtimin e tyre dhe për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse.

5.5.4. Karroceria dhe llamarinisteria

Punët e karrocerisë dhe llamarinisterisë kryhen për automjetet me dëmtime të pjesëve të jashtme ose strukturore. Procesi përfshin kontrollin e pjesës së dëmtuar, çmontimin e komponentëve, drejtimin e llamarinës, prerjen e pjesëve të dëmtuara kur është e nevojshme, përgatitjen e pjesëve zëvendësuese, saldimin dhe bashkimin, përpunimin mekanik të sipërfaqes, bluarjen, pastrimin dhe përgatitjen për lyerje.

Ky është segmenti me emetimet më të larta të pluhurit dhe të tymit brenda objektit. Bluarja gjeneron grimca të imëta që mund të përhapen në zonat fqinje dhe të kontaminojnë sipërfaqet e përgatitura për lyerje; saldimi gjeneron tym metalik dhe shkëndija. Prandaj kërkohen aspirim lokal në pikën e gjenerimit, ndarje fizike e zonës së bluarjes nga zona e lyerjes, pastrim me vakum në vend të fshirjes së thatë dhe ekranim i shkëndijave nga materialet e ndezshme.

Pjesët strukturore të prera që rezultojnë nga këto punime trajtohen sipas destinimit të tyre real. Pjesët që plotësojnë kushtet për ripërdorim ruhen në mënyrë të organizuar dhe të mbrojtur; pjesët e papërshtatshme për ripërdorim ndahen si mbetje metalike, ruhen veçmas dhe u dorëzohen operatorëve të autorizuar. Ashklat dhe grimcat metalike të kontaminuara me vaj klasifikohen si mbeturina të rrezikshme dhe nuk përzihen me metalin e pastër.

5.5.5. Procesi i lyerjes dhe i tharjes

Lyerja kryhet në zonën ose kabinën e paraparë për këtë qëllim dhe zhvillohet në shtatë faza të njëpasnjëshme: përgatitja e automjetit me pastrim dhe maskim të pjesëve që nuk lyhen; stukimi për nivelimin e sipërfaqeve të dëmtuara; bluarja e stukos pas tharjes; përgatitja përfundimtare e sipërfaqes me pastrim nga pluhuri; aplikimi i bojës me armë llaku; tharja sipas parametrave të përcaktuar për materialin e përdorur; dhe lustrimi e përfundimi i sipërfaqes me kontroll vizual.

Ky është burimi kryesor i emetimeve të përbërjeve organike të avullueshme në lokacion dhe njëkohësisht burimi i palëvizshëm më i rëndësishëm i shkarkimeve në ajër. Kabina duhet të funksionojë me ventilim dhe me filtra sipas projektit e udhëzimeve të prodhuesit; materialet e bojës përdoren sipas fletëve të të dhënave të sigurisë; enët mbyllen menjëherë pas përdorimit; dhe burimet e ndezjes ndalohen në të gjithë zonën.

Gjatë procesit gjenerohen mbetje bojrash dhe llaqesh, ambalazhe të kontaminuara, materiale absorbuese, filtra kabine të ngopur, letra zmerile dhe shirita maskues të kontaminuar. Të gjitha këto rryma klasifikohen sipas grupeve 08 dhe 15 të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, ruhen në enë të mbyllura e të etiketuara dhe u dorëzohen operatorëve të licencuar; ndërrimi i filtrave dhe konsumi i materialeve regjistrohen si tregues operativë të monitorimit.

5.5.6. Shërbimet e gomisterisë

Shërbimet e gomisterisë përfshijnë çmontimin dhe montimin e gomave, kontrollin e gjendjes së tyre, fryrjen, riparimin, balancimin e rrotave, kontrollin e presionit dhe zëvendësimin e gomave të dëmtuara. Këto punime kryhen me pajisje të dedikuara dhe me ajër të kompresuar nga kompresori i përbashkët.

Gomat e papërdorshme ndahen menjëherë nga mbetjet e tjera dhe grumbullohen në një hapësirë të përshtatshme, të qëndrueshme dhe të mbrojtur, deri te dorëzimi te operatori i autorizuar. Ruajtja e tyre në sasi të mëdha dhe për periudha të gjata nuk lejohet, sepse rrit rrezikun nga zjarri dhe krijon kushte për grumbullim uji e insekte.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë i këtij segmenti është i ulët, por dy elemente kërkojnë vëmendje: zhurma impulsive nga pistoleti pneumatik, e cila është ndër burimet më të dukshme akustike për fqinjët, dhe kufizimi i sasisë maksimale të gomave të ruajtura njëkohësisht, i cili përbën masë të drejtpërdrejtë të mbrojtjes nga zjarri.

5.5.7. Pajisjet, materialet dhe infrastruktura përcjellëse

Për realizimin e procesit teknologjik përdoren pajisje standarde të autoservisit. Tabela e mëposhtme i paraqet ato së bashku me funksionin dhe me aspektin mjedisor që lidhet me secilën, në mënyrë që lista të mos jetë vetëm inventar, por bazë për planin e mirëmbajtjes dhe të monitorimit.

Tabela 28. Pajisjet kryesore të procesit teknologjik dhe aspekti mjedisor i tyre

Nr.	Pajisja ose mjeti	Funksioni	Aspekti mjedisor i lidhur
1	Ura ngritëse – 8 copë	Ngritja e automjeteve për kontroll dhe riparim	Rrjedhje nën automjet; kërkohet tavë mbajtëse dhe dysheme e papërshkueshme

Nr.	Pajisja ose mjeti	Funksioni	Aspekti mjedisor i lidhur
2	Kompresor ajri	Furnizimi me ajër të kompresuar	Zhurmë dhe vibrime; kërkohet bazament antivibrues dhe mirëmbajtje
3	Armë llaku	Aplikimi i bojës	Emetime VOC dhe mjegull boje; përdorim vetëm në kabinë
4	Kabinë/furrë lyerjeje	Lyerja dhe tharja e automjeteve	Burim i palëvizshëm shkarkimesh; kërkohen ventilim, filtra dhe evidencë ndërrimi
5	Pajisje diagnostikuese	Diagnostikimi elektronik	Konsum energjie; pa emetime të drejtpërdrejta
6	Pajisje për balancim rrotash	Balancimi i rrotave	Zhurmë e ulët; mbetje peshash balancuese
7	Pajisje për regjistrimin e këndeve	Kontrolli i gjeometrisë së rrotave	Konsum energjie; pa emetime të drejtpërdrejta
8	Makineri për punime karrocerie	Përpunimi i pjesëve të dëmtuara	Zhurmë, pluhur dhe grimca metalike; kërkohet aspirim lokal
9	Pajisje saldimi	Bashkimi dhe riparimi i pjesëve metalike	Tym saldimi dhe shkëndija; kërkohen aspirim dhe ekranim
10	Pajisje për gomisteri	Montim, çmontim dhe riparim gomash	Zhurmë impulsive; mbetje gomash
11	Vegla dore dhe pajisje ndihmëse	Montim, çmontim dhe përpunim	Mbetje metalike dhe materiale absorbuese të kontaminuara

Burimi: Inventari i pajisjeve i deklaruar nga aplikuesi dhe vlerësim profesional i aspekteve mjedisore të secilës pajisje.

Kolona e fundit përcakton pse secila pajisje hyn ose nuk hyn në programin e monitorimit. Tri pajisje – kabina e lyerjes, pajisjet e saldimit e të bluarjes dhe kompresori – janë burime të identifikuara emetimi dhe u korrespondojnë pika konkrete kontrolli në Kapitullin 8.

Materialet e konsumueshme që përdoren gjatë procesit përfshijnë vajra lubrifikues, lëngje ftohëse dhe frenimi, detergjentë, tretës, stuko, bojëra, primerë dhe llaqe, materiale për përgatitjen e sipërfaqeve, letër zmerile, shirita maskues, lecka, materiale absorbuese, filtra, materiale saldimi, pjesë këmbimi, goma dhe komponentë të tjerë. Materialet kimike ruhen në ambalazhet origjinale ose në enë të përshtatshme, të mbyllura dhe të etiketuara, në zona të mbrojtura nga dëmtimi mekanik dhe nga rrjedhjet.

Infrastruktura përcjellëse e nevojshme për funksionimin e sigurt përfshin rrjetin e furnizimit me energji elektrike dhe me ujë, sistemin e ndriçimit dhe të ventilimit, shkarkimin e ujërave sanitare, pajisjet kundër zjarrit dhe të ndihmës së parë, hapësirat e ndara për magazinimin e materialeve, të pjesëve të përdorura dhe të mbetjeve, si dhe pajisjet e materialet për reagim ndaj derdhjeve aksidentale.




Figura 7. Pajisje dhe hapësira pune të përdorura gjatë procesit teknologjik

Burimi: Fotografi të terrenit të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026.



Figura 8. Zona e punës, magazinimi i materialeve dhe organizimi i brendshëm

Burimi: Fotografi të terrenit të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Meqë aktiviteti është ekzistues, "zbatimi" nënkupton riorganizim me faza dhe jo ndërtim nga fillimi. Faza e parë është pastrimi dhe inventarizimi i plotë i stokut; e dyta është ndarja fizike e zonave funksionale; e treta është rregullimi i sipërfaqeve, i mbulimit dhe i drenazhimit; dhe e katërta është vendosja e regjistrave, e kontratave dhe e monitorimit. Punët që krijojnë pluhur, zhurmë ose pengojnë qarkullimin kryhen jashtë orëve me fluks të lartë.

Gjatë funksionimit zbatohet metoda "pranim – kontroll – karantinë – klasifikim – magazinim – shitje ose montim". Çdo pjesë me rrjedhje izolohet menjëherë në karantinë; pjesët nuk vendosen drejtpërdrejt mbi tokë; komponentët e rëndë stabilizohen mbi bazamente të dimensionuara; mbeturinat nuk përzihen me inventarin tregtar; dhe larja e pakontrolluar e pjesëve në oborr nuk lejohet.

Metoda e punës përfshin gjithashtu një rregull të thjeshtë por vendimtar për gjurmueshmërinë: asnjë material nuk del nga lokacioni pa dokument. Për pjesët e shitura mbahet evidenca e daljes, për mbeturinat mbahet fletëpërcjellësja dhe dëshmia e licencës së operatorit pranues, dhe për materialet e kthyera te furnizuesi mbahet dokumenti i kthimit. Ky rregull zbatohet nga i njëjti person përgjegjës që mban regjistrin e hyrjeve.

5.7. Planin e lokacionit

Plani i lokacionit bazohet në situacionin gjeodetik të parcelave 1402-2 dhe 1402-9 dhe në skicën e zgjerimeve të paraqitur në pikën 3.2. Organizimi ruan objektin ekzistues P+3, parashikon zgjerimin e autoservisit me 550 m² në zonën e verdhë dhe vendos garazhin/depon me 730 m² në zonën e kaltër.

Rruga e brendshme, e shënuar me të gjelbër në skicë, kalon nën pjesën e zgjeruar të objektit dhe lidh autoservisin me garazhin e depon. Para zbatimit, projekti duhet të verifikojë gabaritin e automjeteve që hyjnë realisht, rrezet e kthesave, fushëpamjen, ndriçimin, kapacitetin mbajtës të sipërfaqes, qasjen e mjeteve zjarrfikëse dhe ndarjen e lëvizjes së këmbësorëve nga ajo e mjeteve.

Organizimi funksional i propozuar ndan lokacionin në zona me përdorim të përcaktuar: parkim dhe pritje për klientët; magazina e pjesëve të përdorura; zona e mirëmbajtjes dhe riparimit; magazina e depozitimit dhe e sortimit; administrata dhe pritja; nyjat sanitare dhe dhoma e ndërrimit; zona e trajtimit të ujërave me separator; dhe zona e mbeturinave me depozitim të përkohshëm. Kjo ndarje është paraqitur në skicën konceptuale të pikës 3.12 dhe konkretizohet me planimetrinë e aprovuar.

Tabela 29. Organizimi funksional sipas situacionit dhe skicës së zgjerimit

Elementi	Organizimi i planifikuar	Kushti teknik dhe mjedisor
Objekti ekzistues P+3	Mbetet objekti bazë i kompleksit	Kontroll strukturor dhe funksional sipas përdorimit të aprovuar
Zgjerimi i autoservisit	550 m² në zonën e kufizuar me vijë të verdhë	Projekt zbatues, ventilim, mbrojtje nga zjarri, dysheme e papërshkueshme dhe kontroll i zhurmës e i emetimeve
Rruga e brendshme	Kalimi nën pjesën e zgjeruar dhe vazhdimi sipas drejtimit të shënuar	Lartësi e lirë, ndriçim, fushëpamje, manovrim dhe qasje emergjente të verifikuara nga projektuesi
Garazhi dhe depoja	730 m² në zonën e kufizuar me vijë të kaltër, objekti P+0	Magazinim i pajisjeve dhe i pjesëve rezervë; pa përzierje me mbeturinat ose lëngjet e rrezikshme
Zona e pranimit dhe karantinës	Hapësirë e shënuar pranë hyrjes	Platformë e papërshkueshme, mbulim dhe mbajtje sekondare
Zona e mbeturinave	Hapësirë e ndarë, e mbuluar dhe e kyçur për rrymat e rrezikshme	Enë kompatibile, etiketa, mbajtje sekondare dhe qasje për operatorin
Zonat e qarkullimit	Korridore të shënuara për mjete dhe këmbësorë	Gjerësi sipas projektit të aprovuar; mbahen gjithmonë të lira
Gjithsej sipërfaqe e re	1.280 m² sipas deklarimit të aplikuesit	Gjurmët dhe dimensionet përfundimtare verifikohen në projektin zbatues dhe në procedurat e lejeve

Burimi: Situacioni gjeodetik i datës 17.08.2026, skica e aplikuesit dhe skica konceptuale e organizimit funksional.

Kushtet e kolonës së tretë janë detyruese për projektin zbatues dhe kalojnë si tregues pranimi në Kapitullin 9. Sipërfaqet e deklaruara prej 550 m² dhe 730 m² janë të dhëna të aplikuesit; dimensionet, gjurma e ndërtimit, distancat nga kufiri, parkimi, drenazhimi dhe pozita e pajisjeve përcaktohen nga projektuesi brenda sipërfaqes së dokumentuar prej 5.094 m².

5.8. Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Për rregullimin e lokacionit preferohen materiale rezistente ndaj vajrave dhe hidrokarbureve: beton i dendur me përfundim të lëmuar ose veshje e certifikuar për rezistencë kimike; kanale të mbyllura ose rezistente; enë prej HDPE-je ose çeliku të përshtatshëm për substancën përkatëse; paleta mbajtëse me kapacitet sekondar të paktën sa vëllimi i enës më të madhe; rafte metalike të ankoruara me ngarkesë të deklaruar; dhe mbulesa të qëndrueshme ndaj reshjeve dhe rrezatimit UV.

Materialet poroze, të çara ose të dëmtuara nuk përdoren në zonat ku mund të ketë rrjedhje. Ky kriter zbatohet posaçërisht për dyshemenë e servisit, për zonën e pranimit dhe të karantinës dhe për hapësirën e magazinimit të lëngjeve; në këto zona sipërfaqja duhet të jetë e pastrueshme dhe e riparueshme pa ndërprerje të gjatë të punës.

Për ekranim vizual mund të përdoren panele të qëndrueshme dhe brez gjelbërimi aty ku hapësira e lejon dhe ku nuk pengohet fushëpamja e trafikut në hyrje. Zgjedhja e materialeve merr parasysh rezistencën ndaj zjarrit, ngarkesën e pjesëve të magazinuara, mundësinë e mirëmbajtjes dhe riciklueshmërinë e tyre në fund të jetës; materialet me përmbajtje azbesti janë të ndaluara dhe nuk përdoren në asnjë element të projektit.

5.9. Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Alternativa A mund të zbatohet me faza dhe me ndërprerje minimale të veprimtarisë. Prioriteti i parë u takon veprimeve që lidhen drejtpërdrejt me sigurinë dhe me ndotjen: izolimi i mbeturinave të rrezikshme, vendosja e pajisjeve për derdhje, lirimi i korridoreve dhe ndalimi i kontaktit të pjesëve me tokën e me reshjet. Këto veprime nuk kërkojnë leje ndërtimore dhe mund të fillojnë menjëherë.

Prioriteti i dytë u takon punimeve të sipërfaqeve, të drenazhimit, të mbulimit dhe të sinjalizimit, të cilat kërkojnë projekt dhe, sipas rastit, leje. Prioriteti i tretë janë dy zgjerimet e planifikuara, të cilat nuk mund të fillojnë para pëlqimit mjedisor dhe lejes së ndërtimit, sipas nenit 7 paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit nr. 08/L-181.

Veprimtaria planifikohet të vazhdojë pa afat të paracaktuar, përderisa respektohen lejet dhe kushtet e vendosura. Përfundimi i funksionimit duhet të njoftohet paraprakisht dhe të shoqërohet me largim të inventarit, me dorëzim të mbeturinave te operatorët e licencuar, me pastrim të sipërfaqeve dhe me verifikim të gjendjes së tokës sipas rrezikut të identifikuar. Afati dyvjeçar i nenit 21 të Ligjit nr. 08/L-181 për ndërprerjen e vlefshmërisë së pëlqimit mjedisor merret parasysh në planifikimin e fazës së ndërtimit.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Lokacioni i vlerësuar ka sipërfaqe të dokumentuar prej 5.094 m² në parcelat 1402-2 dhe 1402-9. Brenda këtij kufiri planifikohen zgjerimi i autoservisit me 550 m² dhe ndërtimi i garazhit/depos me 730 m², pra 1.280 m² sipërfaqe e re gjithsej sipas deklarimit të aplikuesit.

Alternativa e përzgjedhur nuk kërkon zgjerim jashtë kufijve të dokumentuar. Efikasiteti hapësinor arrihet përmes rafteve vertikale, renditjes sipas shpejtësisë së qarkullimit të stokut, përcaktimit të një kufiri maksimal të sasisë së ruajtur dhe largimit të rregullt të materialeve të papërdorshme. Kjo qasje shmang zënien e tokës shtesë dhe njëkohësisht ul ngarkesën vizuale.

Nëse stoku tejkalon kapacitetin e sigurt të lokacionit, zgjidhja nuk është grumbullimi më i dendur, sepse ai bllokon korridoret, rrit rrezikun nga zjarri dhe pengon ndërhyrjen në rast derdhjeje. Zgjidhjet e pranueshme janë reduktimi i hyrjeve, përdorimi i një magazine të jashtme të autorizuar ose zhvendosja. Çdo objekt shtesë i mbuluar kërkon verifikim urbanistik, statik dhe kundër zjarrit para realizimit.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i veprimtarisë matet me katër tregues: numri i automjeteve të servisuara, numri i njësive të importuara për pjesë, masa e stokut të ruajtur dhe shpejtësia e qarkullimit të tij. Tre treguesit e parë janë të deklaruar ose të matshëm; i katërti rrjedh nga krahasimi i hyrjeve me daljet gjatë një periudhe.

Alternativa e rekomanduar është kapacitet i kontrolluar, i kufizuar nga hapësira e disponueshme e magazinimit dhe nga aftësia reale për të menaxhuar rrymat e mbeturinave, dhe jo maksimizim i pakufizuar i stokut. Ky është një kufizim i vetëdijshëm i alternativës: rritja e vëllimit pa rritje përkatëse të kapacitetit të kontrollit do të zhvendoste rrezikun nga i menaxhueshëm në të papranueshëm.

Tabela 30. Treguesit e kapacitetit aktual të deklaruar

Treguesi	Mesatarja mujore	Vlera vjetore e ekstrapoluar	Baza e verifikimit
Automjete të mirëmbajtura ose të riparuara	30 automjete/muaj	Rreth 360 automjete/vit	Urdhër-punët dhe faturat e shërbimit
Vetura ose furgona të prera në seksione, të importuara për pjesë	15 njësi/muaj	Rreth 180 njësi/vit	Dokumentet doganore dhe listat e pjesëve
Ditët e operimit	e hënë – e shtunë	Sipas kalendarit real të punës	Regjistri i pranisë
Orari ditor	08:00–16:00	8 orë pune në ditë	Rregullorja e brendshme e punës

Burimi: Deklarimet e aplikuesit; verifikimi kryhet me evidencat operative sipas Kapitullit 8.

Vlerat vjetore prej rreth 360 dhe rreth 180 janë ekstrapolime aritmetike dymbëdhjetëmujore nga mesatarja mujore e deklaruar dhe supozojnë ritëm të njëjtë gjatë gjithë vitit. Ato paraqiten si vlera të prejardhura dhe jo si evidencë; evidenca reale vjetore duhet të paraqesë numrin faktik, ndërprerjet sezonale dhe kthimet ose refuzimet e ngarkesave.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Alternativa A përdor kontrollin në burim si parim themelor. Ai përfshin sipërfaqe të papërshkueshme në zonat me rrezik; tava dhe mbajtje sekondare nën çdo enë me lëngje; mbulim të komponentëve që përmbajnë lëngje të mbetura; ndarje të ujërave të pastra atmosferike nga zonat me rrezik; ndalim të plotë të shkarkimit të lëngjeve teknike në kanalizim; pastrim me metoda të thata dhe me absorbues; mirëmbajtje të dokumentuar të pajisjeve; kufizim të ndezjeve në boshe; dhe orar të kontrolluar për punët e zhurmshme.

Për ajrin, kontrolli përqendrohet te tri burimet e identifikuara: kabina e lyerjes me ventilim dhe filtra funksionalë; bluarja dhe saldimi me aspirim lokal; dhe pluhuri nga sipërfaqet e pambuluara me shtrim ose lagie të kontrolluar. Për zhurmën, kontrolli përqendrohet te kompresori, te veglat pneumatike dhe te manovrimi i mjeteve.

Alternativa C shton separator vajrash, sistem të projektuar drenazhimi, ventilim lokal të zgjeruar dhe mbyllje më të madhe të operacioneve brenda objektit. Përzgjedhja ndërmjet A-së dhe C-së për komponentin e ujërave duhet të bazohet në projektin e drenazhimit, në sipërfaqet reale kontribuuese dhe në kushtet që vendos autoriteti

kompetent; ky raport nuk e paragjykon atë vendim, por përcakton se ndarja e ujërave dhe mbrojtja e pusetave janë detyrim minimal në çdo rast.

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Alternativa e rekomanduar nuk parasheh asnjë trajtim ose asgjësim përfundimtar në lokacion. Mbeturinat ndahen në burim, etiketohen, peshohen ose numërohen, ruhen përkohësisht në mënyrë të sigurt dhe u dorëzohen operatorëve të licencuar. Ky është kufizim thelbësor i alternativës dhe përcakton njëkohësisht kategorinë e projektit.

Ripërdorimi ka përparësi mbi riciklimin dhe mbi asgjësimin, por vetëm kur pjesa është e identifikueshme, funksionale, pa rrjedhje dhe realisht e destinuar për përdorim. Ripërdorimi i pjesëve të automjeteve është vetë thelbi ekonomik i veprimtarisë; prandaj përfitimi mjedisor i saj është real, por realizohet vetëm nëse kriteri i përdorshmërisë zbatohet me rigorozitet dhe nuk shndërrohet në arsyetim për grumbullim.

Mbeturinat komunale vazhdojnë të merren nga KRM "Pastrimi" Sh.A. Vajrat, filtrat, bateritë, antifrizi, lëngjet e frenave, mbetjet e bojërave, absorbuesit e kontaminuar, gomat dhe metalet kërkojnë rrugë të veçanta dhe operatorë të licencuar për rrymën përkatëse. Përzierja e tyre me mbeturinat komunale ose me inventarin tregtar nuk është alternativë e pranueshme në asnjë rrethanë.

5.14. Rregullimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit

Alternativa e përzgjedhur përdor rrugën ekzistuese dhe riorganizon qarkullimin brenda parcelës. Hyrja mbahet e lirë, klientët orientohen drejt parkimit të shënuar, ndërsa mjetet e transportit shkarkojnë vetëm në zonën e dedikuar. Pritja ose magazinimi i mjeteve në rrugën publike nuk lejohet në asnjë rrethanë.

Nëse numri i lëvizjeve ose dimensionet e mjeteve krijojnë konflikt me trafikun e korridorit, duhet të shqyrtohen terminë të rezervuar për furnizim jashtë orëve me fluks të lartë, sinjalizim shtesë, pasqyrë trafiku, angazhim i një personi drejtues gjatë manovrimit të mjeteve të rënda ose modifikim i hyrjes me leje të autoritetit rrugor.

Nuk propozohet asnjë rrugë e re në alternativën e zgjedhur. Numërimi shtatëditor i hyrje-daljeve sipas llojit të mjetit dhe orës, i parashikuar në pikën 8.4, është mjeti që përcakton nëse masat e mësipërme mjaftojnë apo nëse kërkohet ndërhyrje në gjeometrinë e hyrjes.

5.15. Përgjegjësia dhe procedura për menaxhimin e mjedisit

Alternativa e rekomanduar cakton me shkrim një person përgjegjës për mjedisin dhe një zëvendësues. Përgjegjësi ka autoritet të ndalojë punën në rast rrjedhjeje, përzierjeje të mbeturinave, bllokimi të korridoreve ose rreziku të menjëhershëm për njerëzit; ky autoritet duhet të jetë i deklaruar shprehimisht në vendimin e emërimit, përndryshe funksioni mbetet formal.

Përgjegjësi mban regjistrin e hyrjeve dhe daljeve, të mbeturinave, të incidenteve, të ankesave, të trajnimeve, të kontrolleve periodike dhe të dorëzimeve te operatorët. Drejtori menaxhues mban përgjegjësinë për sigurimin e burimeve dhe për pajtueshmërinë e përgjithshme, ndërsa punëtorët kanë detyrimin të raportojnë menjëherë çdo anomali.

Procedurat rishikohen të paktën një herë në vit dhe detyrimisht pas çdo incidenti ose ndryshimi të procesit. Operatorët e kontraktuar verifikohen për licencë përpara çdo dorëzimi të parë dhe sa herë që licenca e tyre skadon; dëshmia e verifikimit ruhet në dosjen mjedisore.

5.16. Trajnime

Alternativa minimale – udhëzim fillestar verbal – nuk konsiderohet e mjaftueshme për këtë veprimtari, sepse rreziqet kryesore lidhen me vendime që merren nga punëtori në momentin e pranimit ose të trajtimit të një pjese. Alternativa e rekomanduar është trajnim i dokumentuar për të gjithë personelin relevant.

Përmbajtja minimale e trajnimit përfshin klasifikimin produkt–mbeturinë dhe pasojat e tij juridike; trajtimin e vajrave, të baterive dhe të lëngjeve teknike; përdorimin e absorbuesve dhe të kompleteve për derdhje; mbrojtjen nga zjarri dhe përdorimin e aparateve fikëse; ngritjen dhe stabilizimin e pjesëve të rënda; sigurinë e trafikut të brendshëm; përdorimin e pajisjeve mbrojtëse personale; dhe procedurën e raportimit të incidenteve.

Trajnimi kryhet para caktimit në punë, përsëritet periodikisht dhe verifikohet me listë pjesëmarrjeje ose me test praktik. Kontraktorët dhe transportuesit informohen për rregullat e lokacionit para hyrjes së parë; ky informim regjistrohet dhe përsëritet kur ndryshojnë rregullat ose zonat e punës.

5.17. Monitorimi

Alternativa pa monitorim nuk lejon verifikimin e performancës dhe as dëshmimin e pajtueshmërisë; prandaj ajo nuk konsiderohet e realizueshme. Alternativa e rekomanduar kombinon kontrolle vizuale të shpeshta me evidencë sasiore dhe me matje profesionale të aktivizuara sipas kushteve.

Kontrollet vizuale javore mbulojnë sipërfaqet, rrjedhjet, enët, etiketat, pusetat dhe korridoret. Evidenca mujore mbulon konsumin e ujit dhe të energjisë, numrin e automjeteve të servisuara, hyrjet e dërgesave, sasitë e mbeturinave dhe dorëzimet. Kontrolli periodik mbulon pajisjet kundër zjarrit, filtrat e kabinës dhe pajisjet e emergjencës. Rishikimi vjetor mbulon pajtueshmërinë e përgjithshme.


Matjet e zhurmës, të ujërave dhe të tokës aktivizohen nga kushtet e pëlqimit mjedisor, nga ankesat e verifikuara, nga incidentet ose nga ndryshimi i kapacitetit e i pajisjeve. Pikat, parametrat, metodat dhe frekuencat përfundimtare përcaktohen në Kapitullin 8; këtu vlerësohet vetëm alternativa organizative dhe përshtatshmëria e saj me shkallën e veprimtarisë.

5.18. Planet për situata emergjente

Skenarët kryesorë të identifikuar janë rrjedhja e vajit ose e karburantit, zjarri, dëmtimi i baterisë me derdhje elektroliti, rrëzimi i pjesëve të rënda, aksidenti gjatë manovrimit, reshjet ekstreme me përmbytje lokale, tërmeti dhe hyrja e personave të paautorizuar. Këta skenarë rrjedhin drejtpërdrejt nga natyra e materialeve dhe e pajisjeve të përshkruara në pikën 5.5.

Alternativa e rekomanduar ka plan të shkruar emergjence, të vendosur në lokacion dhe të njohur nga i gjithë personeli, me numra emergjentë, rrugë evakuimi, pikë grumbullimi, pajisje absorbuese, aparate zjarrfikëse dhe përgjegjësi të caktuara për secilin rol. Pajisjet duhet të jenë të qasshme dhe të kontrolluara periodikisht; korridoret dhe daljet nuk bllokohen nga stoku në asnjë rrethanë.

Çdo incident dokumentohet me shkakun, sasinë e vlerësuar, zonën e prekur, kohën e reagimit dhe masat korrigjuese; mbeturinat e krijuara gjatë ndërhyrjes trajtohen si të kontaminuara. Ushtrimi praktik kryhet të paktën një herë në vit dhe rezultatet e tij përdoren për të korrigjuar planin.



LLOJET KRYESORE TË SITUATAVE EMERGJENTE DHE VEPRIMET KRYESORE

Nr.	Situata emergjente	Veprimi kryesor
1	Zjarri	Alarm, evakuim, fikje fillestare dhe thirrja e shërbimeve emergjente
2	Derdhja e vajit/karburantit	Ndalimi i rrjedhjes, izolimi, absorbimi dhe grumbullimi
3	Rrjedhja e lëngjeve të automjeteve	Izolimi i zonës dhe përdorimi i materialeve absorbuse
4	Aksident në punë	Ndihma e parë, sigurimi i zonës dhe njoftimi i emergjencës
5	Prerja/dëmtimi i pjesëve strukturore	Ndërprerja e punës dhe sigurimi i pjesëve/materialeve
6	Dëmtimi i baterive	Izolimi dhe magazinimi në kushte të sigurta
7	Ndotja e tokës	Kufizimi i zonës, largimi i dheut të kontaminuar dhe trajtimi i tij
8	Derdhja në kanalizim	Bllokimi i rrjedhjes dhe parandalimi i hyrjes në sistemin e kanalizimit
9	Aksident me automjet	Sigurimi i vendit dhe largimi i rrezikut
10	Tërmet/fenomen natyror	Ndërprerja e punës, evakuimi dhe kontrolli i objektit

Skema 2. Skema e reagimit ndaj situatave emergjente dhe e përgjegjësive

Burimi: Skemë e përgatitur për raportin mbi bazën e skenarëve të identifikuar dhe të praktikave të reagimit emergjent.

Skema paraqet tri linjat kryesore të reagimit – zjarr, derdhje ose rrjedhje, dhe aksident me lëndim – si dhe rrjedhën e përbashkët të veprimeve pas kontrollit të ngjarjes: kufizimi i pasojave, grumbullimi i materialeve të kontaminuara, magazinimi i sigurt, dorëzimi te operatori i autorizuar, raportimi, hetimi, masat korrigjuese dhe rikthimi në operim të sigurt.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Në alternativën e vazhdimit nuk parashihet demolim i menjëhershëm i objekteve ekzistuese. Demolimi bëhet i mundshëm vetëm në dy raste: si pjesë e punimeve të zgjerimit, nëse projekti zbatues e kërkon heqjen e ndonjë strukture ndihmëse; ose në fund të jetës së veprimtarisë.

Në mbyllje, alternativa e preferuar është çmontimi selektiv dhe jo demolimi i drejtpërdrejtë. Ai përfshin inventarizimin dhe shitjen ose ripërdorimin e pajisjeve, largimin e të gjitha lëngjeve dhe mbeturinave nga operatorë të licencuar, pastrimin e objekteve dhe të sipërfaqeve, kontrollin e tokës në zonat me rrezik dhe rehabilitimin e sipërfaqeve sipas gjetjeve.

Nëse analizat tregojnë ndotje, rehabilitimi projektohet sipas shtrirjes dhe përqendrimit të konstatuar dhe nuk kufizohet në mbulim sipërfaqësor. Objektet nuk demolohen pa dokumentacionin përkatës, pa kontroll paraprak për materiale të rrezikshme në strukturë dhe pa plan të menaxhimit të mbeturinave të ndërtimit e të demolimit.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Alternativa e rekomanduar është një Plan i Menaxhimit Mjedisor proporcional me rrezikun dhe i integruar në operimin ditor, jo një dokument i veçantë që qëndron pa përdorim. Plani lidh çdo masë me përgjegjësin, afatin, treguesin e zbatimit, dëshminë që ruhet dhe veprimin korrigjues në rast mospërputhjeje.

Fushat që mbulon plani janë ajri dhe pluhuri, zhurma, toka, ujërat, mbeturinat, trafiku, siguria nga zjarri, ankesat dhe emergjencat. Struktura e plotë e planit, rolet, kontrollet dhe afatet zhvillohen në Kapitullin 9; këtu paraqiten vetëm elementet themelore që e bëjnë alternativën të realizueshme.

Tabela 31. Elementet themelore të Planit të Menaxhimit Mjedisor

Fusha	Kontrolli kryesor	Treguesi i zbatimit
Pjesët dhe stoku	Zonim, etiketim, rafte ose mbajtëse, kufi maksimal i sasisë	Asnjë pjesë në korridore ose në kontakt të drejtpërdrejtë me tokën
Ujërat dhe toka	Sipërfaqe të papërshkueshme, mbulim, drenazhim i kontrolluar	Pa rrjedhje të pashuara dhe pa shkarkim të lëngjeve teknike
Mbeturinat	Ndarje, enë të përshtatshme, regjistër dhe operator i licencuar	Dëshmi për çdo dorëzim dhe bilanc sasior mujor
Ajri dhe zhurma	Filtra dhe ventilim funksional, aspirim lokal, orar i kontrolluar	Pa emetim të dukshëm jashtë zonës dhe pa ankesa të pazgjidhura
Trafiku	Qarkullim i shënuar, parkim i ndarë, shpejtësi e kufizuar	Pa bllokim të rrugës publike
Emergjencat	Plan, pajisje, trajnim dhe ushtrim vjetor	Kontrolle periodike të dokumentuara dhe raport incidenti
Menaxhimi	Përgjegjës i emëruar, auditim i brendshëm dhe rishikim	Regjistra të plotë dhe masa korrigjuese të mbyllura brenda afatit

Burimi: Struktura e Planit të Menaxhimit Mjedisor sipas nenit 13 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Treguesit e kolonës së tretë janë formuluar në mënyrë binare – ose plotësohen, ose jo – sepse tregues me formulim të përgjithshëm nuk mund të verifikohen nga inspektimi. Kjo zgjedhje metodologjike ruhet edhe në Kapitujt 7, 8 dhe 9.

5.21. Përshkrimi i alternativave pa veprim

Për një veprimtari ekzistuese, shprehja “pa veprim” ka dy kuptime të ndryshme që duhen dalluar qartë. Kuptimi i parë është vazhdimi i gjendjes aktuale pa investime dhe pa masa shtesë, që korrespondon me Alternativën B. Kuptimi i dytë është mosmiratimi ose ndërprerja e aktivitetit.

Në kuptimin e parë, mosveprimi nuk e ruan gjendjen e mjedisit të pandryshuar. Pa ndërhyrje, sipërfaqet e pashtruara degradohen më tej, kontakti i reshjeve me pjesët e ruajtura jashtë mbetet i pakontrolluar, rrymat e mbeturinave mbeten pa gjurmueshmëri, ngarkesa vizuale rritet me akumulimin e stokut dhe mundësia për të dalluar ndotjen historike nga ajo e re humbet përfundimisht. Prandaj mosveprimi është trajektore me përkeqësim të ngadaltë dhe kumulativ, jo gjendje e qëndrueshme.

Në kuptimin e dytë, ndërprerja e aktivitetit do të ndalonte hyrjet e reja, do të kërkonte largimin ose shitjen e inventarit të përdorshëm, dorëzimin e mbeturinave, pastrimin e sipërfaqeve dhe kontrollin e tokës për ndotje. Përfitimi mjedisor do të ishte eliminimi i presioneve operative në lokacion; kostot do të ishin humbja e aktivitetit ekonomik, e të ardhurave, e shërbimit për klientët dhe e vendeve të punës, si dhe kostoja e vetë procesit të mbylljes dhe të rehabilitimit.

Krahasimi tregon se alternativa më e balancuar është vazhdimi me përmirësime të detyrueshme. Alternativa pa veprim nuk duhet të përdoret si arsyetim për ruajtjen e gjendjes së tanishme. Nëse masat nuk realizohen brenda afateve të përcaktuara ose nëse veprimtaria nuk merr autorizimet e kërkuara, zgjidhja e mbetur nuk është vazhdimi pa ndryshime, por mbyllja e kontrolluar ose zhvendosja.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT 5

Për shkak të karakterit ekzistues të veprimtarisë, të përputhjes së përgjithshme me përdorimin komercial të zonës dhe të pranisë së infrastrukturës, Alternativa A – vazhdimi në lokacionin aktual me përmirësime të verifikueshme – vlerësohet si alternativa e preferuar. Kjo përzgjedhje nuk nënkupton pranim automatik të gjendjes ekzistuese dhe as të praktikave të pakontrolluara. Zbatueshmëria e saj varet nga harmonizimi kadastral, nga lejet, nga planimetria funksionale e aprovuar, nga kontrolli i ujërave dhe i tokës, nga menaxhimi i dokumentuar i mbeturinave, nga kufizimi i kapacitetit dhe nga plotësimi i të dhënave të identifikuara si boshllëqe në Kapitullin 4.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

Vlerësimi i këtij kapitulli i referohet veprimtarisë ekzistuese të AUTO SELIMI SH.P.K. në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, e cila zhvillohet nga ora 08:00–16:00, e hënë – e shtunë, me kapacitet të deklaruar prej rreth 30 automjetesh të riparuara dhe rreth 15 veturash ose furgonësh të prerë në seksione për pjesë, të importuara në muaj. Prerja fillestare kryhet jashtë Republikës së Kosovës.

Titujt dhe renditja 6.1–6.44 janë bartur pa ndryshim nga Shtojca I e UA-së nr. 04/2025. Përshkrimi dallon në mënyrë sistematike ndikimet e funksionimit normal, ndikimet aksidentale, ndikimet e përkohshme nga riorganizimi dhe nga punimet e zgjerimit, si dhe ndikimet kumulative me aktivitetet përreth. Kur mungojnë matje ose bilance të operatorit, kjo identifikohet shprehimisht si boshllëk i të dhënave dhe jo si mungesë ndikimi.

Metodologjia e vlerësimit është cilësore dhe e strukturuar. Për secilin ndikim identifikohen burimi, faza e projektit, aspekti mjedisor, receptori, rruga e përhapjes, natyra, shtrirja hapësinore, kohëzgjatja, frekuenca, probabiliteti, intensiteti dhe ndjeshmëria e receptorit. Mbi këtë bazë përcaktohet rëndësia para masave, pastaj masat parandaluese e zbutëse, ndikimi i mbetur pas masave dhe kërkesa për monitorim.

Tabela 32. Kriteret e përdorura për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve

Kriteri	Shkalla e përdorur	Sqarimi i zbatimit
Natyra	Pozitiv / negativ / neutral	Drejtimi i ndryshimit krahasuar me gjendjen bazë
Shtrirja hapësinore	Brenda lokacionit / lokale / komunale / rajonale / ndërkufitare	Distanca maksimale në të cilën ndryshimi mbetet i dallueshëm
Kohëzgjatja	E përkohshme / afatshkurtër / afatgjatë / e përhershme	Koha gjatë së cilës ndryshimi vazhdon pas ndërprerjes së burimit
Frekuenca	E rastësishme / periodike / e vazhdueshme	Shpeshtësia e shfaqjes gjatë orarit të punës
Kthyeshmëria	E kthyeshme / pjesërisht e kthyeshme / e pakthyeshme	Mundësia e rikthimit në gjendjen bazë pas ndërhyrjes
Probabiliteti	I sigurt / i mundshëm / i pamundshëm	Gjasa e shfaqjes në kushtet e operimit të përshkruar
Ndjeshmëria e receptorit	E ulët / e mesme / e lartë	Vlera, prania dhe cenueshmëria e receptorit të identifikuar
Rëndësia	E papërfillshme / e ulët / e mesme / e lartë	Kombinim i kritereve të mësipërme; jepet para dhe pas masave

Burimi: Metodologji e strukturuar e vlerësimit, e përshtatur me kërkesat e nenit 10 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Aty ku mungon matja, përfundimi nuk jepet si konstatim numerik, por si vlerësim i arsyetuar me bazën e tij të deklaruar. Kjo qasje ruhet në të gjitha pikat e këtij kapitulli dhe e bën të gjurmueshëm çdo hap nga burimi te përfundimi.

6.1. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë

Ndikimet kryesore të identifikuara lidhen me lëvizjen dhe ndezjen e automjeteve, me veglat mekanike dhe kompresorin, me punët e karrocerisë dhe të lyerjes, me ruajtjen e automjeteve e të pjesëve në hapësirë të jashtme, me ujërat atmosferike që mund të kontaktojnë komponentë me lëngje të mbetura, me gjenerimin e mbeturinave nga servisimi dhe me ngarkesën vizuale të stokut.

Në lokacion nuk parashihen shkrirje metalesh, djegie, copëtim industrial, trajtim termik ose deponim përfundimtar. Ky kufizim teknologjik e përjashton një grup të tërë ndikimesh tipike të industrisë së riciklimit të automjeteve dhe e zvogëlon ndjeshëm profilin e rrezikut të projektit krahasuar me një qendër trajtimi të automjeteve në fund të jetës.

Në funksionim normal, ndikimet vlerësohen kryesisht lokale, të kontrollueshme dhe në një pjesë të konsiderueshme të kthyeshme. Rreziku më i rëndësishëm potencial mbetet ndotja e tokës dhe e ujërave nga rrjedhjet e vajrave, karburanteve, antifrizit, lëngjeve të frenave dhe elektrolitit të baterive. Rreziqe të tjera me peshë janë zhurma te receptorët e afërt, emetimet e VOC-ve nga lyerja, pluhuri nga bluarja, trafiku në hyrje, zjarri dhe përzierja e pjesëve-produkt me mbeturinat.

Tabela 33. Pasqyra përmbledhëse e ndikimeve sipas komponentëve mjedisorë

Komponenti	Burimi kryesor i ndikimit	Shtrirja e pritshme	Rëndësia para masave
Ajri	Trafiku, ndezjet provuese, pluhuri i bluarjes, tymi i saldimit dhe VOC-të nga lyerja	Lokacioni dhe korridori rrugor i afërt	E ulët deri e mesme
Ujërat dhe toka	Rrjedhje lëngjesh, reshje mbi pjesë të pakulluara, drenazhim i pakontrolluar	Lokacioni dhe rrjedha e afërt lindore–juglindore	E mesme; e lartë në rast aksidenti
Zhurma	Vegla pneumatike, kompresor, manovrim dhe ngarkim-shkarkim	Kufiri i parcelës dhe objektet e afërta	E mesme
Mbeturinat	Servisimi, karroceria, lyerja dhe pjesët e papërdorshme	Brenda lokacionit dhe te operatori pranues	E mesme
Popullsia dhe peizazhi	Trafiku, zhurma, erërat dhe stoku i dukshëm nga rruga	Objektet e afërta dhe korridori rrugor	E ulët deri e mesme
Biodiversiteti	Ndotja aksidentale dhe heqja eventuale e vegjetacionit periferik	Skajet e parcelës dhe parcelat fqinje	E ulët
Klima	Konsumi i energjisë dhe transporti	Kombëtare dhe globale, me peshë të vogël	E ulët

Burimi: Sinteza e vlerësimit të këtij kapitulli mbi bazën e gjendjes bazë të Kapitullit 4.

Kolona e fundit paraqet rëndësinë para zbatimit të masave. Ndikimi i mbetur pas masave paraqitet në matricën përmbledhëse në fund të kapitullit dhe lidhet me treguesit e monitorimit të Kapitullit 8.

6.2. Cilësinë e ajrit

Vlerësimi i cilësisë së ajrit mbulon katër burime të identifikuara: trafikun dhe ndezjet provuese; pluhurin nga bluarja dhe nga sipërfaqet e pambuluara; tymin e saldimit; dhe përbërjet organike të avullueshme nga përgatitja e sipërfaqes dhe nga lyerja. Vetëm i fundit përbën burim të palëvizshëm në kuptimin e legjislacionit për shkarkimet në ajër.

Receptorët e identifikuar janë punëtorët brenda objektit, klientët dhe kalimtarët në zonën e hyrjes, si dhe përdoruesit e objekteve fqinje. Rruga e përhapjes është ajrore dhe varet nga drejtimi i erës, nga funksionimi i ventilimit dhe i filtrave dhe nga orientimi i portave të objektit.

Rëndësia e ndikimit varet nga kohëzgjatja e punëve me emetim, nga gjendja e filtrave, nga kushtet meteorologjike dhe nga distanca deri te receptori. Pa matje nuk pretendohet përputhshmëri numerike me vlerat kufitare; vlerësimi bazohet në identifikimin e burimit, në shkallën e aktivitetit dhe në efektivitetin e pritshëm të masave.

6.3. Nivelin dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi

Ndotësit relevantë për këtë veprimtari janë grimcat PM_{10} dhe $PM_{2,5}$ nga bluarja e nga trafiku, NO_2 dhe CO nga djegia në motorët me djegie të brendshme, benzeni dhe përbërjet organike të avullueshme nga bojërat, tretësit e primerët, si dhe grimcat metalike nga saldimi.

Nuk ekziston bazë për të parashikuar përqendrime të larta të vazhdueshme nga vetë projekti, sepse nuk ka burim industrial të palëvizshëm me punë të vazhdueshme dhe as oxhak të lartë. Kabina e lyerjes punon në mënyrë periodike dhe me sistem filtrimi; emetimet e saj janë të kufizuara në kohë dhe të lidhura drejtpërdrejt me numrin e automjeteve që i nënshtrohen lyerjes.

Krahasimi numerik me vlerat kufitare të legjislacionit nuk mund të kryhet pa matje në kufirin e lokacionit dhe te receptori më i afërt. Vlerësimi cilësor i dhënë këtu nuk e zëvendëson monitorimin nëse ai kërkohet nga autoriteti ose nëse paraqiten ankesa të verifikuara; për këtë arsye pika A-1 e programit të monitorimit parashikon matje të aktivizueshme sipas kushtit ose ankesës.

6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike

Emetimet e gazeve serrë të lidhura me projektin janë kryesisht indirekte, nga konsumi i energjisë elektrike për ndriçim, vegla, kompresor dhe kabinë lyerjeje, si dhe të drejtpërdrejta nga automjetet e transportit, nga automjetet e klientëve dhe nga ndezjet provuese. Në lokacion nuk ka kaldajë industriale, proces termik të deklaruar ose djegie të vazhdueshme të karburantit.

Për shkak të shkallës së aktivitetit – rreth 30 automjete të servisuara dhe rreth 15 njësi të importuara në muaj – kontributi i projektit në emetimet komunale dhe kombëtare vlerësohet i vogël, por jo zero. Ai nuk mund të shprehet në ton CO_2 ekuivalent pa të dhëna për konsumin e energjisë, për kilometrazhin e transportit dhe për sasinë e karburantit; këto të dhëna hyjnë në evidencën mujore të Kapitullit 8.

Ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike është më materiale se kontributi i tij. Reshjet intensive rrisin shpëlarjen e sipërfaqeve dhe kontaktin e ujit me pjesët e ruajtura jashtë; temperaturat e larta rrisin avullimin e tretësve dhe rrezikun nga zjarri; erërat e forta mund të shpërndajnë materiale të lehta dhe pluhur; ngrica mund të dëmtojë drenazhimin dhe instalimet. Prandaj masat e përshtatjes klimatike janë pjesë e detyrueshme e Kapitullit 7.

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit

Nuk identifikohet rrugë e ndikimit ndërkufitar në ajër. Burimet e identifikuara janë të vogla, të shpërndara dhe me shtrirje lokale; nuk ka oxhak të lartë, djegie të vazhdueshme, proces kimik në shkallë industriale ose vëllim emetimesh që mund të transportohet në distanca ndërkombëtare.

Distanca e lokacionit nga kufiri shtetëror më i afërt, kombinuar me natyrën periodike dhe me intensitetin e ulët të emetimeve, e bën të pamundshëm një ndikim të matshëm përtej kufirit. Prandaj për këtë komponent nuk propozohet program ndërkufitar monitorimi, në përputhje me pikën 8.7.

Ky përfundim do të rishikohej vetëm nëse projekti do të ndryshonte thelbësisht – për shembull, me futjen e një procesi djegieje, të një impianti trajtimi termik ose të një kapaciteti shumë më të madh lyerjeje. Çdo ndryshim i tillë do të trajtohej sipas procedurës së menaxhimit të ndryshimit të përcaktuar në Kapitullin 9.

6.6. Cilësia e ujit

Për këtë veprimtari, uji nuk është lëndë e parë teknologjike. Sipas deklarimit të aplikuesit, uji merret nga kompania rajonale e ujësjellësit për nevoja sanitare dhe për pastrim të kufizuar, ndërsa ujërat fekale shkarkohen në kanalizimin e vendbanimit. Nuk është deklaruar asnjë proces industrial me konsum të vazhdueshëm uji ose me shkarkim teknologjik.

Rruga kryesore e ndikimit mbi ujërat nuk kalon nëpër konsumin, por nëpër kontaktin e reshjeve ose të ujit të pastrimit me vajra, hidrokarbure, bojëra, tretës, metale dhe grimca të ngurta të pranishme në sipërfaqet operative dhe në pjesët e ruajtura jashtë. Nga aty, ndotësit mund të barten drejt tokës, drejt pusetave dhe, në rastin më të pafavorshëm, drejt rrjedhës ujore në afërsi lindore–juglindore.

Shtrirja vlerësohet lokale në operim normal, por mund të rritet ndjeshëm gjatë një derdhjeje ose gjatë një reshjeje intensive. Mungesa e planit të drenazhimit dhe e matjeve bazë e rrit pasigurinë e vlerësimit; për këtë arsye masat për ujërat janë të para në renditjen e prioriteteve të Kapitullit 7.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Në funksionim normal, pa rrjedhje dhe pa larje të pakontrolluar, ndikimi mbi ujërat vlerësohet të jetë i ulët. Në rast rrjedhjeje të paizoluar ose reshjesh mbi pjesë të pakulluara, ndikimi mund të bëhet i mesëm deri i lartë në shkallë lokale, veçanërisht nëse ujërat dalin nga parcela pa kaluar nëpër ndonjë element mbajtës.

Ndotësit relevantë janë hidrokarburet totale të naftës, vajrat mineralë, metalet e rënda nga grimcat dhe nga bateritë, glikoli nga antifrizi, lëngjet e frenave me bazë glikol-eteri dhe lëndët e ngurta të pezulluara. Për ujërat nëntokësore, rreziku përcaktohet nga natyra e depozitimeve proluviale të pakonsoliduara, të cilat nuk ofrojnë barrierë të besueshme natyrore.

Nuk ekzistojnë të dhëna për nivelin e ujit nëntokësor, për përshkueshmërinë e shtresave dhe as për cilësinë e rrjedhës ujore në afërsi. Prandaj nuk mund të përcaktohet përqendrimi në receptor dhe as koha e migrimit; vlerësimi mbetet cilësor dhe i bazuar në parimin e kujdesit, ndërsa masat dimensionohen për të parandaluar arritjen e ndotësve te uji, jo për ta trajtuar atë pasi të jetë ndotur.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave

Nuk identifikohet rrugë e ndotjes ndërkufitare të ujërave. Projekti nuk shkarkon drejtpërdrejt në një trup ujor ndërkufitar dhe vëllimi maksimal i mundshëm i një derdhjeje aksidentale në lokacion është i kufizuar nga sasia e lëngjeve që ruhen njëkohësisht.

Megjithatë, çdo rrjedhje duhet trajtuar si incident me potencial përhapjeje, sepse rrjeti lokal i ujërave lidhet me pellgun më të gjerë hidrografik. Kjo do të thotë se pasoja e një derdhjeje nuk kufizohet domosdoshmërisht në parcelë, edhe kur shtrirja ndërkufitare mbetet e pamundshme.

Programi ndërkufitar i monitorimit nuk propozohet për këtë komponent. Ai do të aktivizohej vetëm në rast se do të ndryshonte projekti, do të identifikohej një rrugë reale ndikimi ose do të ndodhte një incident me pasoja të dokumentuara jashtë territorit, sipas pikës 8.7.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti nuk parashikon devijim shtrati, mbushje, gërmim në trup ujor ose ndonjë ndërhyrje tjetër që ndryshon morfologjinë e rrjedhës së afërt. Prandaj ndikimi hidromorfologjik vlerësohet i papërfillshëm.

Ujërat e zeza që gjenerohen janë vetëm sanitare dhe rrjedhin nga nyjat sanitare të përdorura nga punëtorët dhe klientët. Sasia e tyre lidhet me numrin e personave dhe jo me kapacitetin e servisimit apo me sasinë e pjesëve. Këto ujëra shkarkohen në kanalizimin e vendbanimit dhe nuk duhet të përzihen në asnjë rrethanë me vajra, antifriz, lëngje frenash ose ujëra nga larja e pjesëve.

Kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) nr. 02/2022. Meqë nuk ekziston bilanc i ujit dhe as matje e shkarkimit, sasia aktuale nuk mund të krahasohet me këto kushte; dëshmia e kyçjes dhe evidenca e konsumit janë hapat e parë që e mundësojnë këtë krahasim.

6.10. Toka

Burimet e presionit mbi tokën janë rrjedhjet nga automjetet dhe nga enët, mbetjet e karrocerisë e të lyerjes, ngjeshja mekanike nga lëvizja e mjeteve të rënda dhe punimet e kufizuara për realizimin e zgjerimeve. Receptori është vetë profili i tokës brenda dhe në skajet e parcelës, si dhe nëntoka poshtë saj.

Sipërfaqja operative është kryesisht e shtruar, por me pjesë të hapura në skaje. Pikërisht këto pjesë të hapura përbëjnë rrugën e drejtpërdrejtë të infiltrimit; sipërfaqja e shtruar e transformon rrezikun nga infiltrim i drejtpërdrejtë në rrjedhje sipërfaqësore, e cila mund të kontrollohet nëse ekziston drenazhim, ose të përhapet nëse ai mungon.

Ndikimi normal mbi tokën është i parandalueshëm me masa relativisht të thjeshta. Përkundrazi, një rrjedhje e paizoluar shkakton ndotje afatgjatë, të vështirë për t'u zbuluar dhe të kushtueshme për rehabilitim. Gjendja historike nuk mund të ndahet nga ndikimi i ardhshëm pa mostrim bazë; ky është arsyeja teknike dhe juridike pse mostrimi i tokës në pikat me rrezik renditet ndër prioritetet e para.

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj

Veprimtaria është ekzistuese dhe nuk parashikon ndryshim të topografisë, gërmime të mëdha ose krijim shpatesh. Terreni është fushor dhe rreziku i rrëshqitjes vlerësohet i ulët; nuk janë vërejtur shenja paqëndrueshmërie brenda parcelës.

Ndikimi fizik i identifikueshëm rrjedh nga tri burime: ngjeshja e tokës në pjesët e pashtruara nga lëvizja e vazhdueshme e mjeteve; dëmtimi mekanik i sipërfaqeve të shtruara nga ngarkesat e rënda dhe nga manovrimi; dhe erozioni lokal i sipërfaqes atje ku uji rrjedh i pakontrolluar drejt skajeve të parcelës.

Punimet e riorganizimit dhe të zgjerimit mund të shkaktojnë përkohësisht pluhur dhe heqje të kufizuar të shtresës sipërfaqësore në gjurmën e ndërtimit. Këto ndikime janë të përkohshme, lokale dhe të kthyeshme, dhe nuk përbëjnë transformim gjeomorfologjik. Ato kontrollohen me kufizim të zonës së punës, me lagie ose pastrim të kontrolluar dhe me rikthim të sipërfaqes pas përfundimit.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimi me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Burimet e mundshme të ndotjes së tokës janë vajrat e përdorura, mbetjet e karburantit në rezervuarët e pjesëve të importuara, lëngjet e frenave, antifrizi, elektroliti i baterive, mbetjet e bojërave dhe të tretësve, absorbuesit e kontaminuar dhe grimcat metalike të vajosura nga bluarja.

Në operim normal, ndikimi duhet të mbetet brenda zonës operative dhe brenda sipërfaqeve të papërshkueshme. Në rast aksidenti ose gjatë reshjeve intensive, ai mund të përhapet drejt skajeve të parcelës dhe, me ujërat atmosferike, drejt zonave fqinje. Shtrirja reale varet drejtpërdrejt nga ekzistenca e mbajtjes sekondare dhe nga koha e reagimit.

Nuk ekzistojnë analiza të tokës për hidrokarbure totale, BTEX, plumb, kadmium, krom, nikel ose parametra të tjerë. Pa mostra nuk mund të bëhet krahasim me vlerat e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe nuk mund të ndahet ndotja historike nga ndikimi i ardhshëm. Ky kufizim është regjistruar si boshllëk i të dhënave dhe i korrespondon pika T-1 dhe T-2 e programit të monitorimit.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Lokacioni tashmë përdoret për veprimtari komerciale dhe shërbyese. Vazhdimi i tij nuk kërkon parcelë të re, nuk shfrytëzon mineral, pyll, ujë procesi ose burim tjetër natyror në sasi industriale dhe nuk shkakton fragmentim të ri të tokës jashtë kufirit.

Konsumi kryesor i burimeve është energjia elektrike, uji sanitar, materialet e servisimit dhe vetë sipërfaqja ekzistuese. Ripërdorimi i pjesëve të automjeteve, i cili është thelbi i veprimtarisë tregtare, ka efekt të kundërt pozitiv, sepse zvogëlon kërkesën për pjesë të reja dhe për burimet natyrore e energjinë e nevojshme për prodhimin e tyre.

Ndikimi mbi shfrytëzimin e tokës brenda parcelës lidhet me intensitetin e magazinimit dhe me ruajtjen e hapësirave të lira. Rritja e stokut mbi kapacitetin e sigurt do të zinte korridoret e qarkullimit dhe zonat tampon, duke e shndërruar një përdorim të organizuar në grumbullim. Kufizimi i sasisë maksimale të ruajtur njëkohësisht është prandaj masë e shfrytëzimit racional të tokës dhe jo vetëm masë sigurie.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Brenda kufirit ekzistues të projektit nuk parashihet humbje e re e tokës bujqësore. Parcelat janë në përdorim komercial, aktiviteti zhvillohet në gjurmën aktuale dhe të dy zgjerimet e planifikuara realizohen brenda po atij kufiri, në sipërfaqe tashmë të transformuara.

Sipërfaqet bujqësore ose të hapura që shtrihen përreth nuk preken drejtpërdrejt, sepse projekti nuk parashikon zgjerim jashtë parcelave dhe nuk kërkon rrugë të reja. Cilësia e tokës në ato sipërfaqe mund të ndikohet vetëm në mënyrë indirekte, në rast rrjedhjeje ose bartjeje me ujërat atmosferike përtej kufirit.

Çdo zgjerim i ardhshëm jashtë parcelave do të kërkonte vlerësim të ri të klasës bujqësore të tokës, të sipërfaqes së humbur dhe të pajtueshmërisë me planifikimin hapësinor. Ky do të përbënte ndryshim thelbësor të projektit dhe do të kalonte përmes procedurës së menaxhimit të ndryshimit dhe përmes vlerësimit të ri nga autoriteti kompetent.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Projekti nuk nxjerr material gjeologjik, nuk ndërhyn në formacione shkëmbore, nuk prek veçori paleontologjike dhe nuk ndryshon relievin. Punimet e planifikuara kufizohen në themele dhe në sipërfaqe, brenda depozitimeve të reja proluviale.

Prandaj ndikimi i drejtpërdrejtë mbi gjeologjinë dhe gjeomorfologjinë vlerësohet i papërfillshëm. Nuk identifikohet asnjë element gjeologjik me vlerë të veçantë brenda ose në afërsi të kufirit të projektit.

Rreziku relevant për këtë komponent nuk është ndryshimi i strukturës gjeologjike, por depërtimi i ndotësve në depozitimet sipërfaqësore të pakonsoliduara. Ky rrezik trajtohet plotësisht në pikat për tokën dhe për ujërat nëntokësore dhe nuk zhvillohet më tej këtu.

6.16. Popullsia lokale

Receptorët njerëzorë të identifikuar janë punëtorët, klientët, kalimtarët, përdoruesit e objekteve fqinje dhe banorët përgjatë korridorit rrugor. Komuna e Lipjanit ka 55.044 banorë sipas Regjistrimit 2024, me përqendrim urban në rritje dhe me dendësim të vazhdueshëm të zonave periurbane.

Ekspozimi i mundshëm vjen nga zhurma, pluhuri dhe VOC-të, trafiku në hyrje, ndriçimi i jashtëm, pamja e stokut dhe rreziku i rrallë nga zjarri ose rrjedhja. Ndjeshmëria e receptorit vlerësohet e mesme deri e lartë për objektet ngjitur me zonën operative dhe e ulët për qendrat e vendbanimeve në qindra metra distancë.

Rëndësia e ndikimit është më e madhe gjatë punëve të zhurmshme, gjatë lyerjes, gjatë ngarkim-shkarkimit dhe gjatë manovrimit të mjeteve të rënda. Ajo vlerësohet te receptori më i afërt dhe jo kundrejt qendrave të vendbanimeve; ky është një ndryshim thelbësor metodologjik që përcakton edhe pozicionimin e pikave të matjes në Kapitullin 8.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsia, përqendrimi dhe migrimi

Kapaciteti aktual i deklaruar nuk e ndryshon numrin, strukturën ose migrimin e popullsisë. Projekti nuk krijon kamp pune, nuk kërkon rezidencë për personelin dhe nuk gjeneron fluks të madh punëtorësh nga jashtë zonës.

Ndikimi demografik i drejtpërdrejtë vlerësohet neutral. Ndikimi i mundshëm indirekt lidhet me cilësinë e jetesës së receptorëve të afërt – me zhurmën, me pamjen dhe me trafikun – dhe jo me lëvizjen e popullsisë.

Trendi i dendësimit urban i konstatuar në Kapitullin 3 ka pasojë të kundërt: nuk është projekti që ndryshon popullsinë, por popullsia që ndryshon kontekstin e projektit. Rritja e njësive të banimit nga 13.647 në 19.434 tregon se numri i receptorëve të mundshëm në afërsi ka gjasa të rritet; prandaj masat duhet të projektohen me marzh dhe jo në kufirin e pranueshmërisë aktuale.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Automjetet, furgonët dhe pjesët strukturore të ruajtura në hapësirë të jashtme janë të dukshme nga rruga Bajram Gashi dhe nga objektet e afërta. Ngarkesa vizuale rritet me lartësinë, me dendësinë dhe me çrregullsinë e radhitjes së stokut, siç dëshmohet nga fotografitë e terrenit dhe nga ortofotoja.

Ndikimi vlerësohet negativ, lokal dhe afatgjatë për aq kohë sa magazinimi mbetet i ekspozuar. Ai nuk përbën shkelje në vetvete, por përcakton mënyrën se si veprimtaria lexohet nga fqinjët dhe nga kalimtarët, dhe rrjedhimisht gjasën e ankesave dhe të konfliktit me përdorimet e tjera të korridorit.

Riorganizimi funksional i propozuar në Kapitullin 5 parashikon ndarje të zonave, kufizim të lartësisë së stokut dhe zonë tampon. Pa këtë riorganizim, pamja aktuale mund të mbetet konfliktuale me karakterin periurban në zhvillim; me të, ndikimi i mbetur vlerësohet i ulët deri i mesëm dhe i kthyeshëm.

6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit për shëndetin e njeriut

Zhurma gjenerohet nga veglat pneumatike, nga kompresori, nga ndezja e motorëve, nga manipulimi i pjesëve metalike dhe nga manovrimi i mjeteve. Karakteri i saj është kryesisht impulsiv dhe i ndërprerë, gjë që e bën më të dallueshme për receptorin sesa një zhurmë e vazhdueshme e së njëjtës energji.

Vibrimet janë të shkurtra dhe lokale; në lokacion nuk ka pajisje të rëndë me punë të vazhdueshme që të gjenerojë vibrime të transmetueshme përtej kufirit. Nxehtësia lidhet kryesisht me kushtet meteorologjike dhe

me punën e furrës së lyerjes brenda objektit. Nuk është deklaruar asnjë burim i rrezatimit jonizues dhe nuk janë identifikuar burime të rrezatimit jojonizues përtej pajisjeve elektrike standarde.

Ekspozimi profesional ndaj vajrave, tretësve, pluhurit metalik, gazrave të shkarkimit dhe elektrolitit të baterive prek kryesisht punëtorët dhe kontrollohet me ventilim, me pajisje mbrojtëse personale, me trajnim dhe me organizim të punës. Receptorët jashtë lokacionit mund të preken kryesisht nga zhurma dhe nga erërat. Pa matje, rëndësia akustike nuk mund të krahasohet me vlerat kufitare; prandaj matja bazë te receptori më i afërt është masa e parë e propozuar për këtë komponent.

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Efektet pozitive socio-ekonomike burojnë nga ofrimi i shërbimit lokal të riparimit, nga ripërdorimi i pjesëve që zgjat jetën e automjeteve dhe ul koston e mirëmbajtjes për qytetarët, nga punësimi dhe nga qarkullimi ekonomik i lidhur me furnizimin, doganimin dhe transportin.

Efektet negative të mundshme lidhen me incidentet mjedisore, me konfliktin e trafikut në hyrje, me uljen e cilësisë vizuale të korridorit dhe me ankesat e fqinjëve. Këto efekte nuk janë të pashmangshme; ato varen drejtpërdrejt nga zbatimi i masave organizative dhe teknike.

Në shkallë komunale, ndikimi ekonomik i projektit është i kufizuar për shkak të madhësisë së veprimtarisë; në nivel të biznesit dhe të klientëve të tij, ai është i drejtpërdrejtë dhe i prekshëm. Raporti nuk monetizon përfitimet ose kostot, sepse nuk disponon të dhëna financiare dhe sepse një monetizim i pambështetur do të ishte i pasaktë dhe i pagjurmueshëm.

6.21. Ndikimi i projektit në strukturen e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesor të zonës

Projekti i takon sektorit të shërbimeve dhe të tregtisë me pakicë të pjesëve të automjeteve, sipas kodeve 4520 dhe 4532. Ai mbështet serviset e tjera, transportin, doganimin dhe tregun e pjesëve, dhe funksionon si hallkë e ekonomisë qarkore duke zgjatur ciklin e jetës së komponentëve.

Dega kryesore ekonomike e zonës është tregtia dhe shërbimet përgjatë korridorit rrugor, çka e bën projektin të përputhshëm me strukturën ekzistuese. Shkalla e aktivitetit nuk është e mjaftueshme për të ndryshuar strukturën e ekonomisë komunale, por kontribuon në degën lokale të shërbimeve të automjeteve.

Ripërdorimi i pjesëve mund të ulë koston e riparimit për konsumatorin dhe kërkesën për pjesë të reja. Ky efekt është pozitiv nga këndvështrimi i përdorimit të burimeve, por nuk kuantifikohet në këtë raport dhe nuk përdoret për të kompensuar ndikimet e identifikuara mjedisore.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme te vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura

Faza e ndërtimit e parashikuar është e kufizuar dhe përfshin vetëm dy zgjerimet brenda kufirit ekzistues. Ajo mund të angazhojë përkohësisht kontraktorë dhe punëtorë ndërtimi për një periudhë prej disa muajsh, pa krijuar vende pune të përhershme.

Gjatë funksionimit ruhen vendet ekzistuese të punës. Vende shtesë mund të krijohen vetëm nëse rritet kapaciteti i autorizuar ose nëse zgjerimi i objekteve shoqërohet me zgjerim të shërbimeve. Dokumentet e ARBK-së shënojnë një punëtor të regjistruar. Numri faktik i personave që punojnë në lokacion nuk figuron në asnjë dokument të dosjes; ai deklarohet nga aplikuesi dhe përditësohet në regjistrimin e biznesit, sepse përcakton kërkesat për pajisje mbrojtëse, për nyje sanitare, për trajnime dhe për planin e evakuimit. Çështja është regjistruar në listën e çështjeve të hapura.

Nuk priten humbje vendesh pune në sektorë të tjerë si pasojë e projektit. Humbje do të ndodhnin vetëm në skenarin e mbylljes së veprimtarisë ose në rast konflikti të rëndë e të pazgjidhur me përdorimet fqinje; ky është një argument shtesë në favor të zbatimit të plotë të masave të propozuara.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Kontributi realizohet përmes detyrimeve tatimore, doganimit të importit, blerjeve lokale të materialeve dhe shërbimeve, angazhimit të transportuesve dhe tregtimit të pjesëve. Këto rrjedha janë reale, por me peshë të vogël në shkallë rajonale dhe kombëtare.

Kontributi më i veçantë i projektit nuk është vëllimi financiar, por funksioni i tij në zinxhirin e ripërdorimit. Në një treg ku parku i automjeteve është relativisht i vjetër, disponueshmëria e pjesëve të përdorura të kontrolluara mbështet mirëmbajtjen e rregullt të automjeteve, e cila ka efekt indirekt pozitiv edhe në emetimet e trafikut.

Vlera monetare e këtij kontributi nuk mund të llogaritet pa të dhëna financiare të operatorit dhe pa analizë të ciklit jetësor të pjesëve. Prandaj ai paraqitet cilësisht dhe nuk përdoret si argument kompensues ndaj ndikimeve negative të identifikuara.

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Lokacioni është i transformuar dhe ka vlerë të ulët si habitat natyror brenda kufirit të projektit. Nuk ka ndërhyrje në formacione gjeologjike dhe nuk identifikohet asnjë element i trashëgimisë gjeologjike ose paleontologjike në zonën e ndikimit.

Ndikimet ekologjike të mundshme janë katër: humbja e vegjetacionit periferik nëse punimet e zgjerimit dalin nga gjurma e aprovuar; shqetësimi i faunës së zakonshme urbane e periurbane nga zhurma dhe nga ndriçimi; ndotja aksidentale e tokës ose e ujit që përhapet jashtë parcelës; dhe ndikimi indirekt i ndriçimit të jashtëm mbi speciet nokturne.

Parcela është e transformuar, por skajet e gjelbëruara dhe tokat e hapura përreth mund të përdoren nga specie të zakonshme. Libri i Kuq i Florës Vaskulare dhe Libri i Kuq i Faunës përdoren si burime kontrolli për statusin e ruajtjes së llojeve që mund të jenë potencialisht të pranishme; asnjë lloj nuk deklarohet i pranishëm në lokacion vetëm mbi bazën e këtyre burimeve.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Brenda zonës operative nuk janë identifikuar habitate kritike, specie të mbrojtura ose korridore ekologjike të konfirmuara. Vazhdimi i veprimtarisë në gjurmën ekzistuese nuk shkakton humbje të konsiderueshme habitati, sepse sipërfaqja tashmë është e transformuar dhe nuk mbulohet nga vegjetacion natyror.

Dëmtimi mund të ndodhë vetëm në dy rrethana konkrete. E para është heqja e vegjetacionit periferik në skajet e parcelës gjatë punimeve të zgjerimit, e cila mund të shmanget me kufizimin e zonës së punës në gjurmën e aprovuar. E dyta është ndotja aksidentale që kalon jashtë parcelës dhe prek tokën ose ujin në parcelat fqinje.

Nuk është kryer vrojtim biologjik sezonal; përfundimi bazohet në karakterin e urbanizuar të lokacionit, në fotografitë e terrenit dhe në hartat e disponueshme. Bazuar në shpërndarjen e njohur dhe në karakteristikat e habitatit, disa lloje të zakonshme mund të jenë potencialisht të pranishme në skajet e gjelbëruara, por prania e tyre nuk konsiderohet e konfirmuar pa vrojtim të drejtpërdrejtë në terren. Vrojtimi bëhet i domosdoshëm vetëm nëse parashihet heqje e vegjetacionit ose zgjerim i gjurmës.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike biodiversiteti, florës dhe fauna, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre

Nuk identifikohet humbje e veçorive gjeologjike, paleontologjike ose gjeomorfologjike, sepse projekti nuk parashikon gërmim të thellë, nxjerrje materiali ose ndërhyrje në formacione shkëmbore. Punimet kufizohen në themele dhe në sipërfaqe brenda depozitimeve të reja.

Zonat natyrore të mbrojtura të njohura në Komunën e Lipjanit nuk ndodhen në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit dhe nuk janë brenda zonës së ndikimit të vlerësuar për zhurmën, pluhurin ose ujërat atmosferike. Prandaj nuk identifikohet rrugë ndikimi mbi pasuritë natyrore të mbrojtura.

Për speciet e rralla dhe të rrezikuara nuk është identifikuar rrugë ndikimi, përveç skenarit të ndotjes aksidentale, e cila do të mbetej kryesisht lokale dhe do të kufizohej nga masat e mbajtjes dhe të reagimit. Ky përfundim mbetet i vlefshëm për aq kohë sa veprimtaria qëndron brenda gjurmës aktuale dhe brenda kapacitetit të vlerësuar.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Qëllimi i sipërfaqeve të reja është i ndarë qartë: 550 m² për zgjerimin funksional të autoservisit dhe 730 m² për garazh e depo të pajisjeve e të pjesëve rezervë. Të dy komponentët, me 1.280 m² gjithsej, vlerësohen si pjesë e të njëjtit kompleks, sepse ndajnë të njëjtin sistem qarkullimi, drenazhimi, sigurie dhe menaxhimi mjedisor.

Sipërfaqja e përgjithshme prej 5.094 m² përdoret për servis, pranim, magazinim, qarkullim dhe funksione ndihmëse. Ndarja konceptuale e tërë sipërfaqes në zona funksionale është propozuar në Kapitullin 5 dhe paraqitur në skicën konceptuale të pikës 3.12.

Ndikimi kryesor mbi shfrytëzimin e sipërfaqeve është intensifikimi i një përdorimi komercial ekzistues dhe jo ndryshimi i destinimit. Megjithatë, mbulimi i rreth një të katërtës së sipërfaqes me ndërtime të reja zvogëlon hapësirën e lirë dhe rrit sipërfaqen e papërshkueshme; kjo duhet të kompensohet me projekt drenazhimi, përndryshe rrjedhja atmosferike rritet.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Bilanci i deklaruar i ndërtimeve të reja përfshin 550 m² zgjerim të autoservisit dhe 730 m² garazh e depo, pra 1.280 m² gjithsej. Sipërfaqja e mbetur e lirë, e llogaritur si diferencë nga sipërfaqja e matur, është rreth 3.814 m² dhe përdoret për qarkullim, radhitje, manipulim dhe zona funksionale të hapura.

Sipërfaqet përfundimtare të ndërtuara dhe të pandërtuara, koeficientët urbanistikë dhe gjurma e saktë verifikohen në projektin zbatues dhe në dokumentet e aprovuara nga autoritetet kompetente. Skica konceptuale nuk përbën matje të sipërfaqes së ndërtuar dhe nuk mund të përdoret për llogaritje urbanistike.

Ndikimi mjedisor i ndryshimit të bilancit varet nga pjesa e sipërfaqes që do të mbulohet ose shtrohet. Rritja e sipërfaqes së papërshkueshme rrit vëllimin dhe shpejtësinë e rrjedhjes atmosferike; nëse ky vëllim nuk kanalizohet dhe nuk trajtohet sipas rrezikut, ndikimi mbi tokën dhe ujërat rritet edhe pse sipërfaqja e ekspozuar zvogëlohet. Prandaj projekti i drenazhimit duhet të hartohet së bashku me projektin e ndërtimit dhe jo pas tij.

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2021–2029 e paraqet lokacionin në zonë komerciale. Veprimtaria e servisimit dhe e tregtimit të pjesëve është përgjithësisht e përputhshme me këtë kategori përdorimi, ndërsa

pajtueshmëria konkrete për objektet, për magazinimin dhe për kushtet e veçanta përcaktohet nga autoriteti komunal.

Nuk parashikohet fragmentim i ri i tokës jashtë parcelave dhe as ndryshim i destinimit të sipërfaqeve fqinje si pasojë e projektit. Ndikimi mbetet brenda kufirit të dokumentuar dhe nuk shtrihet në parcelat bujqësore ose të pazhvilluara përreth.

Ndikimi i mbetur vlerësohet pas masave teknike e organizative dhe lidhet me një tregues të verifikueshëm monitorimi: mungesa e magazinimit ose e parkimit operativ jashtë kufirit të projektit. Çdo devijim nga ky tregues dokumentohet dhe mbyllet vetëm pas verifikimit të masës korrigjuese.

6.30. Infrastruktura komunale

Projekti përdor infrastrukturën ekzistuese: rrugën publike, ujësjellësin, kanalizimin e vendbanimit, rrjetin elektrik dhe shërbimin komunal të mbeturinave. Ndikimi mbi kapacitetet komunale vlerësohet i vogël për shkak të shkallës së aktivitetit, por nuk është zero dhe ndryshon sipas komponentit.

Ndikimi lidhet me katër elemente: kapacitetin e infrastrukturës ekzistuese për të përballuar lëvizjet shtesë; sigurinë e hyrje-daljeve; konsumin e burimeve publike; dhe aftësinë për të ndarë e dorëzuar rrymat e mbeturinave te operatorë të autorizuar. Elementi i fundit është ai ku gjendja aktuale paraqet mangësinë më të madhe dokumentare.

Shtrirja e ndikimit është lokale dhe zakonisht e kthyeshme. Megjithatë, bllokimi i rrugës gjatë manovrimit, shkarkimi i gabuar në kanalizim ose tejmbushja e zonës së ruajtjes së mbeturinave përbëjnë devijime të menjëhershme që kërkojnë ndërhyrje pa vonesë dhe që dokumentohen si mospërputhje.

6.31. Trafiku

Trafiku i gjeneruar nga projekti përbëhet nga lëvizjet e klientëve për rreth 30 automjete të riparuara në muaj, nga dërgesat e rreth 15 njësive të importuara në muaj, nga lëvizjet e punëtorëve dhe nga largimi periodik i mbeturinave. Importi mund të mbërrijë në dërgesa të grupuara; prandaj numri i njësive nuk barazohet me numrin e kamionëve.

Ndikimet e identifikuara janë manovrimi i mjeteve të rënda në hyrje, zhurma dhe emetimet gjatë pritjes, rreziku për këmbësorët dhe mundësia e bllokimit të përkohshëm të hyrjes ose të karrexhatës. Shtrirja është përgjatë hyrjes dhe segmentit të afërt të rrugës Bajram Gashi, gjatë orarit të punës.

Nuk ekziston numërim i trafikut, vlerësim i kapacitetit të kyçjes ose analizë e sigurisë së manovrimit. Numërimi shtatëditor i hyrje-daljeve sipas llojit të mjetit dhe orës, i parashikuar në pikën 8.4, është mjeti që e mbyll këtë boshllëk dhe që përcakton nëse masat organizative mjaftojnë apo kërkohet ndërhyrje në gjeometrinë e hyrjes.

6.32. Furnizimi me ujë

Uji merret nga kompania rajonale për nevoja sanitare dhe për pastrim të kufizuar. Në lokacion nuk zhvillohet proces me konsum të lartë uji dhe nuk përdoret ujë si lëndë e parë; prandaj ndikimi mbi kapacitetin e rrjetit vlerësohet i papërfillshëm.

Sasia e konsumuar nuk është e dokumentuar, sepse nuk është paraqitur lexim i matësit dhe as faturë e ujësjellësit. Kjo mungesë nuk ndryshon vlerësimin e nivelit të ndikimit, por e bën atë të pambështetur me të dhëna; për këtë arsye evidenca mujore e konsumit në m³ është element i detyrueshëm i programit të monitorimit.

Çdo përdorim i ardhshëm i ujit për larjen e pjesëve ose për procese të tjera do të ndryshonte njëkohësisht bilancin e konsumit dhe karakterin e ujërave të ndotura. Një ndryshim i tillë kërkon vlerësim paraprak, sepse ujërat nga larja e pjesëve përmbajnë vajra dhe grimca dhe nuk mund të shkarkohen si ujëra sanitare.

6.33. Energjia

Energjia elektrike furnizohet nga rrjeti publik dhe dëshmohet me faturë në emër të biznesit. Konsumi lidhet me ndriçimin, me veglat, me kompresorin, me pajisjet diagnostikuese, me kabinën e lyerjes dhe me administratën. Në lokacion nuk ka prodhim të energjisë dhe nuk është deklaruar gjenerator rezervë.

Ndikimi mbi rrjetin vlerësohet i vogël, ndërsa ndikimi klimatik është indirekt dhe proporcional me konsumin. Kabina e lyerjes dhe kompresori janë konsumatorët kryesorë; prandaj mirëmbajtja e tyre ka efekt të dyfishtë – ul konsumin dhe njëkohësisht ul emetimet dhe zhurmën.

Evidenca mujore e kWh është treguesi që lidh konsumin me kapacitetin e deklaruar. Një rritje e pashpjeguar e konsumit kundrejt mesatares është tregues i hershëm i ndryshimit të kapacitetit ose i defektit të pajisjeve dhe aktivizon kontroll sipas pikës 8.4.

6.34. Ujërat e zeza

Sipas deklarimit të aplikuesit, ujërat e zeza të gjeneruara janë vetëm sanitare dhe shkarkohen në kanalizimin e vendbanimit; dëshmia e kyçjes duhet të bashkëngjitet në dosje. Ndikimi vlerësohet i ulët për aq kohë sa shkarkimi mbetet vetëm sanitar dhe kyçja është funksionale.

Përzierja e ujërave sanitare me vajra, karburante, antifriz, lëngje frenash ose me ujëra nga larja e pjesëve nuk lejohet dhe do të përbënte shkelje të kushteve të shkarkimit në rrjetin publik. Kjo ndalesë është konceptuale dhe operative njëkohësisht: ajo kërkon ndarje fizike të rrjetit sanitar nga çdo rrjedhje e mundshme teknike.

Nuk është dorëzuar dëshmi e kyçjes, plan i rrjetit të brendshëm ose analizë e shkarkimit. Nëse lidhja funksionale me kanalizimin publik nuk ekziston ose ndërpritet, ujërat sanitare menaxhohen vetëm me gropë septike të mbyllur dhe të papërshkueshme, sipas projektit teknik, pa shkarkim në tokë ose në drenazhimin atmosferik. Ujërat atmosferike trajtohen veçmas dhe janë objekt i masave teknike të Kapitullit 7.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Mbeturinat e gjeneruara përfshijnë vajra të përdorura, filtra vaji dhe kabine, bateri, antifriz, lëngje frenash, mbetje bojrash dhe llaqesh, absorbues të kontaminuar, goma, metale, plastikë, qelq, ambalazh dhe mbeturina komunale. Shumëllojshmëria e rrymave është karakteristika kryesore e këtij komponenti dhe burimi kryesor i rrezikut administrativ.

Shërbimi komunal mbulon vetëm rrymën komunale të përzier. Të gjitha rrymat e tjera kërkojnë operatorë të licencuar për rrymën përkatëse dhe dokumentim të veçantë të çdo dorëzimi. Aktualisht nuk ekziston dëshmi dokumentare për asnjë prej tyre.

Ndikimi lidhet me rrjedhjet nga enët e papërshtatshme, me rrezikun nga zjarri në rastin e materialeve të ndezshme, me përzierjen e rrymave që e bën trajtimin e mëvonshëm të pamundur, me magazinimin e zgjatur që rrit sasinë e ruajtur dhe me humbjen e gjurmueshmërisë. Pjesët e përdorshme mbeten produkt vetëm kur janë të identifikueshme dhe realisht të destinuara për ripërdorim; pjesët e papërdorshme klasifikohen si mbeturina që nga momenti i konstatimit.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Brenda kufirit të projektit nuk është identifikuar asnjë pasuri e mbrojtur natyrore ose kulturore. Harta e distancave paraqet një xhami në rreth 963 m dhe një kishë në rreth 1.369 m si objekte orientuese, pa provuar statusin e tyre juridik si asete nën mbrojtje.

Zonat natyrore të mbrojtura të Komunës së Lipjanit nuk ndodhen në afërsi të drejtpërdrejtë dhe nuk përfshihen në zonën e ndikimit të vlerësuar. Prandaj nuk identifikohet ndikim fizik ose strukturor mbi pasuritë e mbrojtura.

Ndikimi mbi peizazhin është lokal dhe lidhet me dukshmërinë e stokut nga rruga. Pamja e çrregullt mund të ndikojë perceptimin e korridorit periurban dhe rrjedhimisht pranueshmërinë sociale të veprimtarisë, edhe kur nuk përbën shkelje të asnjë norme. Masat e renditjes, të kufizimit të lartësisë dhe të ekranimit e adresojnë drejtpërdrejt këtë ndikim.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë nga

Përveç ndikimeve sipas komponentëve mjedisorë, neni 10 paragrafi 3 i UA-së nr. 04/2025 kërkon trajtimin e shtatë çështjeve të veçanta: zbatimin e projektit përfshirë punimet e largimit; ndikimet kumulative me projektet e tjera ekzistuese; shtrirjen hapësinore të ndikimit negativ; shkarkimin e ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit; emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit; emetimet e gazrave serrë gjatë operimit; dhe ndikimet në ndryshimet klimatike.

Këto çështje trajtohen në pikat 6.38–6.44 që vijojnë. Ato nuk përsërisin analizën e mëparshme, por e plotësojnë atë me dimensionin kohor të fazave dhe me dimensionin hapësinor e kumulativ të ndikimeve.

Për të gjitha këto çështje zbatohet i njëjti parim metodologjik: aty ku ekzistojnë të dhëna, jepet vlerësimi me bazën e tij; aty ku nuk ekzistojnë, identifikohet boshllëku dhe përcaktohet mënyra e mbylljes së tij, pa u zëvendësuar me vlerë të supozuar.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Burimi: Program i pikave të monitorimit i hartuar për konfigurimin aktual të lokacionit; pikat përfundimtare shënohen në planin e aprovuar të lokacionit.

Matjet e zhurmës kryhen gjatë aktivitetit përfaqësues dhe regjistrojnë burimet aktive, trafikun dhe kushtet e motit. Mostrat e tokës dhe të ujit merren nga person kompetent, ruhen dhe transportohen sipas metodës së

përcaktuar. Të gjitha pajisjet matëse duhet të kenë certifikatë të vlefshme kalibrimi, e cila i bashkëngjitet raportit.

8.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Çdo raport matjeje duhet të përmbajë identifikimin e operatorit dhe të lokacionit; qëllimin e matjes; datën dhe orën; pikën me kod dhe koordinata; hartën e pikave; metodën e përdorur; pajisjen dhe certifikatën e kalibrimit; laboratorin ose personin kompetent; kushtet meteorologjike; aktivitetet që zhvilloheshin gjatë matjes; rezultatet me pasigurinë sipas rastit; vlerat kufitare të krahasimit; fotografitë; interpretimin; devijimet e konstatuara; dhe rekomandimin për veprim.

Përgjegjësi mjedisor përgatit një raport mujor të brendshëm dhe një raport vjetor përmbledhës. Raportet laboratorike i bashkëngjiten pa ndryshim dhe pa përzgjedhje të pjesshme të rezultateve. Një tejkalim, një incident ose një ankesë e rëndë nuk pret raportin vjetor: njoftohen menjëherë menaxhmenti dhe, sipas detyrimit, autoriteti kompetent.

Dokumentet ruhen në formë elektronike dhe fizike sipas afatit ligjor, me kopje rezervë dhe me kontroll versioni. Të dhënat personale dhe sekretet tregtare mbrohen sipas legjislacionit, por kjo mbrojtje nuk mund të përdoret për të fshehur të dhëna mbi emetimet e substancave të rrezikshme, mbi rreziqet nga aksidentet ose mbi rezultatet e monitorimit, të cilat sipas nenit 6 paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-181 nuk mbulohen nga konfidencialiteti.

Tabela 43. Raportet, përmbajtja minimale, afati dhe marrësi

Raporti ose regjistri	Përmbajtja minimale	Afati ose dinamika	Marrësi
Listat javore të kontrollit	Rrjedhjet, pusetat, enët, korridoret, zjarri dhe fotografitë	Javore; ruhen menjëherë pas plotësimit	Përgjegjësi dhe drejtori
Bilanci operativ mujor	Riparimet, importet, uji, energjia, mbeturinat dhe dorëzimet	Deri në fund të muajit pasues	Menaxhmenti
Raporti laboratorik	Metoda, pikat, kontrolli i cilësisë, rezultatet, kufijtë dhe interpretimi	Pas çdo fushate, sipas afatit kontraktual	Operatori; autoriteti sipas kushtit
Raporti i incidentit	Kronologjia, sasia, zona, njoftimi, mbeturinat dhe korrigjimi	Paraprak menjëherë; përfundimtar pas hetimit	Drejtori dhe autoritetet sipas rastit
Raporti vjetor mjedisor	Trendet, pajtueshmëria, ankesat, incidentet, matjet dhe plani i vitit pasues	Brenda afatit ligjor ose të kushtit të lejes	Autoriteti kompetent dhe arkiva

Burimi: Struktura e raportimit e hartuar sipas kërkesave të nenit 12 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Raporti vjetor mjedisor është dokumenti që lidh të gjitha nivelet e monitorimit dhe që përcakton programin e vitit pasues. Ai duhet të përmbajë edhe listën e veprimeve korrigjuese të hapura dhe të mbyllura, sepse pikërisht ajo listë dëshmon nëse sistemi funksionon apo vetëm regjistron.

8.6. Detyrimin për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Operatori informon publikun në mënyrën dhe brenda afatit të kërkuar nga legjislacioni, nga pëlqimi mjedisor ose nga autoriteti kompetent. Informacioni duhet të jetë i kuptueshëm për personat pa formim teknik dhe të përfshijë komponentin e matur, datën, vendin e përgjithshëm, rezultatin, vlerën kufitare, përfundimin dhe masat e ndërmarra kur ka tejkalim.

Procedurat e detajuara për planifikimin dhe organizimin e konsultimeve publike për raportin e VNM-së përcaktohen me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) nr. 11/2025. Konsultimi publik për raportin, sipas nenit

16 paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-181, nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë, ndërsa debati publik organizohet nga Ministria në bashkëpunim me aplikuesin dhe me Komunën.

Përmbledhja publike e rezultateve nuk zëvendëson raportin teknik. Ajo nuk publikon të dhëna personale, por tregon qartë nëse ka pasur tejkalim, cili është shkaku i mundshëm, çfarë veprimi është marrë dhe kur do të përsëritet matja. Për ankesat caktohet një pikë kontakti, mbahet regjistër dhe respektohet një afat përgjigjeje i deklaruar.

Tabela 44. Rastet, informacioni, kanali dhe koha e informimit të publikut

Rasti	Informacioni që jepet	Kanali	Koha
Rezultate rutinë pa tejkalim	Përmbledhje periodike dhe trendi i treguesve	Njoftim në lokacion ose kanal publik i operatorit; sipas procedurës së autoritetit	Sipas raportimit vjetor ose kushtit të lejes
Tejkalim i konfirmuar	Rezultati, vlera kufitare, zona, rreziku dhe masa e ndërmarrë	Autoriteti kompetent; njoftim publik sipas udhëzimit	Pa vonesë, brenda afatit ligjor
Incident me rrezik të drejtpërdrejtë	Natyra, zona, sjellja e kërkuar dhe kontakti	112 dhe autoritetet; njoftim i drejtpërdrejtë i personave të prekur	Menjëherë
Ankesë individuale	Verifikimi i kryer, matja nëse është bërë dhe përgjigjja	Kontakt i drejtpërdrejtë dhe regjistri i ankesave	Brenda afatit të procedurës
Konsultim publik për raportin e VNM-së	Raporti i plotë dhe përmbledhja joteknike	Uebfaqja e Ministrisë dhe e Komunës; tabela e shpalljeve; debat publik	Jo më pak se 30 ditë sipas nenit 16 të Ligjit nr. 08/L-181

Burimi: Ligji nr. 08/L-181, neni 16; Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 11/2025 për procedurat e konsultimeve publike.

Rreshti i fundit ka rëndësi procedurale për vetë këtë raport: ai përcakton fazën në të cilën publiku ka të drejtë të shqyrtojë përmbajtjen dhe të paraqesë komente. Aplikuesi ofron një kopje fizike ose elektronike të raportit për Komunën e Lipjanit, e cila duhet të jetë në dispozicion të publikut.

8.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis, sipas rastit

Sipas vlerësimit të Kapitullit 6, projekti nuk vlerësohet se shkakton ndikim ndërkufitar në ajër, në ujë, në tokë ose në biodiversitet. Burimet janë të vogla, të shpërndara dhe me shtrirje lokale; nuk ka shkarkim në një trup ujor ndërkufitar, nuk ka oxhak industrial dhe nuk ka proces me emetime që transportohen në distanca të mëdha.

Prandaj nuk propozohet program i rregullt ndërkufitar monitorimi. Ky përfundim është i lidhur drejtpërdrejt me kufirin teknologjik të projektit dhe me kapacitetin e deklaruar; ai nuk është përfundim i përhershëm dhe rishikohet sa herë që ndryshojnë këto dy elemente.

Programi ndërkufitar do të aktivizohej vetëm në katër rrethana: nëse ndryshon thelbësisht projekti; nëse identifikohet një rrugë reale e ndikimit ndërkufitar; nëse ndodh një incident me pasoja të dokumentuara jashtë territorit; ose nëse kërkohet nga autoriteti kompetent apo nga një marrëveshje ndërkombëtare e zbatueshme. Në atë rast, parametrat, pikat, shkëmbimi i të dhënave, institucionet përgjegjëse dhe procedura e alarmimit do të përcaktoheshin në koordinim me autoritetet, sipas Kapitullit IV të Ligjit nr. 08/L-181.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT 8

Programi kombinon kontrollin e përditshëm operativ me matjet e verifikueshme dhe me raportimin e strukturuar. Prioritetet fillestare janë matja bazë e zhurmës te receptori më i afërt, dokumentimi i tokës dhe i drenazhimit, përcaktimi i pikave të ujit sipas rrezikut, bilanci sasior i mbeturinave, numërimi shtatëditor i trafikut dhe matja e distancave te receptorët. Frekuencat përfundimtare harmonizohen me kushtet e pëlqimit mjedisor dhe rishikohen pas fushatës së parë të matjeve.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Plani i Menaxhimit Mjedisor përcakton mënyrën se si AUTO SELIMI SH.P.K. do t'i zbatojë, kontrollojë dhe dokumentojë masat e Kapitullit 7 dhe programin e monitorimit të Kapitullit 8. Ai zbatohet për veprimtarinë ekzistuese në Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, në parcelat 1402-2 dhe 1402-9 me sipërfaqe të përgjithshme 5.094 m².

Plani mbulon operimin normal, pranimin e dërgesave, mirëmbajtjen dhe riparimin, ruajtjen dhe tregtimin e pjesëve, punët e karrocerisë dhe të lyerjes, situatat jonormale, emergjencat, ndryshimet e aktivitetit dhe mbylljen. Ai është përshtatur me kapacitetin aktual të deklaruar dhe me orarin 08:00–16:00, e hënë – e shtunë.

Çdo rritje e qëndrueshme e kapacitetit, çdo zgjerim jashtë parcelave, çdo ndryshim i teknologjisë ose fillimi i prerjes e i trajtimit të automjeteve në Kosovë i nënshtrohet vlerësimit të ndryshimit dhe njoftimit ose miratimit nga autoriteti kompetent para zbatimit. Kjo procedurë e menaxhimit të ndryshimit është element qendror i planit dhe jo formalitet administrativ.

Tabela 45. Rolet, detyrat dhe dëshmitë brenda Planit të Menaxhimit Mjedisor

Roli	Detyrat kryesore	Vendimi ose dëshmia
Drejtori menaxhues	Miraton planin, siguron burimet, miraton veprimet korrigjuese dhe komunikon me autoritetet	Vendim i brendshëm; procesverbal i rishikimit vjetor
Përgjegjësi mjedisor	Zbaton planin, mban regjistrat, verifikon kushtet e lejeve, koordinon matjet dhe raportet	Përshkrim detyre; listat e kontrollit; raportet mujore dhe vjetore
Përgjegjësi i servisit	Kontrollon rrjedhjet, dyshemenë, tavat mbajtëse, pajisjet, ajrosjen dhe pastrimin	Regjistri i servisit dhe i mirëmbajtjes
Magazinieri	Kontrollon dokumentet e dërgesës, karantinën, etiketat, raftet, sasitë dhe daljet	Regjistri i hyrje-daljeve dhe inventari
Koordinatori i emergjencës	Kontrollon pajisjet kundër zjarrit dhe derdhjeve, korridoret, ushtrimet dhe njoftimin	Lista mujore; raporti i ushtrimit dhe i incidentit
Punëtorët	Zbatojnë procedurat, përdorin pajisjet mbrojtëse, ndajnë mbeturinat dhe raportojnë devijimet	Evidenca e trajnimit dhe raporti i devijimit

Burimi: Struktura organizative e propozuar për zbatimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor.

Çdo punëtor ka detyrimin dhe të drejtën ta ndalë dhe ta raportojë punën kur konstaton rrjedhje, zjarr, enë të dëmtuar, ngarkesë të paqëndrueshme ose rrezik të menjëhershëm. Ky autorizim duhet të deklarohet shprehimisht në udhëzimet e punës, përndryshe ai nuk ushtrohet në praktikë.

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Plani mbulon objektin ekzistues dhe 1.280 m² sipërfaqe të re të planifikuar, të ndarë në 550 m² zgjerim autoservisi dhe 730 m² garazh e depo. Përgjegjësitë, kontrollet dhe evidencat zbatohen në secilën zonë funksionale dhe në rrugën e përbashkët të qarkullimit.

Meqë veprimtaria është ekzistuese, faza para operimit trajtohet si fazë e riorganizimit dhe e harmonizimit me masat e VNM-së. Çdo punë ndërtimore e ardhshme trajtohet vetëm sipas projektit dhe lejeve përkatëse. Mbrojtja efektive mbështetet në hierarkinë: shmangie; zvogëlim në burim; mbajtje brenda lokacionit; ripërdorim ose riciklim; dorëzim te operatori i autorizuar; reagim ndaj incidentit; dhe rehabilitim.

Tabela e mëposhtme përcakton për secilën fazë ose proces kontrollin e detyrueshëm, treguesin e pranimit dhe evidencën. Ajo është dokumenti operativ i planit dhe përdoret drejtpërdrejt si listë kontrolli nga përgjegjësi mjedisor.

Tabela 46. Kontrollet e detyrueshme sipas fazave dhe proceseve

Faza ose procesi	Kontrolli i detyrueshëm	Treguesi i pranimit	Evidenca
Riorganizimi fillestar	Shënohen zonat funksionale; lirohet korridori i qarkullimit dhe i emergjencës; caktohen përgjegjësit	Korridori dhe daljet plotësisht të lira; zonat e shënuara	Planimetria, fotografitë dhe vendimet e emërimit
Pranimi i dërgesave	Kontrollohen origjina, lista e pjesëve, dokumentet doganore, rrjedhjet, pastërtia dhe përdorshmëria	Të gjitha dërgesat e kontrolluara; asnjë pjesë me rrjedhje në zonën e pastër	Formulari i pranimit dhe dosja e dërgesës
Karantina	Pjesët e dyshimta, të dëmtuara ose me status të paqartë izolohen nën mbulim me mbajtje sekondare	Asnjë pjesë e paqartë nuk tregtohet para vendimit	Etiketa, fotografia dhe vendimi produkt–mbeturinë
Servisi mekanik	Përdoren tava mbajtëse; lëngjet mblidhen veç; sipërfaqet kontrollohen; motorët nuk mbahen ndezur pa nevojë	Zero shkarkime teknike në tokë ose kanalizim; pa rrjedhje të patrajtuara	Lista ditore dhe javore; regjistri i lëngjeve
Karroceria dhe bluarja	Aspirim lokal, ndarje e zonës, pastrim me vakum dhe ekranim i shkëndijave	Pa pluhur të dukshëm jashtë zonës; pa ndezje të materialeve	Lista e kontrollit dhe evidenca e mirëmbajtjes
Lyerja dhe tharja	Ventilim dhe filtra funksionalë; enë të mbyllura; ndalim i burimeve të ndezjes	Pa mjegull boje jashtë kabinës; filtra brenda afatit	Regjistri i ndërrimit të filtrave dhe i konsumit
Magazinimi i pjesëve	Pjesët ruhen mbi bazamente ose rafte stabile, nën mbulim dhe larg korridorit	Pa kontakt me tokën dhe me reshjet; pa rrëzim ose bllokim	Inventari dhe kontrolli i rafteve
Menaxhimi i mbeturinave	Klasifikim, ndarje, enë kompatibile, etiketa, mbulim dhe dorëzim te operatori i autorizuar	Të gjitha enët të etiketuara; pa përzierje; dokument për çdo dorëzim	Regjistri, peshimi dhe fletëpërcjellësja
Ujërat dhe drenazhimi	Kur ekziston lidhja funksionale: vetëm ujëra sanitare në kanalizim; në mungesë të saj zbatohet gropë septike e mbyllur. Pusetat dhe ujërat atmosferike kontrollohen veçmas	Pa film vaji, pa bllokim, pa shkarkim teknik në kanalizimin sanitar dhe pa shkarkim të paautorizuar në tokë ose drenazh	Kontrolli pas reshjeve, faturat dhe raportet e pastrimit
Ajri, zhurma dhe trafiku	Punët kryhen brenda orarit; kufizohen ndezjet, pluhuri dhe pritja në rrugë; pajisjet mirëmbahen	Pa tejkalime ose ankesa të pakorrigjuara; pa bllokim të rrugës publike	Matjet, regjistri i ankesave dhe evidenca e hyrje-daljeve
Emergjencat	Izolohet burimi; mbrohen pusetat; përdoren absorbuesit dhe aparatet; njoftohet dhe dokumentohet	Reagim i menjëhershëm; ndotja nuk del jashtë zonës së kontrolluar	Raporti i incidentit dhe veprimi korrigjues
Mbyllja	Largohen pjesët, lëngjet, mbeturinat dhe pajisjet; pastrohet lokacioni; kontrollohet toka	Asnjë mbeturinë ose burim ndotjeje i mbetur	Inventari përfundimtar, analizat dhe procesverbali

Burimi: Plan i menaxhimit mjedisor i hartuar sipas nenit 13 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Në pranimin e pjesëve të importuara zbatohet kontrolli produkt–mbeturinë si filtri i parë dhe më i rëndësishëm i të gjithë sistemit. Pjesët pranohen për tregtim vetëm kur janë të identifikueshme, të përdorshme, pa rrjedhje dhe realisht të destinuara për ripërdorim. Materialet e papërdorshme, të përziera ose të destinuara vetëm për rikuperim e asgjësim izolohen dhe trajtohen sipas kërkesave për mbeturina; ngarkesa refuzohet kur dokumentet, gjendja fizike dhe destinimi nuk përputhen.

Ritmi i kontrolleve është i shkallëzuar. Kontrollet ditore fokusohen te rrjedhjet, pastërtia, korridoret dhe pajisjet. Kontrollet javore përfshijnë pusetat, karantinën, mbeturinat, raftet dhe kufijtë e parcelës. Përmbledhja mujore përfshin kapacitetin, konsumin e ujit dhe të energjisë, sasitë e mbeturinave, ankesat, incidentet dhe statusin e veprimeve korrigjuese. Matjet instrumentale kryhen sipas Kapitullit 8 dhe sipas kushteve të autoritetit.

Tabela 47. Kalendari i zbatimit dhe kriteret e mbylljes së veprimeve

Afati	Veprimi prioritar	Kriteri i mbylljes
Menjëherë – 30 ditë	Caktimi i përgjegjësve; lirimi i korridorit të qarkullimit dhe të emergjencës; shënimi i zonave; ndarja dhe etiketimi i mbeturinave; kontrolli i dërgesave; kompletet për derdhje dhe aparatet kundër zjarrit	Vendime, fotografi, etiketa, lista kontrolli dhe pajisje funksionale
0–3 muaj; kontratat para dorëzimit të parë	Kontratat me operatorë të autorizuar për secilën rrymë para dorëzimit të parë; hapja e regjistrave; trajnimet; fushata bazë e monitorimit; inventari i pusetave; procedurat e pranimit dhe të emergjencës	Kontrata dhe licenca, regjistra aktivë, raporte matjeje dhe procesverbale trajnimi
3 – 6 muaj	Projektimi dhe zbatimi i sipërfaqeve të papërshkueshme, i zonës së mbuluar të mbeturinave, i drenazhimit dhe i separatorit kur kërkohet	Projekt dhe leje, punë të pranuara dhe provë funksionale
6 – 12 muaj	Realizimi i zgjerimeve sipas lejeve; përfundimi i ekranimit vizual dhe i renditjes së stokut	Leje përdorimi dhe verifikim i treguesve vizualë
Vazhdimisht	Inspektime, monitorim, mirëmbajtje, raportim, trajtim ankesash, auditim dhe përmirësim	Treguesit brenda kufijve dhe veprimet korrigjuese të mbyllura
Para çdo ndryshimi	Shqyrtim i kapacitetit, i teknologjisë, i sipërfaqes, i statusit të importit dhe i kërkesave për leje ose VNM	Vendim i dokumentuar para angazhimit ose zbatimit

Burimi: Kalendar i zbatimit i hartuar sipas prioriteteve të Kapitullit 7.

Kalendari është ndërtuar mbi parimin e efektit të hershëm: veprimet me kosto të ulët dhe me efekt të lartë mbrojtës realizohen brenda muajit të parë, ndërsa investimet teknike shtrihen në muajt vijues. Kjo renditje siguron që rreziku më i madh – rrjedhja e paizoluar dhe përzierja e mbeturinave – të adresohet menjëherë dhe jo pas përfundimit të punimeve.

9.2. Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor

Pajtueshmëria menaxhohet përmes një Regjistri të Detyrimeve Mjedisore dhe një Matrice të Kushteve të Pëlqimit Mjedisor. Çdo kusht i vendimit përkthehet në veprim konkret, me përgjegjës, afat, tregues, dokument dëshmues dhe status. Matrica përditësohet pas çdo vendimi, inspektimi, ndryshimi ligjor ose ndryshimi të aktivitetit.

Mungesa e një kushti në matricë nuk interpretohet si mungesë detyrimi. Kur konstatohet se një kusht nuk është regjistruar, ai shtohet menjëherë dhe verifikohet nëse është zbatuar në praktikë; kjo procedurë parandalon që gabimet administrative të shndërrohen në mospërputhje reale.

Sipas nenit 18 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/L-181, Ministria shfuqizon vendimin për pëlqim mjedisor nëse inspektorati përkatës vërteton se nuk janë realizuar masat e parapara në raportin e VNM-së dhe kushtet e përcaktuara në vendim. Kjo dispozitë e bën matricën e kushteve jo thjesht mjet organizimi, por instrument të mbrojtjes së vetë autorizimit të veprimtarisë.

Tabela 48. Kontrolli i pajtueshmërisë me pëlqimin mjedisor

Kontrolli	Mënyra e zbatimit	Dëshmia	Frekuenca ose shkasi
Identifikimi i kushteve	Regjistrohen numri, data, afati, kapaciteti, lokacioni dhe të gjitha kushtet e vendimit	Kopja e vendimit dhe matrica e kushteve	Pas lëshimit ose ndryshimit të vendimit
Përkthimi në detyra	Çdo kusht lidhet me pronarin e detyrës, afatin, treguesin dhe dokumentin e mbylljes	Plan veprimi i miratuar	Menjëherë pas pranimit të kushtit
Kontrolli dokumentar	Verifikohen lejet, kontratat, licencat e operatorëve, raportet, faturat dhe fletëpërcjellëset	Dosja mjedisore me kontroll versioni	Mujore dhe para skadimit të çdo dokumenti
Kontrolli në terren	Inspektohen zonat, korridori, enët, etiketat, pusetat, pajisjet, stoku dhe kufijtë	Listë kontrolli me datë dhe fotografi	Javore; pas reshjeve ose incidentit
Raportimi	Dorëzohen matjet dhe raportet në formatin dhe afatin e përcaktuar	Dëshmia e dorëzimit dhe korrespondenca	Sipas kushtit; pa vonesë për incident
Menaxhimi i ndryshimit	Para ndryshimit shqyrtohen VNM-ja, pëlqimi, lejet, statusi produkt–mbeturinë dhe kapaciteti	Formulari i ndryshimit dhe përgjigjja e autoritetit	Para prokurimit, ndërtimit ose operimit të ri
Trajtimi i mospajtueshmërisë	Ndalet ose izolohet veprimi; vlerësohet ndikimi; njoftohet; korrigjohet shkaku dhe verifikohet efektiviteti	Raporti i mospajtueshmërisë dhe i mbylljes	Menjëherë; verifikim sipas afatit
Auditimi	Krahasohet aktiviteti real me vendimin, me planin, me regjistrat dhe me gjendjen në terren	Raporti i auditimit dhe procesverbali i menaxhmentit	Së paku vjetor dhe para rinovimit

Burimi: Procedurë e pajtueshmërisë e hartuar sipas nenit 18 të Ligjit nr. 08/L-181 dhe nenit 13 të UA-së (MMPHI) nr. 04/2025.

Përgjegjësi mjedisor mban kalendarin e afateve me paralajmërim para skadimit të çdo dokumenti. Versionet e vjetra arkivohen dhe dokumentet aktuale mbahen të qasshme në lokacion. Kontrata për mbeturinat komunale me KRM “Pastrimi” Sh.A. nuk zëvendëson kontratat për vajra, filtra, bateri, goma, absorbues ose mbeturina të tjera të servisit; për secilën rrymë verifikohet autorizimi i operatorit para dorëzimit.

Në rast tejkalimi, ankese të verifikuar, rrjedhjeje ose kushti të paplotësuar, operatori hap veprimin korrigjues me përshkrimin e problemit, masën e menjëhershme, analizën e shkakut, masën parandaluese, përgjegjësin, afatin, verifikimin e efektivitetit dhe mbylljen nga personi i autorizuar. Kur ndikimi mund të vazhdojë, procesi përkatës pezullohet deri në kontrollimin e rrezikut.

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Familja e standardeve ISO 14000 mbulon menaxhimin mjedisor. Standardi certifikues për sistemet e menaxhimit mjedisor është ISO 14001, botimi aktual i të cilit është ISO 14001:2026, i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim më 15.04.2026 me titullin “Environmental management systems — Requirements with guidance for use”. Zbatimi dhe certifikimi janë vullnetare, përveç kur kërkohen nga një kontratë ose nga një vendim i veçantë.

Ky plan nuk deklaron se AUTO SELIMI SH.P.K. është e certifikuar sipas ndonjë standardi. Ai përcakton një rrugë të shkallëzuar drejt një sistemi të dokumentuar, proporcional me madhësinë dhe me rreziqet e veprimtarisë, i cili mund të zhvillohet edhe pa certifikim formal dhe që përmirëson gjurmueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e masave.

Sistemi zhvillohet sipas ciklit Planifiko–Zbato–Kontrollo–Përmirëso. Planifikimi përfshin kontekstin, palët e interesuara, aspektet dhe ndikimet, detyrimet, rreziqet dhe objektivat. Zbatimi përfshin burimet, kompetencën, komunikimin, dokumentet, kontrollin operativ dhe gatishmërinë emergjente. Kontrolli përfshin treguesit, matjet, vlerësimin e pajtueshmërisë dhe auditimin. Përmirësimi përfshin korrigjimin, analizën e shkakut dhe rishikimin e menaxhmentit.

Tabela 49. Elementet e sistemit të menaxhimit mjedisor dhe zbatimi i propozuar

Elementi i sistemit	Zbatimi i propozuar	Dokumenti kryesor
Politika mjedisore	Angazhim për pajtueshmëri, parandalim të ndotjes, përdorim efikas të burimeve dhe përmirësim të vazhdueshëm	Politikë e nënshkruar dhe e komunikuar
Konteksti dhe palët e interesuara	Identifikohen autoritetet, punëtorët, klientët, fqinjët, furnizuesit, transportuesit dhe operatorët e mbeturinave	Regjistri i palëve dhe i nevojave
Aspektet dhe ndikimet	Vlerësohen rrjedhjet, mbeturinat, uji, toka, ajri, zhurma, trafiku, energjia, emergjencat dhe mbyllja	Regjistri i aspekteve me kriteret e rëndësisë
Detyrimet e pajtueshmërisë	Mirëmbahet regjistri i ligjeve, i lejeve, i kushteve, i kontratave dhe i raporteve	Regjistri i detyrimeve mjedisore
Objektivat dhe programet	Vendosen objektiva të matshëm me pronar, afat, burime dhe tregues	Programi vjetor i objektivave
Kompetenca dhe ndërgjegjësimi	Trajnim për pranimin, statusin produkt–mbeturinë, lëngjet, pajisjet mbrojtëse, zjarrin dhe raportimin	Matrica e kompetencës dhe evidenca e trajnimit
Kontrolli operativ	Procedura për pranimin, karantinën, servisin, magazinimin, mbeturinat, drenazhimin, furnitorët dhe kontraktorët	Procedurat dhe udhëzimet e punës
Gatishmëria emergjente	Skenarë, role, pajisje, kontakte, ushtrime dhe rishikim pas incidentit	Plani dhe raporti i ushtrimit ose i incidentit
Monitorimi dhe matja	Zbatohen pikat, parametrat, frekuencat dhe raportimi i Kapitullit 8	Programi dhe raportet e monitorimit
Auditimi dhe rishikimi	Auditi i brendshëm verifikon sistemin; menaxhmenti rishikon rezultatet, burimet dhe objektivat	Programi i auditimit dhe procesverbali i rishikimit
Përmirësimi i vazhdueshëm	Mospajtueshmëritë regjistrohen, analizohet shkaku, caktohen masat dhe verifikohet efektiviteti	Regjistri i veprimeve korrigjuese

Burimi: Struktura e sistemit sipas familjes ISO 14000 dhe botimit aktual ISO 14001:2026.

Objektivat minimale të rekomanduara për vitin e parë janë: kontroll dokumentar i plotë i të gjitha dërgesave; etiketim dhe ndarje e plotë e mbeturinave; dorëzim i të gjitha rrymave te operatorë të autorizuar; zero shkarkime të lëngjeve teknike në tokë ose në kanalizim; zero rrjedhje që dalin jashtë mbajtjes sekondare; korridori i qarkullimit dhe daljet gjithmonë të lira; trajnim i plotë i personelit relevant; kontroll mujor i ujit, i energjisë dhe i kapacitetit; një ushtrim emergjent në vit; dhe mbyllje e çdo mospajtueshmërie brenda afatit të miratuar. Këto objektiva rishikohen pasi të mblidhen të dhënat bazë dhe nuk përdoren për të zëvendësuar kufijtë ligjorë. Rishikimi i menaxhmentit kryhet së paku një herë në vit dhe pas çdo incidenti të rëndësishëm ose ndryshimi të madh, duke shqyrtuar statusin e veprimeve, ndryshimet në detyrime, rezultatet e monitorimit, arritjen e objektivave, ankesat, incidentet, performancën e operatorëve dhe mjaftueshmërinë e burimeve.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT 9

Plani i Menaxhimit Mjedisor e lidh secilën masë me përgjegjësin, afatin, treguesin dhe dëshminë. Prioritetet e menjëhershme janë emërimi i përgjegjësve, ndarja funksionale e lokacionit, lirimi i korridorit të qarkullimit dhe të emergjencës, kontrolli i dërgesave, karantina, menaxhimi i dokumentuar i mbeturinave dhe gatishmëria emergjente. Pajtueshmëria verifikohet me matricën e kushteve, me monitorimin, me auditimin e brendshëm dhe me rishikimin e menaxhmentit; sistemi përmirësohet gradualisht sipas familjes ISO 14000 dhe botimit aktual ISO 14001:2026, pa e paraqitur certifikimin si detyrim ligjor.

10. INFORMACIONE SHTESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

Ky kapitull paraqet sqarimet shtesë që ndihmojnë në përcaktimin e qëllimit, të kufijve dhe të përmbajtjes së raportit të VNM-së për veprimtarinë ekzistuese të AUTO SELIMI SH.P.K.. Informacioni plotëson kapitujt paraprakë pa ndryshuar titullin e projektit, kapacitetin e deklaruar ose kushtet që i takon t'i përcaktojë autoriteti kompetent.

Neni 15 i UA-së nr. 04/2025 parashikon gjithashtu që Komisioni i VNM-së, duke marrë për bazë informatat e ofruara nga aplikuesi, mund të konsultojë institucionet që mund të ndikohen nga projekti dhe të kërkojë mendimin e tyre. Mendimi i dhënë nga këto institucione bëhet pjesë përbërëse e raportit të VNM-së dhe integrohet në këtë kapitull kur të jetë i disponueshëm.

Deri në datën e këtij raporti nuk është pranuar asnjë mendim institucional i kërkuar nga Komisioni i VNM-së. Institucionet që mund të jenë relevante për këtë projekt janë Komuna e Lipjanit për pajtueshmërinë hapësinore, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor për të dhënat dhe kontrollin e vlefshmërisë, si dhe autoriteti kompetent për mbrojtjen nga zjarri.

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shtesë të projektit specifik apo një lloji të caktuar projektesh përmbajnë të dhëna të tjera për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM-së, nëse kërkohen

Karakteristika përcaktuese e këtij projekti është kombinimi i dy veprimtarive të lidhura por me profile të ndryshme rreziku: servisimi i automjeteve, i cili gjeneron emetime dhe mbeturina të rrezikshme në sasi të vogla por të vazhdueshme; dhe importimi e tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë segmente të mëdha strukturore, i cili gjeneron rrezik të lidhur me statusin juridik të materialit dhe me magazinimin.

Qëllimi i këtij raporti kufizohet në veprimtarinë ekzistuese dhe në kapacitetin e deklaruar. Kufizimi nuk është formal: ai përcakton se cilat ndikime janë vlerësuar dhe cilat jo, dhe rrjedhimisht se çfarë mbulon dhe çfarë nuk mbulon një eventual pëlqim mjedisor i dhënë mbi bazën e tij.

Të dhënat shtesë të aplikuesit përcaktojnë 550 m² zgjerim të objektit të autoservisit dhe 730 m² garazh e depo, ose 1.280 m² sipërfaqe të re të planifikuar. Këto vlera përdoren për qëllimin e këtij vlerësimi, ndërsa gjurma, lartësia, distancat nga kufiri dhe parametrat urbanistikë mbeten objekt i projektit zbatues dhe i miratimeve përkatëse.

Tabela 50. Karakteristikat e projektit dhe kufiri i vlerësimit

Elementi	Karakteristika e projektit	Kufiri i vlerësimit
Statusi	Veprimtari ekzistuese e regjistruar për mirëmbajtje e riparim automjetesh dhe për tregti me pakicë të pjesëve	Vlerësohet gjendja aktuale dhe harmonizimi me masat e reja
Lokacioni	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan; parcelat 1402-2 dhe 1402-9; 5.094 m²	Vetëm brenda kufirit të dokumentuar të parcelave
Kapaciteti	Rreth 30 automjete të riparuara në muaj dhe rreth 15 vetura ose furgona të prerë të importuar në muaj	Rritja e qëndrueshme trajtohet si ndryshim i projektit
Orari	08:00–16:00, e hënë – e shtunë	Punët me zhurmë dhe ngarkim-shkarkimi kufizohen brenda këtij orari
Prerja e automjeteve	Seksionet e prera përgatiten jashtë Republikës së Kosovës	Prerja e automjeteve të plota në lokacion nuk përfshihet në këtë vlerësim

Elementi	Karakteristika e projektit	Kufiri i vlerësimit
Produktet	Pjesë të përdorura dhe pjesë strukturore të përshtatshme për ripërdorim; shërbimi i riparimit	Pranohen si produkte vetëm pas kontrollit të pranimit
Proceset me emetime	Karroceri, bluarje, saldim, lyerje dhe tharje në kabinë ose furrë	Vlerësohen si burim i palëvizshëm dhe si burim pluhuri e tymi
Mbeturinat	Rryma nga servisi, nga lyerja, nga pjesët e papërdorshme, nga ambalazhi dhe nga administrata	Ndarje, magazinim i përkohshëm dhe dorëzim sipas statusit
Infrastruktura	Qasje nga rruga Bajram Gashi; furnizim me energji, ujë sanitar dhe kanalizim ekzistues	Pa zgjerim jashtë parcelave dhe pa rrugë të re pa procedurë të veçantë
Trajtimi i mbeturinave në lokacion	Nuk kryhet asnjë operacion trajtimi, rikuperimi termik ose asgjësimi	Çdo operacion i tillë do të kërkonte vlerësim dhe leje të re

Burimi: Deklarimet teknike të aplikuesit dhe vlerësimi i hartueses mbi kufijtë e projektit.

Kolona e tretë përcakton kufirin e vlefshmërisë së këtij vlerësimi. Çdo veprimtari që del jashtë këtyre kufijve nuk mbulohet automatikisht nga përfundimet e raportit dhe kërkon shqyrtim të veçantë para zbatimit.

Rrjedha operative fillon me planifikimin dhe dokumentimin e dërgesës në origjinë. Në hyrje kryhet kontrolli i dokumenteve dhe i gjendjes fizike. Pjesët e pranueshme kalojnë në zonën e ruajtjes ose të servisit; pjesët me rrjedhje, dëmtim, kontaminim ose status të paqartë kalojnë në karantinë. Pas kontrollit, ato klasifikohen për ripërdorim e tregtim, për riparim ose për menaxhim si mbeturinë. Dorëzimi te klienti shoqërohet me evidencë të daljes, ndërsa mbeturinat dorëzohen te operatori përkatës me dokument.

Tabela 51. Hapat e kontrollit të dërgesës dhe kriteret e refuzimit

Hapi	Kontrolli kryesor	Rezultati i lejuar	Rasti i refuzimit ose i karantinës
1. Para dërgesës	Origjina, fatura, lista e pjesëve, fotografitë dhe dokumentet doganore	Dërgesë e identifikueshme dhe e gjurmueshme	Dokumente të paplota ose përshkrim që nuk përputhet me ngarkesën
2. Pranimi fizik	Gjendja fizike, rrjedhjet, erërat, lëngjet e mbetura, pastërtia dhe stabiliteti	Shkarkim në zonën e kontrollit mbi sipërfaqe të papërshkueshme	Rrjedhje aktive, ndotje e dukshme ose ngarkesë e paqëndrueshme
3. Vendimi për statusin	Përdorshmëria, integriteti, destinimi dhe mundësia reale e ripërdorimit	Produkt i përdorur, pjesë për riparim ose mbeturinë e klasifikuar	Status i paqartë deri në verifikim nga personi kompetent ose nga autoriteti
4. Ruajtja	Etiketa, zona, mbulimi, baza ose rafti dhe parandalimi i rrjedhjes	Ruajtje e ndarë, e etiketuar dhe e gjurmueshme	Enë ose raft i pasigurt, përzierje rrymash ose kontakt me tokën e reshjet
5. Dalja	Klienti ose operatori, sasia, data dhe dokumenti i transferimit	Shitje, ripërdorim ose dorëzim i ligjshëm i mbeturinës	Mungesë gjurmueshmërie ose operator pa autorizim të verifikuar

Burimi: Procedurë e pranimit e hartuar për të siguruar zbatimin e kriterit produkt–mbeturinë.

Ndarja produkt–mbeturinë është elementi vendimtar i të gjithë sistemit. Pamja e një pjese të madhe të prerë nuk e përcakton vetvetiu statusin juridik të saj; vlerësohen dokumentet, origjina, gjendja teknike, përdorshmëria, destinimi dhe ekzistenca reale e tregut për të. Pjesët e papërdorshme, materialet e përziera pa destinim të qartë dhe materialet e destinuara vetëm për rikuperim ose asgjësim nuk trajtohen si mall tregtar. Vendimi përfundimtar administrativ mbetet në kompetencën e autoriteteve përkatëse.

Tabela 52. Shërbimet dhe burimet: gjendja e dëshmuar dhe kontrolli shtesë i nevojshëm

Shërbimi ose burimi	Gjendja e deklaruar ose e dëshmuar	Kontrolli shtesë i nevojshëm
Energjia elektrike	Furnizim nga rrjeti publik; faturë KESCO në emër të biznesit	Regjistrim mujor i kWh dhe kontroll periodik i instalimeve e i pajisjeve
Uji sanitar	Furnizim nga kompania rajonale e ujësjellësit	Kontrata ose numri i konsumatorit, matësi dhe konsumi mujor në m³
Ujërat fekale	Shkarkim në kanalizimin e vendbanimit – status i deklaruar nga aplikuesi	Dëshmia e kyçjes, pika e lidhjes dhe konfirmimi i operatorit ose i Komunës; në mungesë të lidhjes funksionale, projekt i gropës septike të mbyllur dhe të papërshkueshme
Ujërat atmosferike	Rrjedhje sipërfaqësore dhe pusetat ekzistuese; skema konceptuale e ndarjes dhe e kontrollit është paraqitur në raport	Projekt zbatues hidroteknik: ndarje e ujërave të pastra nga zonat me rrezik, sedimentim, separator hidrokarburesh, pusetë kontrolli dhe pikë daljeje e miratuar
Mbeturinat komunale	Shërbim nga KRM “Pastrimi” Sh.A. me kontejner 1,1 m³ sipas faturës	Frekuenca, sasitë dhe evidenca e zbrazjeve
Mbeturinat e servisimit dhe të lyerjes	Kërkohet ndarje dhe dorëzim sipas rrymës	Kontratat dhe licencat e operatorëve, kapacitetet e enëve dhe sasitë sipas kodeve
Gazet teknike dhe materialet e ndezshme	Përdoren në saldim dhe në lyerje	Regjistër i sasive të ruajtura njëkohësisht dhe fletët e të dhënave të sigurisë

Burimi: Faturat e shërbimeve të paraqitura në dosje dhe deklarimet e aplikuesit.

Aktiviteti nuk përdor ujë si lëndë të parë teknologjike dhe nuk përfshin proces industrial prodhimi. Burimet kryesore të rrezikut janë lëngjet e automjeteve, bateritë, filtrat, gomat, pjesët e rënda, magazinimi i jashtëm, ujërat atmosferike që kalojnë nëpër zona me rrezik, zhurma e servisit, emetimet nga lyerja dhe trafiku i dërgesave.

Për këtë profil rreziku, kontrolli fizik i lokacionit, mbajtja sekondare, karantina, gjurmueshmëria dhe menaxhimi i ndryshimit janë më efektive dhe më proporcionale sesa instalimi i teknologjive të rënda të trajtimit. Kjo është arsyeja pse masat e Kapitullit 7 janë të përqendruara te organizimi dhe te sipërfaqet, dhe jo te pajisjet e trajtimit.

Tabela 53. Ndryshimet që kërkojnë rishqyrtim para zbatimit

Ndryshimi i propozuar	Arsyeja për rishqyrtim	Veprimi i kërkuar para zbatimit
Rritje e qëndrueshme e kapacitetit	Ndryshon trafikun, stokun, mbeturinat, zhurmën dhe nevojat e ruajtjes	Vlerësim i kapacitetit dhe njoftim ose miratim sipas kërkesës
Prerje e automjeteve në Kosovë	Shton proces, pajisje, zhurmë, shkëndija, emetime dhe mbeturina	Procedurë e re teknike, kundër zjarrit dhe mjedisore; shqyrtim nga autoriteti
Import i automjeteve të plota për trajtim	Ndryshon statusin e dërgesës dhe e afron aktivitetin me trajtimin e automjeteve në fund të jetës	Klasifikim juridik dhe leje përkatëse para importit dhe operimit
Grumbullim i mbetjeve metalike si veprimtari	Aktivizon pikën 12.5 të Shtojcës 2 të Ligjit nr. 08/L-181	Vlerësim i ri i kategorisë dhe procedurë e veçantë
Zgjerim jashtë parcelave	Ndryshon sipërfaqen, pronësinë, zonimin dhe receptorët	Dokument pronësor, pajtueshmëri zonale dhe procedurë mjedisore e veçantë

Ndryshimi i propozuar	Arsyeja për rishqyrtim	Veprimi i kërkuar para zbatimit
Ndërtim ose drenazhim i ri	Ndryshon rrjedhjen e ujërave dhe sipërfaqet e papërshkueshme	Projekt, leje, dimensionim dhe përditësim i planit të monitorimit
Pajisje ose proces i ri	Mund të shtojë konsumin e energjisë, emetimet, zhurmën, dridhjet ose lëndët e rrezikshme	Menaxhim i ndryshimit, vlerësim rreziku dhe miratim para prokurimit
Larje e pjesëve me ujë	Krijon rrymë të re ujërash të ndotura me vajra dhe grimca	Projekt i mbledhjes dhe trajtimit; vlerësim i shkarkimit sipas UA (MMPHI) nr. 02/2022

Burimi: Procedurë e menaxhimit të ndryshimit e hartuar sipas kufijve të vlerësimit të këtij raporti.

Dokumentet mbështetëse duhet të jenë të datuara, të lexueshme dhe të lidhura qartë me operatorin e me lokacionin. Hartat mbajnë legjendë, shkallë, drejtimin e veriut, burimin, datën dhe kufirin e projektit. Fotografitë shoqërohen me datë, pozicion dhe drejtim. Matjet shoqërohen me metodën, pajisjen, kalibrimin, kushtet e matjes dhe interpretimin. Çdo dokument i zëvendësuar ruhet në arkiv me kontroll versioni.

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT 10

Karakteristika përcaktuese e projektit është kombinimi i servisit të automjeteve me importin dhe tregtimin e pjesëve të përdorura, përfshirë seksione të mëdha strukturore të prera jashtë Republikës së Kosovës. Qëllimi i VNM-së kufizohet në veprimtarinë ekzistuese dhe në kapacitetin e deklaruar. Kontrolli produkt–mbeturinë, karantina, sipërfaqet e mbrojtura, drenazhimi, gjurmueshmëria dhe menaxhimi i ndryshimit janë kushtet kryesore që e ruajnë këtë kufi; tejkalimi i ndonjërit prej tyre e nxjerr veprimtarinë jashtë kornizës së vlerësuar.

11. BURIMET E TË DHËNAVE

Burimet e të dhënave janë përzgjedhur sipas lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me veprimtarinë ekzistuese, me lokacionin, me receptorët mjedisorë dhe me kërkesat ligjore të raportit. Regjistri i mëposhtëm dallon dokumentet primare të operatorit, matjet dhe vrojtimet në terren, materialet hartografike, statistikat zyrtare, aktet juridike dhe burimet teknike.

Për çdo burim tregohet përdorimi konkret në raport dhe mënyra e kontrollit, në mënyrë që çdo pohim dhe çdo vlerësim të mund të gjurmohet deri te dokumenti bazë. Kjo strukturë e bën të mundur verifikimin e pavarur nga Komisioni i VNM-së dhe nga inspektimi.

Përparësi u është dhënë dokumenteve të lëshuara nga institucionet publike, dokumenteve të operatorit që identifikojnë biznesin dhe lokacionin, matjeve të kryera nga profesionistë të licencuar dhe burimeve zyrtare statistikore. Hartat dhe llogaritjet e përgatitura posaçërisht për raportin janë burime të prejardhura: ato nuk zëvendësojnë planin kadastral, dokumentin urbanistik, matjen laboratorike ose konfirmimin e autoritetit kompetent.

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Lista përfshin burimet e përdorura gjatë hartimit të kapitujve 1–12 të raportit. Termi “dosja e operatorit” i referohet kopjeve elektronike të dorëzuara për hartim; dokumentet përfundimtare duhet të paraqiten të lexueshme, të datuara dhe, kur kërkohet, të vërtetuara.

Burimet janë grupuar në pesë kategori: dokumente të operatorit dhe institucionale; burime gjeohapësinore dhe terrenore; burime zyrtare statistikore e mjedisore; akte juridike dhe standarde; dhe të dhëna të prejardhura. Kjo ndarje pasqyron nivelin e ndryshëm të besueshmërisë dhe të përdorshmërisë së secilës kategori.

Tabela 54. Dokumentet e operatorit dhe institucionale

Nr.	Burimi ose dokumenti	Lëshuesi, data ose identifikuesi	Përdorimi në raport	Kontrolli ose statusi
A-1	Certifikata e regjistrimit e AUTO SELIMI SH.P.K.	ARBK; regjistrim 27.03.2024; nr. serik 10181415	Emri, forma juridike, emri tregtar dhe adresa	Kopje e dorëzuar; krahasohet me ekstraktin aktiv në ditën e aplikimit
A-2	Informatat e biznesit dhe veprimtaritë e regjistruara	ARBK	NUI 812145119; veprimtaria kryesore dhe sekondare; të dhënat e përfaqësuesit	Dokument i skanuar; data e nxjerrjes duhet të jetë e lexueshme
A-3	Deklarimet teknike të aplikuesit	AUTO SELIMI SH.P.K., viti 2026	Statusi ekzistues; orari 08:00–16:00; kapaciteti mujor; sipërfaqet e zgjerimit	Verifikohet me evidencat mujore dhe me projektin zbatues
A-4	Sqarimi për procesin dhe kufirin teknologjik	Deklarim i aplikuesit	Prerja kryhet jashtë Kosovës; në lokacion kryhen pranimi, ruajtja, tregtimi dhe servisi	Procedura e pranimit është formalizuar në Tabelën 51; formulari i pranimit plotësohet dhe arkivohet për çdo dërgesë
A-5	Fatura e energjisë elektrike	KESCO; konsumatori AUTO SELIMI SH.P.K.; viti 2026	Dëshmi e furnizimit të lokacionit nga rrjeti publik	Vlerat e konsumit përdoren vetëm pas transkriptimit nga faturat e lexueshme

Nr.	Burimi ose dokumenti	Lëshuesi, data ose identifikuesi	Përdorimi në raport	Kontrolli ose statusi
A-6	Fatura e shërbimit të mbeturinave komunale	KRM “Pastrimi” Sh.A.; nr. 6856823; 30.06.2026; ID 129776	Dëshmi e shërbimit me kontejner 1,1 m³ dhe e adresës	Mbulon vetëm mbeturinat komunale; nuk dëshmon rrymat e rrezikshme
A-7	Të dhënat për ujësjellësin dhe kanalizimin	Deklarim i aplikuesit	Uji sanitar nga kompania rajonale; ujërat fekale në kanalizimin e vendbanimit	Kërkohen dëshmia e kyçjes, numri i konsumatorit dhe konsumi i matur
A-8	Licenca për VNM e hartueses	MMPHI; nr. 20/19/24; vlefshmëri 12.08.2024 – 11.08.2029	Baza e kompetencës për hartimin e raportit	Kopja i bashkëngjitet dosjes së aplikimit

Burimi: Dosja e dokumenteve e vënë në dispozicion për hartimin e raportit.

Tabela 55. Burimet gjeohapësinore dhe terrenore

Nr.	Burimi	Metadatat kryesore	Përdorimi në raport	Kufizimi i përdorimit
G-1	Situacioni i terrenit – matjet e gjeodetit	ZK Lipjan; parcelat 1402-2 dhe 1402-9; lënda S/2026; shkalla 1:750; Florent Retkoceri, licencë 182; rilevim 17.08.2026	Kufiri i projektit, koordinatat e 10 pikave, objektet dhe sipërfaqja 5.094 m²	Burim primar për gjeometrinë; bashkëngjitet i plotë në shtojcë
G-2	Harta e pozitës gjeografike dhe kadastrale	Material hartografik i korrigjuar dhe i harmonizuar me situacionin gjeodetik	Pozita në raport me Lipjanin, Banullën dhe rrjetin rrugor; parcelat 1402-2 dhe 1402-9	Etiketat e parcelave janë harmonizuar me G-1; përdoret për paraqitje orientuese, ndërsa G-1 mbetet burim primar për gjeometrinë
G-3	Harta e qasjes rrugore	Ortofoto me kufirin e zonës së projektit	Qasja nga rruga Bajram Gashi dhe konteksti i përdorimeve fqinje	Data, ofruesi dhe rezolucioni i ortofotos duhet të shënohen
G-4	Harta e distancave	Hartë e distancave vijëdrejta nga lokacioni	Distancat orientuese ndaj vendbanimeve dhe objekteve orientuese	Distancat janë hartografike; verifikohen me matje GIS ose gjeodetike
G-5	Harta e rrjedhave ujore	Rrjeti hidrografik i zonës Lipjan–Banullë–Gllogoc	Identifikimi i rrjedhave në afërsi dhe i rrugëve të mundshme të ndotjes	Pa matje të cilësisë, të prurjes ose të distancës së kontrolluar
G-6	Harta gjeologjike	Shtresë tematike rajonale	Përshkrimi rajonal i përbërjes gjeologjike dhe i kontekstit të terrenit	Shkalla rajonale nuk lejon projektim gjeoteknik
G-7	Harta pedologjike	Shtresë tematike e tokave me kufirin e projektit	Përshkrimi pedologjik dhe ndjeshmëria e tokës ndaj ndotjeve	Emërtimi i njësisë verifikohet me metadatat e shtresës burimore
G-8	Harta zonale e shfrytëzimit të tokës	Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2021–2029	Konteksti zonal dhe përdorimi i tokës rreth parcelave	Pajtueshmëria juridike vërtetohet vetëm me konfirmim zyrtar urbanistik
G-9	Harta e qasjes në kanalizim	Material hartografik mbi ortofoto	Trasea e propozuar dhe pozitat e pusetave	Ka karakter propozimi; kërkon konfirmim nga operatori dhe nga Komuna
G-10	Fotografitë e terrenit	Fotografi të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026	Gjendja ekzistuese, sipërfaqet, stoku, objektet, hyrja dhe organizimi	Në shtojcë duhet të shtohen data, koordinatat dhe drejtimi i fotografimit

Nr.	Burimi	Metadatat kryesore	Përdorimi në raport	Kufizimi i përdorimit
G-11	Skica e organizimit dhe e zgjerimeve	Skicë e aplikuesit mbi ortofoto	Objekti P+3, zonat e zgjerimit dhe drejtimi i qarkullimit	Konceptuale; dimensionet verifikohen në projektin zbatues
G-12	Skica konceptuale e zonimit funksional	Skicë konceptuale e përgatitur për organizimin e lokacionit	Ndarja e zonave funksionale dhe elementet mjedisore	Sipërfaqet janë të përafërta; nuk zëvendëson planimetrinë e aprovuar

Burimi: Materialet gjeohapësinore dhe fotografike të dorëzuara për hartimin e raportit.

Tabela 56. Burimet zyrtare statistikore dhe mjedisore

Nr.	Burimi ose publikimi	Referenca e kontrolluar	Të dhënat e përdorura
S-1	Agjencia e Statistikave të Kosovës, Profili i Komunës së Lipjanit	ASK, korrik 2026; i bazuar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024	Popullsia 55.044 banorë; struktura urbane e rurale; dendësia; njësitë e banimit
S-2	Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2021–2029	Dokument komunal i planifikimit hapësinor	Kategoritë e shfrytëzimit të tokës dhe konteksti zonal i lokacionit
S-3	Materialet mjedisore dhe zhvillimore të Komunës së Lipjanit	Dokumente komunale të cituara në kapitujt 3 dhe 4	Treguesit klimatikë: temperatura 10,0–10,5 °C; lagështia 74,7 %; reshjet 673,3 mm; insolacioni 2.018 orë; era juglindore rreth 4,0 m/s
S-4	Baza publike kadastrale dhe hartografike	Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe shtresat bazë të përdorura në situacion	Kontrolli i kufijve, i parcelave dhe i marrëdhënieve hapësinore
S-5	Raporti vjetor i gjendjes së mjedisit	AMMK/MMPHI	Konteksti kombëtar për ajrin, ujin, tokën, biodiversitetin dhe presionet mjedisore
S-6	Raporti për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë 2023–2024	AMMK/MMPHI	Konteksti institucional i menaxhimit të mbeturinave komunale
S-7	Vjetari Hidrometeorologjik i Kosovës	IHMK/AMMK/MMPHI	Referencë zyrtare hidrometeorologjike rajonale dhe kombëtare
S-8	Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës	MMPH, 2013	Burim kontrolli për statusin e llojeve; përdoret për shqyrtim paraprak
S-9	Libri i Kuq i Faunës së Republikës së Kosovës	Prishtinë, 2019	Burim kontrolli për statusin e faunës; kërkon verifikim në terren kur preket vegjetacioni
S-10	Vrojtimi profesional dhe përpunimi nga hartuesja	Luljeta Kastrati, viti 2026	Kryqëzimi i dosjes, identifikimi i receptorëve, matricat e ndikimit, masat, monitorimi dhe përfundimet

Burimi: Publikime zyrtare institucionale dhe vrojtim profesional i hartueses.

Burimet kombëtare të cilësisë së ajrit dhe të gjendjes së mjedisit përdoren vetëm si kontekst. Ato nuk përmbajnë stacion matës të dedikuar për zonën e projektit dhe nuk mund të përdoren për të përcaktuar gjendjen e lokacionit ose për të pretenduar përputhshmëri me vlerat kufitare.

Regjistri i akteve juridike i paraqitur më poshtë përmban statusin e verifikuar të secilit akt në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Për çdo akt të ndryshuar është shënuar akti ndryshues, ndërsa për aktet që kanë shfuqizuar akte të mëparshme është shënuar edhe akti i shfuqizuar, në mënyrë që të mos përdoret asnjë referencë e vjetruar.

Tabela 57. Regjistri i akteve juridike dhe statusi i tyre i verifikuar

Nr.	Akti juridik	Referenca zyrtare dhe data	Statusi juridik	Roli në raport
L-1	Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis	Gazeta Zyrtare nr. 2/2023, 06.01.2023	Në fuqi; shfuqizon Ligjin nr. 03/L-214	Baza ligjore e procedurës, e përgjegjësive dhe e përmbajtjes së raportit
L-2	Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 04/2025 për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore	Nënshkruar 04.12.2025; publikuar 05.12.2025; hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit	Në fuqi	Struktura, titujt dhe kërkesat metodologjike të kapitujve 1–12
L-3	Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 03/2025 për procedurat dhe kriteret për licencimin e personave fizikë dhe juridikë për hartimin e raportit të VNM-së	Publikuar 26.11.2025	Në fuqi	Baza për licencimin e hartuesit sipas nenit 12 të Ligjit nr. 08/L-181
L-4	Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 11/2025 për procedurat e detajuara për planifikimin dhe organizimin e konsultimeve publike për raportin e VNM-së	Publikuar 31.12.2025	Në fuqi	Procedura e konsultimit publik dhe e debatit publik
L-5	Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Gazeta Zyrtare nr. 50/2009, 06.04.2009	Në fuqi; i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-276 (27.12.2024) dhe me Ligjin nr. 08/L-283 (26.12.2024)	Parimet e përgjithshme të mbrojtjes së mjedisit
L-6	Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina	Gazeta Zyrtare nr. 17/2012, 29.06.2012	Në fuqi; i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (01.09.2022) dhe me Ligjin nr. 08/L-262 (08.08.2024)	Klasifikimi, ndarja, magazinimi, evidenca dhe dorëzimi i mbeturinave
L-7	Udhëzimi Administrativ nr. 13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave	MMPH; publikuar 06.11.2014	Në fuqi	Kodet e mbeturinave të përdorura në kapitujt 2, 7 dhe 8
L-8	Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 03/2021 për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme	Publikuar 26.01.2021	Në fuqi; shfuqizon UA nr. 06/2008	Ndarja, paketimi, etiketimi, magazinimi dhe dorëzimi i rrymave të rrezikshme
L-9	Udhëzimi Administrativ MMPHI nr. 02/2024 për përcaktimin e kushteve, kritereve dhe procedurave për lëshimin e lejes për import, eksport dhe kalim tranzit të mbeturinave	Publikuar 01.03.2024	Në fuqi; shfuqizon UA nr. 02/2019	Zbatohet vetëm kur dërgesa ka status mbeturine
L-10	Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	Gazeta Zyrtare nr. 18/2022, 13.07.2022	Në fuqi; shfuqizon Ligjin nr. 03/L-160	Mbrojtja e cilësisë së ajrit dhe kontrolli i burimeve të ndotjes

Nr.	Akti juridik	Referenca zyrtare dhe data	Statusi juridik	Roli në raport
L-11	Udhëzimi Administrativ (QRK) nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes	Publikuar 04.08.2021	Në fuqi; shfuqizon UA nr. 06/2007	Referencë për kabinën e lyerjes si burim i palëvizshëm, sipas zbatueshmërisë
L-12	Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Gazeta Zyrtare nr. 10/2013, 29.04.2013	Në fuqi; i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 08/L-176 (06.07.2023) dhe me Ligjin nr. 08/L-283 (26.12.2024)	Mbrojtja e ujërave, lejet ujore dhe shkarkimet
L-13	Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor	Publikuar 17.05.2022	Në fuqi; shfuqizon UA MMPH nr. 30/2014	Kushtet e shkarkimit sanitar dhe ndalimi i shkarkimeve teknike
L-14	Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	Gazeta Zyrtare nr. 40/2008, 15.10.2008	Në fuqi; i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-176 (06.07.2023)	Mbrojtja e receptorëve nga zhurma dhe baza për matjet
L-15	Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Gazeta Zyrtare nr. 85/2010, 09.11.2010	Në fuqi; i ndryshuar me Ligjet nr. 08/L-176 (06.07.2023), nr. 08/L-276 (27.12.2024) dhe nr. 08/L-283 (26.12.2024)	Mbrojtja e natyrës, e habitateve dhe e llojeve
L-16	Ligji nr. 08/L-261 për Mbrojtje nga Zjarri	Publikuar 12.08.2024	Në fuqi; shfuqizon Ligjin nr. 04/L-012	Kërkesat për mbrojtjen nga zjarri dhe për pajisjet
L-17	Udhëzimi Administrativ (MMPHI) nr. 04/2022 për leje mjedisore	Publikuar 03.06.2022	Në fuqi; i ndryshuar me UA (MMPHI) nr. 01/2025 (28.05.2025); shfuqizon UA MMPH nr. 07/2017	Procedura dhe kushtet e lejes mjedisore, sipas zbatueshmërisë
T-1	ISO 14001:2026 – Environmental management systems: Requirements with guidance for use	Organizata Ndërkombëtare për Standardizim; publikuar 15.04.2026	Botim aktual i standardit; zbatim vullnetar	Referencë për sistemin e menaxhimit mjedisor në Kapitullin 9

Burimi: Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; faqet zyrtare të institucioneve kompetente; Organizata Ndërkombëtare për Standardizim. Statusi i akteve është rikontrolluar më 24.08.2026.

Të gjitha aktet e listuara janë verifikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës për sa i përket titullit, numrit, datës së publikimit dhe statusit juridik. Aty ku një ligj është ndryshuar, referenca në raport përdoret në formën e plotë, duke përfshirë aktin ndryshues; asnjë akt i shfuqizuar nuk përdoret si bazë ligjore.

Tabela 58. Të dhënat e prejardhura dhe metoda e nxjerrjes së tyre

Nr.	E dhëna e prejardhur	Burimet hyrëse	Metoda dhe përdorimi	Statusi i verifikimit
D-1	Sipërfaqja 5.094 m² dhe koordinatat e kufirit	G-1	Lexim i drejtpërdrejtë nga dokumenti gjeodetik; përdoret si kufi hapësinor i VNM-së	E dokumentuar; harmonizohet me certifikatën e pronës dhe me kopjen e planit
D-2	Sipërfaqja e mbetur e lirë prej rreth 3.814 m²	G-1 dhe A-3	Zbritje aritmetike: 5.094 m² − 1.280 m²	E prejardhur; saktësohet me planimetrinë e aprovuar
D-3	Vlerat vjetore prej rreth 360 dhe rreth 180 njësive	A-3	Ekstrapolim dymbëdhjetëmujor i mesatares mujore të deklaruar	E prejardhur; zëvendësohet me evidencën reale vjetore
D-4	Distancat ndaj vendbanimeve dhe receptorëve	G-1, G-2, G-4 dhe G-5	Lexim nga harta e distancave; shërben për vlerësimin e ekspozimit	Orientuese derisa të kryhet matja GIS ose gjeodetike
D-5	Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve	A-3, A-4, G-1 deri G-12, S-1 deri S-10	Kombinim i madhësisë, shtrirjes, kohëzgjatjes, frekuencës, kthyeshmërisë, probabilitetit dhe ndjeshmërisë së receptorit	Gjykim profesional; rishikohet pas matjeve bazë
D-6	Ndryshimet demografike 2011–2024	S-1	Llogaritje e diferencave dhe e ndryshimeve në përqindje	E prejardhur nga vlerat e publikuara
D-7	Bilanci i hyrjeve, i pjesëve dhe i mbeturinave	A-3; dokumentet e importit, të servisit, të shitjes dhe të dorëzimit	Bilanc mujor dhe vjetor sipas rrymës; kontrollon gjurmueshmërinë dhe kapacitetin	Jo i plotë pa peshimet dhe pa evidencat dymbëdhjetëmujore
D-8	Plani i monitorimit dhe masat	Rreziqet e identifikuara, matricat e ndikimit dhe kërkesat ligjore	Përcakton treguesin, vendin, frekuencën, përgjegjësin, pragun dhe evidencën	Finalizohet me pikat, koordinatat, laboratorët dhe operatorët e kontraktuar

Burimi: Metodologjia e përpunimit të të dhënave e zbatuar në këtë raport.

Kontrolli i cilësisë së burimeve është kryer përmes krahasimit të emrit të operatorit, të adresës, të numrit të biznesit, të parcelave dhe të datave ndërmjet dokumenteve. Kur i njëjti fakt është paraqitur në disa burime, si referencë kryesore është përdorur burimi zyrtar ose matja e licencuar.

Harta 1 është harmonizuar me situacionin gjeodetik dhe mospërputhja numerike e etiketave të parcelave është eliminuar. Mungesat dokumentare që mbeten – veçanërisht dëshmia zyrtare për ujësjellësin e kanalizimin, dokumentet kadastrale të Shtojcës III, kontratat për rrymat e mbeturinave dhe projekti zbatues i drenazhimit – nuk plotësohen me supozim; ato mbahen si çështje të hapura me burimin, përgjegjësin dhe kapitullin e integrimit të përcaktuar.

Për të dhënat sasiore ruhet dokumenti burimor, njësia, periudha, mënyra e matjes dhe personi përgjegjës. Vlerat e kapacitetit të dhëna nga operatori shërbejnë si bazë vlerësimi, por kontrollohen me regjistrat e punës, të importit, të shitjes, të peshimit dhe të dorëzimit të mbeturinave. Fotografitë, hartat dhe faturat arkivohen në versionin origjinal; kopjet e vendosura në raport nuk janë burimi i vetëm i ruajtur.

Burimet elektronike zyrtare janë rikontrolluar më 24.08.2026. Statusi i akteve verifikohet edhe nga autoriteti gjatë procedurës; çdo burim i ri regjistrohet me titullin, institucionin, datën, versionin, faqen ose shtresën e përdorur dhe datën e qasjes.

12. SHTOJCA

Ky kapitull përmban përmbledhjen jo-teknike të informacionit dhe regjistrin e dokumenteve mbështetëse të raportit të VNM-së për veprimtarinë ekzistuese të AUTO SELIMI SH.P.K.. Përmbledhja është shkruar për publikun dhe për palët e interesuara; ajo jep thelbin e projektit, gjendjen e mjedisit, ndikimet, masat dhe monitorimin, pa zëvendësuar analizën e plotë të kapitujve 1–11.

Përmbajtja e përmbledhjes joteknike ndjek nenin 14 të UA-së nr. 04/2025: projekti dhe lokacioni gjeografik e juridiksioni administrativ; distancat nga kufijtë e vendbanimeve dhe nga objektet kyçe; ndikimet e rëndësishme mjedisore; masat e propozuara; përfitimet nga zbatimi; alternativat e shqyrtuara; dhe harta ilustruese në format A4.

Gjuha e përdorur në përmbledhje është e thjeshtuar qëllimisht dhe pa terma të specializuar. Kur përdorimi i një termi teknik është i pashmangshëm, ai shpjegohet menjëherë në të njëjtën fjali.

12.1. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

Kjo përmbledhje është hartuar për publikun, për fqinjët e lokacionit, për përfaqësuesit e Komunës dhe për çdo palë të interesuar që dëshiron të kuptojë projektin pa lexuar tërë raportin teknik. Ajo paraqet të njëjtat përfundime si kapitujt 1–11, por me gjuhë të thjeshtuar dhe pa detaje metodologjike.

Përmbledhja nuk zëvendëson raportin dhe nuk përmban informacion që nuk gjendet në të. Kur një term teknik është i pashmangshëm, ai shpjegohet menjëherë. Kur një e dhënë nuk është matur ose konfirmuar, kjo thuhet hapur në seksionin për çështjet e hapura, në mënyrë që lexuesi të dijë saktësisht se ku mbaron dëshmia dhe ku fillon vlerësimi profesional.

Struktura e përmbledhjes ndjek nenin 14 të UA-së nr. 04/2025 dhe përfshin identifikimin e projektit, vendndodhjen dhe mjedisin përreth, përshkrimin e veprimtarisë, infrastrukturën, gjendjen aktuale të mjedisit, alternativën e rekomanduar, ndikimet kryesore, masat mbrojtëse, monitorimin dhe informimin e publikut, përfitimet e projektit dhe çështjet që mbeten të hapura.

Identifikimi i projektit dhe i aplikuesit

Titulli i projektit është “Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve, importimi dhe tregtimi i pjesëve të përdorura, përfshirë pjesët strukturore të prera të automjeteve”. Aplikuesi është AUTO SELIMI SH.P.K., me numër unik identifikues 812145119 dhe me adresë Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan. Veprimtaria është ekzistuese dhe zhvillohet në të njëjtin lokacion.

Raporti është hartuar nga Luljeta Kastrati, Inxh. dipl. e Bujqësisë, person fizik i licencuar nga Ministria për hartimin e raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, me licencë nr. 20/19/24 të vlefshme 12.08.2024 – 11.08.2029.

Qëllimi i raportit është të përshkruajë veprimtarinë, të vlerësojë ndikimet e saj në mjedis, të propozojë masa konkrete mbrojtëse dhe të përcaktojë një program monitorimi të verifikueshëm. Raporti nuk jep leje dhe nuk zëvendëson vendimin e Ministrisë; ai është dokumenti mbi bazën e të cilit merret ai vendim.

Tabela 59. Të dhënat kryesore të projektit në formë të përmbledhur

Elementi	Të dhëna
Aplikuesi	AUTO SELIMI SH.P.K.; NUI 812145119
Veprimtaria	Servisim automjetesh dhe tregtim i pjesëve të përdorura, përfshirë seksione strukturore të prera
Statusi	Veprimtari ekzistuese
Lokacioni	Rr. Bajram Gashi, nr. 112, Lipjan, ZK Lipjan
Parcelat	1402-2 dhe 1402-9 sipas situacionit gjeodetik
Sipërfaqja	5.094 m²
Zgjerimi i planifikuar	1.280 m² (autoservis 550 m² + garazh/depo 730 m²)
Orari i punës	08:00–16:00, e hënë – e shtunë
Kapaciteti	Rreth 30 automjete të riparuara në muaj dhe rreth 15 vetura ose furgona të prerë të importuar në muaj


Burimi: Deklarimet e aplikuesit dhe situacioni gjeodetik i datës 17.08.2026.

Vendndodhja dhe mjedisi përreth

Lokacioni gjendet në skajin lindor dhe periurban të qytetit të Lipjanit, në një korridor me veprimtari komerciale dhe shërbyese, me qasje të drejtpërdrejtë nga rruga Bajram Gashi e lidhur me rrugën rajonale R-120. Situacioni i terrenit i datës 17.08.2026 paraqet kufirin e parcelave, dhjetë pikat me koordinata, objektet dhe sipërfaqen prej 5.094 m².

Në afërsi ndodhen biznese, ndërtesa të shfrytëzuara, parcela të hapura dhe sipërfaqe bujqësore ose të pazhvilluara. Harta e distancave paraqet orientueshëm një pikë të vendbanimit në Lipjan në rreth 470 m, një xhami në rreth 963 m, një pikë të vendbanimit Banullë në rreth 1.147 m dhe një kishë në rreth 1.369 m nga zona e projektit.

Megjithatë, fotografitë dhe ortofotoja tregojnë se objekte të shfrytëzuara ndodhen edhe në afërsi të drejtpërdrejtë. Për vlerësimin e zhurmës, të pluhurit dhe të trafikut, si receptor kritik merret objekti i përdorur më i afërt dhe jo qendra e vendbanimit. Kjo zgjedhje e bën vlerësimin më të rreptë dhe masat më të kërkueshme.



Harta 10. Pozita gjeografike e veprimtarisë në raport me vendbanimet dhe me rrjetin rrugor

Burimi: Material hartografik i përgatitur për projektin; situacioni gjeodetik verifikohet veçmas.

Brenda parcelës nuk ka lumë, përrua ose burim. Një rrjedhë ujore shfaqet në hartën tematike në lindje deri juglindje. Sipërfaqja operative është kryesisht e shtruar, por ka edhe pjesë të hapura. Tereni është fushor dhe harta gjeologjike e vendos zonën në depozitime proluviale. Nuk janë dorëzuar matje lokale për ujërat nëntokësore, për cilësinë e tokës, të ajrit ose për zhurmën.

Çfarë zhvillohet në lokacion

Operatori pranon automjete për mirëmbajtje dhe riparim dhe importon pjesë të përdorura nga vetura e furgona. Automjetet nga të cilat merren pjesët priten jashtë Republikës së Kosovës në seksione të mëdha, si pjesa e përparme, pjesa e pasme ose seksione të tjera strukturore.

Në lokacionin e Lipjanit nuk kryhet prerja e automjeteve të plota. Aty kryhen pranimi, kontrolli, karantina kur ka rrjedhje ose status të paqartë, ruajtja, nxjerrja e pjesëve, tregtimi dhe punët e servisit – mekanike, elektrike, të karrocerisë, të lyerjes dhe të gomisterisë.

Ky dallim është i rëndësishëm për publikun sepse përcakton natyrën e veprimtarisë: bëhet fjalë për një autoservis me tregti pjesësh, dhe jo për një qendër trajtimi ose çmontimi të automjeteve në fund të jetës. Nëse kjo natyrë do të ndryshonte, do të kërkohej vlerësim i ri dhe leje të reja.

Tabela 60. Hapat kryesorë të veprimtarisë dhe kontrolli mjedisor

Hapi	Veprimi	Kontrolli mjedisor kryesor
1	Dokumentimi i dërgesës dhe kontrolli para importit	Origjina, fatura, lista e pjesëve, dokumentet doganore dhe destinimi real për ripërdorim
2	Pranimi dhe kontrolli fizik në zonën e caktuar	Kontroll për rrjedhje, lëngje të mbetura, dëmtim, papastërti dhe qëndrueshmëri të ngarkesës
3	Karantina dhe klasifikimi	Ndarje e materialit të dyshimtë; vendim i dokumentuar produkt – pjesë e ripërdorshme – mbeturinë
4	Ruajtja dhe inventarizimi	Pjesët e pastra nën mbulim dhe mbi rafte; pjesët e mëdha të stabilizuara; mbeturinat të ndara dhe të etiketuara
5	Servisimi dhe punët e karrocerisë e të lyerjes	Tava mbajtëse, aspirim lokal, ventilim dhe filtra në kabinën e lyerjes
6	Shitja, montimi ose dorëzimi	Evidencë e daljes; mbeturinat i dorëzohen vetëm operatorit të autorizuar sipas rrymës

Burimi: Përshkrimi i procesit sipas Kapitullit 2 dhe Kapitullit 5 të këtij raporti.

SQARIM PËR STATUSIN PRODUKT–MBETURINË

Një pjesë e prerë nuk është automatikisht as produkt dhe as mbeturinë. Statusi i saj varet nga dokumentet, nga gjendja teknike, nga përdorshmëria, nga destinimi dhe nga ekzistenca reale e tregut. Pjesët e papërdorshme, materialet pa destinim të qartë ose materialet që shkojnë vetëm për rikuperim e asgjësim menaxhohen si mbeturina. Vendimi administrativ përfundimtar i takon autoritetit kompetent.

Infrastruktura dhe burimet

Energjia elektrike merret nga rrjeti publik dhe dëshmohet me faturën e furnizuesit në emër të biznesit. Uji përdoret për nevoja sanitare dhe, sipas deklarimit të operatorit, merret nga kompania rajonale e ujësjellësit. Po sipas deklarimit të operatorit, ujërat fekale shkarkohen në kanalizimin e vendbanimit; dëshmia e kyçjes mbetet dokument shoqërues i dosjes.

Shërbimi për mbeturinat komunale ofrohet nga KRM “Pastrimi” Sh.A., sipas faturës nr. 6856823 të datës 30.06.2026. Ky shërbim mbulon vetëm mbeturinat e zakonshme; ai nuk mbulon vajrat e përdorura, filtrat, bateritë, antifrizin, lëngjet e frenave, mbetjet e bojërave, absorbuesit e kontaminuar, gomat ose mbetjet metalike.

Mungesa e kontratave me operatorë të licencuar për rrymat e veçanta mbetet gjetje e hapur dokumentare, por raporti e lidh qartë me një kusht operativ: para dorëzimit të parë të secilës rrymë duhet të verifikohet autorizimi i operatorit dhe të sigurohet kontrata ose marrëveshja përkatëse. Pa këto dokumente, veprimtaria nuk mund të dëshmojë destinacion të ligjshëm të mbeturinave dhe dorëzimi nuk lejohet.

Gjendja aktuale e mjedisit

Gjendja bazë paraqet një lokacion komercial ekzistues me oborr kryesisht të shtruar, me automjete dhe pjesë të ruajtura në hapësirë të jashtme, me qasje rrugore dhe me lidhje me shërbimet publike. Nuk është dokumentuar oxhak industrial ose proces i vazhdueshëm djegieje.

Burimet kryesore ekzistuese të presionit mbi mjedisin janë trafiku, ndezja e automjeteve, pluhuri nga sipërfaqet e hapura dhe nga bluarja, tymi i saldimit, avujt nga lyerja, zhurma e veglave, rrjedhjet e mundshme të lëngjeve dhe kontakti i pjesëve me reshjet.

Nuk janë dorëzuar analiza laboratorike të tokës dhe të ujit, matje të ajrit ose matje të zhurmës në kufi dhe te receptori më i afërt; nuk është paraqitur as skemë e plotë e drenazhimit ose dëshmi e separatorit të vajrave. Për këtë arsye raporti identifikon rreziqet dhe masat me parimin e kujdesit, por nuk pretendon përputhshmëri numerike me vlerat kufitare pa matje.



Figura 9. Gjendja ekzistuese e zonës operative dhe e magazinimit të pjesëve

Burimi: Fotografi të terrenit të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026.

Alternativa e rekomanduar

Janë shqyrtuar katër alternativa: vazhdimi në lokacionin ekzistues me përmirësime; vazhdimi pa ndryshime; riorganizimi i thellë i lokacionit; dhe zhvendosja në një zonë tjetër komerciale ose industriale. Është shqyrtuar veçmas edhe alternativa pa veprim.

Alternativa e rekomanduar është vazhdimi i veprimtarisë në lokacionin ekzistues me riorganizim funksional dhe me masa teknike. Nuk rekomandohet vazhdimi me organizimin e pandryshuar, kur automjetet dhe pjesët bllokojnë korridoret, prekin tokën, ekspozohen pa kontroll ndaj reshjeve ose përzihen me mbeturinat.

Zgjerimi jashtë parcelave nuk konsiderohet pa dokument pronësor, pa pajtueshmëri zonale dhe pa procedurë të veçantë. Nëse masat e propozuara nuk realizohen ose nuk miratohen, zgjidhja e mbetur nuk është vazhdimi i gjendjes së tanishme, por riorganizimi i thellë ose zhvendosja.




Figura 10. Organizimi funksional i propozuar i lokacionit sipas zonave të përdorimit

Burimi: Skicë konceptuale për organizimin funksional; sipërfaqet janë orientuese dhe konkretizohen me planimetrinë e aprovuar.

Ndikimet kryesore dhe rëndësia e tyre

Veprimtaria nuk përfshin prodhim industrial të rëndë, por përfshin karroceri, bluarje, saldim dhe lyerje në kabinë ose furrë, përveç servisimit mekanik dhe tregtimit të pjesëve. Ndikimet janë kryesisht lokale dhe të kufizuara në kohë.

Pa masa, rreziku më i rëndësishëm lidhet me tokën dhe me ujin nga lëngjet e automjeteve, si dhe me ajrin nga avujt e bojërave, nga pluhuri i bluarjes dhe nga tymi i saldimit. Rreziqe të tjera janë zhurma te fqinjët, trafiku në hyrje, zjarri dhe menaxhimi i gabuar i mbeturinave.

Pas zbatimit të ventilimit dhe të filtrimit, të menaxhimit të materialeve e të mbeturinave, të kontrollit të ujërave dhe të monitorimit, ndikimet e mbetura vlerësohen të ulëta deri të mesme dhe të kontrollueshme. Nuk identifikohet ndikim i rëndësishëm ndërkufitar dhe nuk është identifikuar humbje e drejtpërdrejtë e habitatit natyror, e zonës së mbrojtur ose e ndonjë aseti të trashëgimisë brenda parcelës.

Tabela 61. Ndikimet kryesore, rreziku pa masa dhe gjendja e synuar pas masave

Faktori	Burimi i ndikimit	Rreziku pa masa	Gjendja e synuar pas masave
Toka dhe ujërat	Vajra, karburante, antifriz, lëngje frenash, bateri dhe reshje mbi zona të ndotshme	I mesëm deri i lartë; bëhet afatgjatë nëse rrjedhjet mbeten të pakontrolluara	I ulët deri i mesëm me bazë të papërshkueshme, mbajtje sekondare, mbulim dhe drenazhim
Ajri	Trafiku, ndezjet, pluhuri i bluarjes, tymi i saldimit dhe avujt nga lyerja	I ulët deri i mesëm dhe lokal	I ulët me ventilim e filtra, aspirim lokal dhe enë të mbyllura
Zhurma	Veglat e servisit, kompresori, manipulimi i pjesëve dhe trafiku	I mesëm te receptorët e afërt gjatë orarit të punës	I ulët deri i mesëm me orar 08:00–16:00, mirëmbajtje dhe punë brenda objektit
Mbeturinat	Vajra, filtra, bateri, goma, metale, bojëra dhe absorbues	I mesëm deri i lartë nëse përzihen ose dorëzohen pa gjurmueshmëri	I ulët me ndarje sipas kodit, etiketa, evidencë dhe operatorë të licencuar
Trafiku dhe siguria	Hyrje-daljet e klientëve, të dërgesave dhe të mjeteve të rënda	I mesëm në hyrje dhe në korridoret e ngushta	I ulët deri i mesëm me plan lëvizjeje, parkim të ndarë dhe korridor të lirë
Pamja dhe peizazhi	Stok i dendur dhe ruajtje e dukshme nga rruga	I mesëm dhe i vazhdueshëm	I ulët deri i mesëm me zona të rregulluara, rafte, ekranim dhe kufi lartësie
Shëndeti i njeriut	Zhurmë, tretës, derdhje, zjarr, pjesë të rënda dhe trafik	I mesëm; mund të bëhet i lartë në rast aksidenti	I ulët deri i mesëm me procedura, pajisje mbrojtëse, trajnim dhe plan emergjence

Burimi: Përmbledhje e vlerësimit të Kapitullit 6 dhe e masave të Kapitullit 7.

Masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit

Masat janë hartuar për të vepruar në burim dhe jo për të trajtuar pasojat. Ato ndahen në masa me afat të menjëhershëm, të cilat nuk kërkojnë leje dhe mund të zbatohen brenda muajit të parë, dhe në masa teknike me afat të mesëm, të cilat kërkojnë projekt dhe, sipas rastit, leje.

Grupi i parë përfshin caktimin e përgjegjësit mjedisor, lirimin e korridoreve, etiketimin dhe ndarjen e mbeturinave, vendosjen e kompleteve për derdhje dhe të aparateve kundër zjarrit, mbrojtjen e pusetave dhe ndalimin e kontaktit të pjesëve me tokën. Grupi i dytë përfshin sipërfaqet e papërshkueshme, zonën e mbuluar të mbeturinave, projektin e drenazhimit dhe separatorin e vajrave kur e kërkon dimensionimi teknik.

Të gjitha masat janë të lidhura me një përgjegjës, me një afat, me një tregues të zbatimit dhe me një dokument dëshmues. Ky lidhje është ajo që e bën planin të verifikueshëm nga inspektimi dhe jo thjesht një listë premtimesh.

Tabela 62. Masat kryesore sipas fushave dhe dëshmia e zbatimit

Fusha	Masa që duhet zbatuar	Dëshmia e zbatimit
Pranimi dhe karantina	Kontroll dokumentar dhe fizik; ndalim i shkarkimit të ngarkesës me rrjedhje aktive; zonë karantine e shënuar	Formulari i pranimit, fotografitë, etiketat dhe regjistri i vendimit
Toka dhe ujërat	Dysheme e papërshkueshme në zonat me rrezik; mbajtje sekondare; mbrojtje e pusetave; ndarje e ujërave; separator sipas projektit	Plani i drenazhimit, inspektimet, mirëmbajtja dhe evidenca e incidenteve
Mbeturinat e rrezikshme	Enë të mbyllura, kompatibile dhe të etiketuara; ruajtje nën mbulim; bateritë mbi bazë rezistente; ndalim i përzierjes	Inventar sipas kodit, sasisë dhe datës; fletëpërcjellëse te operatori i licencuar
Pjesët e mëdha strukturore	Stabilizim, rafte me ngarkesë të verifikuar, distancë nga korridori dhe pa kontakt me tokën	Planimetria, etiketat, kontrolli ditor dhe evidenca e stokut maksimal
Ajri dhe zhurma	Punë vetëm brenda orarit të deklaruar; mirëmbajtje e pajisjeve; ndalim i punës në boshe; aspirim lokal; filtra funksionalë	Regjistri i mirëmbajtjes dhe i filtrave, regjistri i ankesave dhe matjet
Zjarri dhe emergjencat	Aparate zjarri, komplet për derdhje, dalje dhe korridor i lirë, pikë grumbullimi, kontakte emergjente dhe ushtrime	Plani i emergjencës, kontrollet periodike dhe procesverbalet e trajnimit
Menaxhimi	Përgjegjës mjedisor i emëruar, procedura të shkruara, trajnime, auditim i brendshëm dhe menaxhim i ndryshimit	Vendimi i menaxhmentit, regjistrat, raportet dhe veprimet korrigjuese

Burimi: Përmbledhje e masave të Kapitullit 7 dhe e Planit të Menaxhimit Mjedisor të Kapitullit 9.

Monitorimi dhe informimi i publikut

Monitorimi duhet të tregojë nëse masat funksionojnë dhe të aktivizojë korrigjim para se një ndikim të bëhet i rëndësishëm. Kontrolli i përditshëm dhe javor kryhet nga vetë operatori; matjet që kërkojnë rezultat zyrtar kryhen nga laboratorë ose nga persona kompetentë sipas kërkesës së autoritetit.

Rezultatet ruhen, krahasohen me kërkesat ligjore dhe raportohen sipas kushteve të pëlqimit mjedisor. Në rast tejkalimi ose incidenti me rrezik, njoftimi bëhet pa vonesë te autoritetet dhe te personat potencialisht të prekur.

Publiku ka të drejtë të informohet dhe të marrë pjesë në procedurë. Konsultimi publik për raportin e VNM-së nuk mund të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë; raporti publikohet në uebfaqen e Ministrisë dhe të Komunës, dhe debati publik organizohet në institucionet publike të Komunës ku zbatohet projekti.

Tabela 63. Elementet kryesore të monitorimit dhe veprimi në rast devijimi

Elementi	Ku kontrollohet	Shpeshtësia minimale	Veprimi kur ka devijim
Rrjedhje, njolla, enë, bateri dhe pusetat	Pranimi, servisi, karantina, magazina e rrezikshme dhe drenazhimi	Vizualisht çdo ditë pune; kontroll i dokumentuar çdo javë	Izolim, absorbim, pastrim, ndalim i burimit, fotografim dhe regjistrim i incidentit
Mbeturinat dhe inventari	Çdo zonë dhe enë sipas rrymës; regjistri qendror	Në çdo hyrje dhe dalje; përmbledhje mujore dhe vjetore	Korrigjim i etiketës ose i sasisë, ndalim i përzierjes dhe dorëzim i përshpejtuar
Zhurma	Kufiri i parcelës dhe receptori i përdorur më i afërt	Matje bazë; më pas sipas kushtit, ankesës ose ndryshimit të pajisjes	Kontroll i burimit, kufizim orari, izolim dhe matje përsëritëse
Ajri, pluhuri dhe erërat	Hyrja, oborri, kabina e lyerjes dhe kufiri drejt receptorit	Kontroll vizual ditor; matje sipas kërkesës ose ankesës	Pastrim, lagie, mbyllje e enëve, ndërrim filtrash dhe kontroll i pajisjeve

Elementi	Ku kontrollohet	Shpeshtësia minimale	Veprimi kur ka devijim
Uji dhe toka	Pika e drenazhimit, zonat me rrezik dhe pikat e miratuara të mostrimit	Pas incidentit; periodikisht sipas pëlqimit ose vlerësimit teknik	Ndalim shkarkimi, izolim, mostrim, njoftim dhe rehabilitim
Trafiku dhe ankesat	Hyrja, parkimi, korridori dhe regjistri i ankesave	Kontroll ditor; përmbledhje mujore	Riorganizim i lëvizjes ose i orarit dhe përgjigje e dokumentuar ndaj ankuesit

Burimi: Përmbledhje e programit të monitorimit të Kapitullit 8.

Përfitimet nga zbatimi i projektit

Përfitimi kryesor mjedisor i veprimtarisë është ripërdorimi i pjesëve të automjeteve, i cili zgjat jetën e komponentëve, zvogëlon kërkesën për pjesë të reja dhe ul sasinë e mbeturinave që do të gjeneroheshin nga zëvendësimi i tyre. Ky përfitim realizohet vetëm nëse kriteri i përdorshmërisë zbatohet me rigorozitet.

Përfitimet ekonomike lidhen me ofrimin e shërbimit lokal të riparimit, me uljen e kostos së mirëmbajtjes për qytetarët, me ruajtjen e vendeve të punës dhe me kontributin në të ardhurat publike përmes tatimeve dhe doganimit.

Zbatimi i masave të propozuara sjell përfitim shtesë: ai e zvogëlon rrezikun e ndotjes, e përmirëson pamjen e korridorit rrugor, e rrit sigurinë në punë dhe e mbron vetë operatorin nga përgjegjësia për ndotje të pazbuluar historike, sepse krijon një gjendje bazë të dokumentuar.

Çështjet që mbeten të hapura

Raporti identifikon në mënyrë të hapur informacionin që nuk mund të konfirmohet me burimet aktuale. Këto çështje nuk fshihen dhe nuk zëvendësohen me vlera të supozuara; ato paraqiten me atë që mungon, me burimin që kërkohet, me përgjegjësin dhe me kapitullin ku integrohen.

Çështjet kryesore të hapura janë: sigurimi i Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe i kopjes së planit me koordinata KosovaRef për parcelat 1402-2 dhe 1402-9; dëshmia e kyçjes në ujësjellës dhe në kanalizim; kontratat me operatorë të licencuar për rrymat e mbeturinave; projekti zbatues i drenazhimit dhe dimensionimi i separatorit; matjet bazë të zhurmës, të tokës dhe të ujit; distanca e matur deri te receptori më i afërt dhe deri te rrjedha ujore; si dhe konfirmimi i numrit faktik të punëtorëve.

Asnjë prej këtyre çështjeve nuk e bën vlerësimin të pavlefshëm, por të gjitha e kufizojnë sigurinë e tij. Ato duhet të mbyllen para ose gjatë fazës së parë të zbatimit, sipas kalendarit të Kapitullit 9, dhe rezultatet e tyre integrohen në dosjen e aplikimit.

PËRFUNDIMI I VLERËSIMIT

Veprimtaria ekzistuese mund të vazhdojë vetëm brenda kufirit dhe kapacitetit të vlerësuar, me zbatimin e masave të këtij raporti dhe të kushteve që vendos autoriteti kompetent. Ndikimet kryesore janë lokale dhe të menaxhueshme, por kontrolli i tokës dhe i ujërave, ndarja e produktit nga mbeturina, magazinimi i sigurt, drenazhimi, kontrolli i emetimeve nga lyerja, gjurmueshmëria dhe reagimi ndaj incidenteve janë kushte thelbësore. Prerja e automjeteve të plota në Kosovë, importi i automjeteve për trajtim si mbeturina, grumbullimi i mbetjeve metalike, rritja e qëndrueshme e kapacitetit, futja e një procesi të ri ose zgjerimi jashtë parcelave nuk mbulohen nga ky vlerësim dhe kërkojnë rishqyrtim para zbatimit.

Regjistri i dokumenteve mbështetëse dhe i shtojcave

Dokumentet e mëposhtme bashkëngjiten pas raportit përfundimtar me të njëjtin kod reference. Statusi "i dorëzuar" nënkupton se kopja elektronike ka qenë në dosjen e hartimit; statusi "për t'u plotësuar" nënkupton se dokumenti mungon, nuk është i plotë ose kërkon version zyrtar të përditësuar.

Lista është ndërtuar duke ndjekur Shtojcën III të UA-së nr. 04/2025 dhe nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-181, në mënyrë që kontrolli i plotësisë së dosjes të mund të kryhet drejtpërdrejt nga kjo tabelë.

Tabela 64. Regjistri i shtojcave dhe i dokumenteve përcjellëse


Kodi	Dokumenti ose shtojca	Identifikimi	Statusi	Referenca në raport
SH-01	Certifikata e regjistrimit të biznesit	ARBK; regjistrim 27.03.2024; nr. serik 10181415	I dorëzuar	Kapitujt 1, 10 dhe 11
SH-02	Informatat e biznesit dhe veprimtaritë e regjistruara	ARBK; NUI 812145119; veprimtaritë 4520 dhe 4532	I dorëzuar; të përditësohet	Kapitujt 1, 2, 10 dhe 11
SH-03	Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme	Parcelat 1402-2 dhe 1402-9 sipas situacionit gjeodetik; dokumenti zyrtar kadastral për t'u bashkëngjitur	Për t'u plotësuar	Kapitujt 1, 3, 5 dhe 11
SH-04	Kopja e planit me koordinata në sistemin KosovaRef	Institucioni kadastral kompetent	Për t'u plotësuar	Kapitujt 3 dhe 11
SH-05	Plani i rilevimit të terrenit dhe licenca e gjeodetit	ZK Lipjan; parcelat 1402-2 dhe 1402-9; lënda S/2026; shkalla 1:750; Florent Retkoceri, licencë 182; 17.08.2026	I dorëzuar	Kapitujt 3, 5, 10 dhe 11
SH-06	Pëlqimi i Komunës ose njoftim-informimi sipas planit zhvillimor, hartave zonale dhe kushteve ndërtimore	Komuna e Lipjanit	Për t'u plotësuar	Kapitujt 2, 3, 5 dhe 10
SH-07	Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, kur nuk është pronë e aplikuesit	Sipas rastit	Për t'u plotësuar sipas rastit	Kapitujt 1 dhe 3
SH-08	Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor	MMPHI	Për t'u plotësuar	Procedura administrative
SH-09	Vlera investuese e projektit në formë tabelare	Aplikuesi	Për t'u plotësuar	Procedura administrative
SH-10	Licenca e hartueses së raportit të VNM-së	MMPHI; nr. 20/19/24; vlefshmëri 12.08.2024 – 11.08.2029	I dorëzuar	Kapitulli 1
SH-11	Harta e pozitës gjeografike dhe kadastrale	Material hartografik i projektit	I dorëzuar	Kapitujt 1, 3, 11 dhe 12
SH-12	Harta e qasjes rrugore	Ortofoto me kufirin e projektit	I dorëzuar	Kapitujt 2, 3 dhe 11
SH-13	Harta e distancave ndaj vendbanimeve dhe objekteve orientuese	Material hartografik i projektit	I dorëzuar; metadatat të plotësohen	Kapitujt 3, 6, 8 dhe 11

Kodi	Dokumenti ose shtojca	Identifikimi	Statusi	Referenca në raport
SH-14	Harta gjeologjike dhe harta pedologjike	Shtresa tematike rajonale	I dorëzuar; metadatat të plotësohen	Kapitujt 3, 4 dhe 11
SH-15	Harta e ujërave sipërfaqësore	Rrjeti hidrografik i zonës	I dorëzuar; distanca të matet	Kapitujt 3, 4, 6, 8 dhe 11
SH-16	Harta zonale e shfrytëzimit të tokës	Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2021–2029	I dorëzuar; konfirmimi zyrtar mungon	Kapitujt 2, 3, 5, 10 dhe 11
SH-17	Harta e qasjes në kanalizim me pozitat e pusetave	Material hartografik i projektit	I dorëzuar; ka karakter propozimi	Kapitujt 3, 5, 7 dhe 11
SH-18	Fotografitë e terrenit	Fotografi të dorëzuara nga aplikuesi, viti 2026	I dorëzuar; data, koordinatat dhe drejtimi të plotësohen	Kapitujt 3, 4, 5, 11 dhe 12
SH-19	Skica e organizimit aktual dhe e zgjerimeve	Skicë e aplikuesit; autoservis +550 m²; garazh/depo 730 m²	E dorëzuar; dimensionet verifikohen në projektin zbatues	Kapitujt 3, 5, 7, 10 dhe 12
SH-20	Skica konceptuale e zonimit funksional	Skicë konceptuale për organizimin e lokacionit	E dorëzuar; sipërfaqet orientuese	Kapitujt 3, 5 dhe 12
SH-21	Dëshmia e furnizimit me energji elektrike	Faturë KESCO në emër të AUTO SELIMI SH.P.K., viti 2026	I dorëzuar	Kapitujt 2, 3, 10 dhe 11
SH-22	Dëshmia e shërbimit të mbeturinave komunale	KRM “Pastrimi” Sh.A.; faturë nr. 6856823; 30.06.2026; ID 129776	I dorëzuar	Kapitujt 2, 3, 4, 10 dhe 11
SH-23	Dëshmia e kyçjes në ujësjellës dhe në kanalizim	Numri i konsumatorit dhe konfirmimi i operatorit	Për t’u plotësuar	Kapitujt 3, 6 dhe 10
SH-24	Kontratat dhe licencat e operatorëve për rrymat e mbeturinave	Operatorë të licencuar sipas rrymës	Për t’u plotësuar	Kapitujt 2, 5, 7 dhe 9
SH-25	Fletët e të dhënave të sigurisë për bojërat, tretësit dhe stukot	Prodhuesit e materialeve	Për t’u plotësuar	Kapitujt 2, 5 dhe 7
SH-26	Dokumentacioni teknik i kabinës së lyerjes dhe i sistemit të filtrimit	Prodhuesi i pajisjes	Për t’u plotësuar	Kapitujt 2, 5, 7 dhe 8
SH-27	Projekti i drenazhimit dhe dimensionimi i separatorit	Projektues i licencuar	Për t’u plotësuar	Kapitujt 5, 7 dhe 8
SH-28	Raportet bazë të matjeve të zhurmës, të tokës dhe të ujit	Laborator ose person kompetent	Për t’u realizuar sipas Kapitullit 8	Kapitujt 4 dhe 8
SH-29	Plani i reagimit emergjent dhe evidenca e trajnimeve	Operatori	Për t’u plotësuar	Kapitujt 5, 7 dhe 9
SH-30	Informacioni për informimin dhe konsultimin me publikun	Sipas UA (MMPHI) nr. 11/2025	Për t’u plotësuar gjatë procedurës	Kapitujt 8 dhe 12
SH-31	Përmbledhja joteknike e raportit të VNM-së	Kapitulli 12 i këtij raporti	E përfshirë në raport	Kapitulli 12

Burimi: Shtojca III e UA-së (MMPHI) nr. 04/2025 dhe neni 13 i Ligjit nr. 08/L-181.

Neni 13 paragrafi 1 i Ligjit nr. 08/L-181 kërkon që aplikuesi të dorëzojë katër (4) kopje të raportit në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike, ndërsa Shtojca III e UA-së nr. 04/2025 përmend një (1) kopje të shkruar dhe një (1) elektronike. Meqë ligji ka fuqi më të lartë juridike se akti nënligjor, numri i kopjeve konfirmohet me Ministrinë në momentin e dorëzimit; ky raport e vë në dukje mospërputhjen dhe nuk e zgjidh atë me interpretim.

Aplikuesi ofron gjithashtu një (1) kopje fizike ose elektronike të raportit për Komunën e Lipjanit, e cila duhet të jetë në dispozicion të publikut, sipas nenit 13 paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-181 dhe pikës (j) të Shtojcës III të UA-së nr. 04/2025.



Skemë teknike2. Ndarja konceptuale e ujërave atmosferike dhe kontrolli i hidrokarbureve për AUTO SELIMI SH.P.K.

Burimi: Skemë konceptuale e përgatitur për këtë Raport të VNM-së; nuk zëvendëson projektin zbatues hidroteknik, dimensionimin e separatorit ose miratimin e pikës së shkarkimit.

Skema ndan ujërat e pastra të çative dhe sipërfaqeve pa kontakt me vajra nga rrjedhjet e zonave me rrezik, si servisi, pranimi, karantina, parkimi dhe manovrimi. Rrjedhjet me rrezik drejtohen në grumbullim dhe sedimentim, pastaj në separator hidrokarburesh dhe pusetë kontrolli para një daljeje të përcaktuar me projekt. Ujërat sanitare mbeten sistem i veçantë dhe nuk hyjnë në këtë linjë; në rast incidenti parashihet izolimi i daljes për të penguar shpërndarjen e ndotjes jashtë sistemit të kontrolluar.